

JETON NEZIRAJ:

Krijoj si artist i lirë, por e di se kjo liri nuk mund të merret si e mirëqenë

Bisedoi *Andreas Dushi*



EPISODI I DYMBËDHJETË.

Forma e shkurtër në panoramën e narrativës italofone. Histori të shkurtra që arrijnë të rrëfejnë vetëm një gjë.

Nga *Dr. Fabio M. Rocchi*

Zhanri i shkurtër në letërsinë moderne dhe bashkëkohore has zhvillime të diskutueshme. Nga njëra anë, ka qenë në gjendje të konvergjojë rreth vetes reflektive dhe kuptime të thella, të zbuluara përmes historive me bukurie absolute dhe ekuilibër të përsosur.

(fq. 8)

JU FTOJMË NË
PANAIRIN I LIBRIT
NË ULQIN
(17-20 GUSHT)

SHËNIME MBI LIBRAT

SHKRIMI MEMUARISTIK I
MIT'HAT FRASHËRIT

nga *Agron Tufa*

(fq. 4)

Parathënia e kompletit *Vepra të zgjedhura 1-6*

VEPRA LETRARE DHE
STUDIMORE E SALI BASHOTËS

Nga *Milazim Krasniqi*

(fq. 11)

Romani "Nessun Dorma" të Roland Gjozës

FATALITETI I NJË GRUAJE
MËKATARE, POR TË PAFAJSHME

Nga *Gani Bytyçi*

(fq. 13)

EFEKTI ZEIGARNIK NË
ROMANIN "MI MANCHI"
TË FATE VELAJ

Nga *Maria Sinatra*

(fq. 16)

BABA ALI TOMORI:
FRYMA NAIMIANE E NJË
BEKTASHIU

Prof. as. dr. *Myrvete Dreshaj* – *Baliu*

Prof. dr. *Begzad Baliu*

(fq. 6)

Fatos Baxhaku dhe fotoja
"Dorëzimi i armëve"

Nga *Qerim Vrioni*

(fq. 12)



Botohet në italisht romani
"Diktatori në kryq" i
Mira Meksit

(fq. 16)

Botohet në greqisht romani
"Valsi i lumturisë" i
Ylljet Aliçkajt

(fq. 21)

KADARE

Historia e "tjetrit"

ESE



BIBLIOTEKË

Autorë të ndryshëm

(fq. 18)

Poezitë më të bukura

(Përkthyer nga Rudolf Marku)

Shqiptar Oseku

(fq. 17)

Udhëtimi

Fatmir Alimani

(fq. 20)

Martin Walser

Viktor Eftimiu

(fq. 7)

Rrëfimet e xhaxha Janit

(Përktheu nga rumanishtja Pandi Bello)

Arben Meksi

(fq. 24)

Karikatura e së shtunës

Ajo njihje Marks, Beethoven, Robert dhe Klara Shumanin, vëllezërit Grim, Liszt e të tjerë, duke e kthyer kështu në një revolucion të romantizmit femëror.

George Perdota: **BETINA,
MUZA E TË GJITHËVE**

(Përktheu Jola Tasellari)

(fq. 21)

TREGU: E VËRTETA PËR ARTIN

Nga *Vangjush Saro*

(fq. 10)

GJON MILI, PICASSO,
VIZITA E DYTË

Nga *Qemal Agaj*

(fq. 22)

A.D.: Jeton, përshëndetje! Nëse nuk gaboj, edicioni i para pak ditëve i *Polip Fest* paska qenë edhe i fundit pasi Qendra Multimediale dhe stafi organizativ i festivalit vendosi ta mbyllë. Cila ishte arsyeja e këtij vendimi dhe marrja e tij mendoni se e zbeh sado pak natyrën e komunikimit letrar shqiptar?

J.N.: Festivali Ndërkombëtar i Letërsisë - polip, ka pasur deri më tash 13 edicione, të suksesshme do të thoja. Janë mbi 200 shkrimtarë rajonal e ndërkombëtar, dhjetra intelektual e aktivist kulture që kanë qenë mysafir të këtij festivali përgjatë këtyre viteve. Jemi përpjekur të ruajmë njëfarë balansi në çdo edicion dhe të kemi të ftuar edhe shkrimtarë të afirmuar, por edhe të rinjë, por mbi të gjitha, na kanë interesuar shkrimtarët e rinj. Sepse ashtu e kishim konceptuar këtë festival, si një platformë që u jep zë, i fuqizon dhe i rretizon para së gjithash shkrimtarët e rinj. Përtej kësaj, në vitet e tija të para, festivali në esencë ka shërbyer si një urë komunikimi e shkëmbimi ndërmjet shkrimtarëve serbë dhe shqiptarë, në një kohë kur ky komunikim ishte jo më vetëm i rrallë, por madje konsiderohej si "i ndaluar". Më lejohet kjo hyrje e shkurtër, por e bëra sa për t'i vënë gjërat në kontekst. Tani, nga këto 13 edicione, dy u organizuan në rrethana të pandemisë, në rrethana krejtësisht të pafavorshme dhe absurde për një festival si ky, i nëntokës, që organizohej në një bodrum të një ndërtese soc-realiste në Prishtinë, ku pihej rakia e ku mes timit të duhanit lexohej 'letërsi e ndaluar', ku komunikohesh e ku diskutohej pa protokoll e pa frikë, por ku, mbi të gjitha, kishte shumë dashuri për letërsinë. Pra, dy vite të humbuar, me ca përpjekje të dështuara për ca zoom-lexime, zoom-diskutime, dhe kjo natyrisht pati ndikim, para së gjithash, të keq. Dhe kështu, nisëm të mendonim që ky festival e kishte humbur kuptimin. 'Vendosëm' ta ndërprisnim për arsye kryekëput konceptuale. Por këtë vendim donim ta merrnim bashkarisht me shkrimtarët dhe njerëzit që këtë festival vërtetë e donin. Dhe kështu, sivjet në maj, patëm edicioni e 13-të, dhe ku fokusi kryesor ishte tek diskutimi mbi festivalet letrare në rajon, rolin e impaktin e tyre dhe rrjedimisht diskutimi çoi edhe tek fati i festivalit polip. Shkrimtarët, natyrisht, në shumicë, ishin kundër ndërprerjes dhe na dhanë argumente të fuqishme që festivali ndoshta duhet të transformohet, por që të vazhdoj duhet medemos. Kështu që, tani jemi në këtë proces, duke e përtypur këtë diskutim dhe duke parë se në çdrejtim duhet të vazhdojmë. Por, të themi edhe që, sivjet ne kemi botuar një monografi impulsive për festivalin, ku janë përmbledhur përvojat e shkrimtarëve dhe ku është analizuar e shqyrtuar jo më sall roli i këtij festivali, por në përgjithësi, roli i letërsisë në rajonin e trazuar tonin. Mendoj që kemi bërë një punë të rëndësishme deri më tani. Do t'më vinte keq nëse ky festival ndërpritet, por në anën tjetër, ndonjëherë është më mirë t'u lëshohet udhë ideve të reja, sesa të shtyhen me gjoks ide që dikur kanë pasur kuptim, por që tani ai kuptim është i paqartë.

A.D.: Përtej *Polip*-it, në çfarë pike e sheh këtë komunikim? Besoni se, ashtu

JETON NEZIRAJ:

Krijoj si artist i lirë, por e di se kjo liri nuk mund të merret si e mirëqenë

Bisedoi Andreas Dushi

sikurse vërtetë nuk ka kufij gjuhësorë, jemi duke ju afruar (mos ndoshta e kemi arritur) edhe zhbërjen e kufijve gjeografikë mes dy anëve të Drinit?

J.N.: Nuk është se na ka interesuar fort 'komunikimi letrar brenda-shqiptar', jo përderisa ai është i lirë dhe në kushte që të mund të ndodhë papengueshëm. Vështirësitë e këtij komunikimi janë aty, natyrisht, por ato janë më tepër të natyrës byrokratike, administrative e ngjajshëm. Ndërkohë që, bashkëpunimi letrar ndërmjet Sërbisë e Kosovës, po, hasë në vështirësi politike, ka hasur gjer më tani, për arsye fort mirë të ditura. Që ky komunikim të ndodhë, është kaluar dhe kalohet akoma nëpër ca 'peripeci', e të cilat, për profilin e Qendrës Multimediale, kanë qenë nxitëse. Letërsia po, teatri po, na kanë interesuar, por na ka interesuar edhe shtrati mbi të cilin krijohet e shkëmbet ajo letërsi, e ai teatër. Dhe po, duke shkëmbyer letërsi e teatër, duke bashkëpunuar e duke u ulë përballë njëri-tjetrit, krijues shqiptar dhe serb, janë trazuar disa ujëra, por në



të njëjtën kohë janë kthjellur shumë më shumë ujëra. Tani, falë kësaj grime bashkëpunimi e dialogu kulturor, ne mund të shohim pak më thellë brenda shoqërisë serbe, dhe poashtu, edhe ata mund të shohin pak më thellë brenda shoqërisë kosovare. Dhe kjo "pak më thellë" nënkupton "pak më shumë njohje". Fashizmi kulturor serb ndaj shqiptarëve është lapidar. Por nuk është se ne nuk e kemi pasur të ndërtuar një kala me stereotipe e paragjykime për shoqërinë serbe.

A.D.: Si dramaturg, jeni përfaqësuesi më me zë ndërkombëtarisht i këtij zhaneri të shkruar në shqip. Herë pas here, dramat tuaja kanë krijuar polemika, nga banalet deri te arritja në nivelet e shqetësimit shtetëror, për shembull nga ana e Serbisë për përmbajtjen e tyre. Mos ndoshta konfliktet në Ballkan janë një Trojë dhe drama, kali që futet aty për të sjellë paqen?

J.N.: Duke shkruar drama që shpesh kanë prekur tema të ndjeshme politike



e sociale, ndonjëherë ka qenë sikur të ecësh në një fushë të minuar. Sepse, në një truall si ky i yni ballkanas, duket se pakkush ka qenë i interesuar për normalitet. Teatri ka luajtur një rol të rëndësishëm, emancipues para së gjithash - dhe vazhdon akoma ta bëjë atë gjë. Ai e ka konfrontuar publikun, kastat politike, mediat dhe të tjerët, me anën e errët të realitetit, të cilën askush nuk ka qenë në gjendje ta njohë dhe ta pranojë si të tillë. Dhe prandaj, po, shpesh me shfaqjet tona kemi hasur në 'rezistencë' të grupeve të caktuara, qofshin ato politike, religjioze a parapolitike, të cilat kanë qenë kundër atyre përmbajtjeve që kemi trajtuar, e kundër atij vizionit tonë për një hapësirë të çliruar nga etnet e nacionalizmit e nga fantazmat e luftës të së kaluarës. Dhe kjo kundërshti them se është legjitime, sepse teatri nuk është aty për t'i akomoduar interesat e pritjet e të gjitha grupeve të publikut. Nëse nacionalistët ndihen të trazuar me ndonjë shfaqje teatrore, është totalisht ok. Dhe poaq ok është nëse homofobët, fundamentalistët religjioz e të ngjajshmit ndihen të fyer ose të pakënaqur me ndonjë shfaqje. E kundërta do t'kishte qenë ofenduese për vet natyrën e teatrit.

A.D.: Metafora e lodhur në pyetjen e mësipërme imponon vijimin e saj: Kush është *Laokonti* në këtë rast, pra kundërshtuesi për ta pranuar këtë kalë?

J.N.: Janë para së gjithash kastat e korruptuara politike, të cilat qëndrojnë në pushtet duke përdorur 'alarmin e ndezur nacional, për 'krizën që na kanoset', për 'rrezikun' nga 'këta' apo 'ata'! Kastave politike nuk u intereson normaliteti, sepse normaliteti pastaj kërkon standarde tjera, në të cilat ata më nuk mund të funksionojnë. Ata e duan anarkinë, e duan gjendjen konstante të 'alarmit nacional'. Por, në këtë grup hyjnë edhe kriminelët e lufrave, ish komandantët e pushtetshëm, që nuk duan t'i humbasin privilegjet që besojnë se duhet t'i gëzojnë për shkak të angazhimit e kontributit të tyre në luftë, e kështu me radhë. Lista është më e gjatë, pra, shumë më e gjatë se sa e atyre që përpiqen për normalitet, që përpiqen të krijojnë një mjedis që nuk është toksik si ky i yni.

A.D.: *The Hande Project* është shfaqur në disa teatro evropiane që prej premierës. Ndërthurja e linjave të subjektit ngjall kureshtje aktive, pra nuk të lë veç ta vëzhgosh pjesën,

por me patjetër të bën pjesë të saj. A jemi të gjithë tërësisht të ekspozuar përballë mundësisë për të qenë pjesë e një projekti si ai i Handke-së? Dhe për çdo projekt metafizik të asaj natyre, sa i nevojshëm është një Neziraj që ta demaskojë artistikisht? (të sqaroj se fjalët *projekt* dhe *demaskim* vijnë të jenë koncepte metaforike :))

J.N.: Në *The Handke Project* ne jemi përpjekur ta kuptojmë se si ne si artistë mund të mbesim të përkushtuar ndaj lirisë artistike, por duke qenë të vetëdijshëm për përgjegjësinë që kemi ndaj publikut!

Ndikimi në publik i një shkrimtari nuk është për tu injoruar, sepse njerëzit shpesh preferojnë të "vërtetat letrare", para të vërtetave që u servohen nga historianët, nga politikanët, nga mediat e nga të tjerët... Në një kohë të "post-truth", për plot njerëz të humbur në informacione, e vërteta gjendet vetëm në letërsi! Dhe ky është një lloj pushteti që letërsia vazhdon ta ketë.

Dhe prandaj, shfaqjet si *The Handke Project* janë të nevojshme, sepse i kundërvihen fashizmit, edhe fashizmit të konvertuar në letërsi. Personalisht, letërsinë e as teatrit nuk e shoh të shkëputur nga *kalërimet* publike të artistit, dhe nuk besoj se dikush mund të jetë një "shkrimtar i mirë", nëse është një "monstrum i pandjeshëm" si njeri. Nuk mund dhe nuk duhet të ketë asnjë 'autoritet' letrar që qëndrimet fashiste i fshehë pas letërsisë.

Natyrish, arti duhet të jetë i lirë të bëjë pyetje, megjithatë, pyetjet që shtrou arti nuk guxojnë të jenë helmuese e trazuese, nuk guxojnë të lëndojnë edhe më tutje viktimat, të shtypurit e të marginalizuarit. Pyetjet që shtrou arti nuk duhet të shtojnë më shumë vuajtje e dhimbje. Pra, një kufi etik ekziston megjithatë, ka ekzistuar gjithmonë në art, sidomos në teatër e letërsi. Ne me shfaqjen tonë thjesht, kemi bërë përpjekje të tregojmë që pikëpyetja e Peter Handkes, kur ai shkruan për luftrat në ish Jugosllavi, është si grepi i Captain Hook-ut. Pra, nuk është pikëpyetje që synon të na çliroj, por të na robëroj. Pikëpyetja e Handkes është armë vrasëse.

A.D.: Përtej këtij projekti, dua të veçoj edhe një tjetër, atë socio-tradicionalin që formëson me detyrim konstruktive shoqërore të caktuara. I tillë është edhe fenomeni i *burrneshës*. Në pjesën *Burrneshë*, marrja e këtij motivi dhe vendosja në një kontekst që do ta zbërthojmë pak më poshtë është loja artistike e që sjell qasje të re në vetëdijen e publikut. Si dramaturg, e keni këtë synim? Cilado qoftë përgjigjja, duhet guxim që ta realizosh këtë?

J.N.: Ekziston një lloj 'urie' (gjithmonë ka ekzistuar) për tema të rralla e ekzotike, për ndodhi e histori të çuditshme, për kode e ligje të padëguara që audiencës "evropiane" do t'ia luanin trurin. Kjo është një lloj kureshtjeje sipërfaqësore e cila shoqërinë që ka prodhuar ato histori a fenomene, i prezenton nën dritën e primitivizmit. Perspektiva perendimore e hulumtimit të fenomenit të burrneshave të përbetuara shqiptare ka qenë kryesisht ekzotike, pra, një shikim i "botës së civilizuar" ndaj asaj "të pacivilizuar". Ka pasur poashtu



një lloj eksploatimi të llojit të vet që i është bërë këtij fenomeni dhe i cili është shfrytëzuar dhe përdorur nga të gjithë, veçanërisht nga mediat ndërkombëtare por edhe nga hulumtuesit e fushave të antropologjisë, sociologjisë, etnografisë e kështu me radhë. Një lloj intimiteti që këtyre burrneshave u ka garantuar akti i të kthyerit në burrneshë, krejt përnjëherë i u është ekspozuar mediave dhe publikut, ekspozim i cili nuk u ka sjellur ndonjë përfitim burrneshave, përkundrazi, në shumë raste ato janë portretuar në dritën e primitivizmit dhe si 'relikte' të një shoqërie skajshmërisht patriarkale. Por për shumë nga këto gra, të vishesh si burrë dhe të bëhesh burrneshë ka qenë një akt emancipues. Ato e lidhin këtë akt me idenë e "lirisë".

A.D.: Përdorimi komercial i traditës që formëson personalen, është ky motivi bazë i botës së spektaklit që krijon më pas shoqërinë e atillë? Dhe, për aq kohë sa qysh nga romakët e lashtë popujt sundoheshin duke u dhënë ushqim e argëtim, kthimi i gjithçkaje në argëtim dhe krijimi i kushteve për ushqim veç nëpërmjet stërmundimit a është hedhje e sigurt e hapave drejt sundimit?

J.N.: Ky raport për të cilin flisni ju, është pak a shumë edhe linja qëndrore e dramës. Në dramën "Burrneshë", antropologia angleze Edith, pas vizitës në veriun e Shqipërisë, takohet me Sose-n, njërin nga pak burrneshat e mbetura shqiptare. Të dyja, pastaj udhëtojnë në Londër, në një seri të prezentimeve publike në London University. Gjatë kësaj vizite, Sose bëhet pjesë e një *queer performance* që është duke u përgatitur nga Julian, që është një *drag-queen* e njohur e Londrës. Për Sose-n takimi me një kulturë kaq të huaj bëhet çështje ekzistenciale. Drama ime trajton fenomenin e burrneshave, nën dritën edhe të debatit të tanishëm mbi çështjet gjinore, si dhe adreson konceptin e lirisë, respektivisht mos-lirisë në shoqëritë me vlera, koncepte e konstruktive të ndryshme shoqërore.

A.D.: Disa nga dramat tuaja kanë ose si element thelbësor, ose si fenomen të lidhur me valenca praninë e personazheve LGBT. Jo veç kjo dramaturgjia, por kjo krijimtari në përgjithësi (po përfshij edhe letërsinë

apo kinematografinë) a është më e pranuar nga publiku, lexuesi a artdashësi i Kosovës sesa nga ai i Shqipërisë?

J.N.: Mendoj që shoqëria shqiptare, edhe në Shqipëri e edhe në Kosovë është duke u emancipuar me shpejtësi. Pra, edhe për sa i përket çështjeve e temave që lidhen me komunitetin LGBTI+. Nuk mund të them me saktësi dallimet mes Kosovës dhe Shqipërisë për sa i përket kësaj çështjeje specifike, por ajo çfarë mund të konfirmoj është se publiku në Shqipëri është më konzervator, edhe për sa u përket prirjeve të reja teatrore, por edhe sa u përket temave. Kjo është e evidente nëse shihet repertori i teatrove në Kosovë dhe Shqipëri. Arsyeja dhe rrethanat për këtë 'ngecje' të teatrit në Shqipëri janë të kuptueshme, deri në një masë, ose, të themi, deri në masën e rrethanave historike e politike në të cilën është zhvilluar e ka funksionuar ky teatër deri në fund të viteve të 90-ta. Ajo çfarë është e pakuptueshme dhe e pabesueshme është një lloj përbuzjeje në kontinuitet e teatrit, krejt këto vitet e pas të 90-tave, përbuzje që natyrish vie nga politikanët. Thjesht, unë ndihem i lënduar për këtë përbuzje, dhe jo më si shqiptar, por si krijues teatri, që beson verbërisht që një teatër i lirë, i zhvilluar, është shenjë e një shoqërie të lirë e të emancipuar.

A.D.: Shpesh eksponentë të kulturës ankohen se u mungon mbështetja nga shteti. Botues, shkrimtarë, përkthyes apo edhe regjizorë. Personalisht si e shihni, mendoni se arti ka nevojë të mbështetet nga shteti? Po përtej nevojës, si thoni, a i bën mirë kjo mbështetje?

J.N.: Kudo tjetër, përgjigjja do të nëkuptohet: po, natyrish, shteti duhet ta mbështes skenën artistike, megjithatë, kam frikë që këtej tek ne kjo mbështetje në të shumtën e rasteve vetëm se e ka kontaminuar skenën artistike, duke ia cënuar pavarësinë dhe duke e instrumentalizuar.

Për vite të tëra, në Qendrën Multimedia, të cilën e drejtoj, nuk kemi aplikuar fare për fonde publike. Dhe ky ka qenë një qëndrim artistik i yni. Sepse, në ato rrethana, 'përzjerja e këmbëve' me shtetin ka nënkuptuar një lloj nënshtrimi. Pavarësinë dhe qasjen kritike e kemi ruajtur duke mos qenë

të varur financiarisht dhe duke mos ia pasur nevojën shtetit. Tani, këto vitet e fundit, gjërat kan ndryshuar. Tani, kur kemi krijuar mjaftueshëm reputacion dhe kur kemi dëshmuar që bëjmë edhe pa fondet e shtetit, aplikojmë për fonde publike, mbështetemi, por në të njëjtën kohë, e ruajm pavarësinë dhe qasjen kritike.

Kam frikë që në Shqipëri është një situatë tjetër dhe kam frikë që krijuesit atje po e jetojnë atë që ne në Kosovë e kemi jetuar deri para 5 vitesh. Me një dallim të vetëm: që ne megjithatë kemi pasur burime alternative financimi, ndërkohë që, krijuesit në Shqipëri nuk i kan. Gjithçka sillet tek fondet, që s'dihet se si jepen, e bashkisë së Tiranës dhe tek ato fonde mizerie që ndan Ministria e Kulturës.

A.D.: A është i lirë artisti në vende si këto tonat? Personalisht, a jeni i lirë?

J.N.: Pyetje e mirë, e rëndësishme. Do të thoja: po, jam lirë, ndihem i lirë. Nuk ka qenë kështu vite më parë, por tani është kështu, dhe ta them që, për këtë liri krijuese është insistuar me ngulm, është luftuar (shpresoj që kjo nuk tingëllon si ndonjë parollë komandantësh). Zgjerimi i lirisë krijuese ka ndodhur paralelisht me emancipimin e shtetit dhe të shoqërisë kosovare. Në anën tjetër, jam i vetëdijshëm që kjo mund të jetë një 'fasadë' e përkohshme, sepse, e dimë që në këto anët tona gjërat dinë të përmbysen në shpejtësi. Prandaj, krijoj si artist i lirë, por me 'alarmin nderur', që kjo liri duhet të mirëmbahet dhe se nuk mund të merret si e mirëqenë.

Në anën tjetër, fatkeqësisht, nuk mund të them që kjo liri krijuese ekziston edhe në Shqipëri e Serbi, ta zëmë. Për vendet tjera në rajon nuk mund të flas. Në Shqipëri është një gjendje e çuditshme, krijuesit besojnë që janë të lirë, megjithatë ata, besoj unë, janë robër të pushtetit aktual, të cilit i shërbejnë në këmbim të atyre pak burimeve financiare për të cilat fola më sipër. Në Serbi ndërsa, pushteti aktual i Vuçiqi ka krijuar një ambient të frikshëm, ku artistëve thjesht u është uzurpuar 'guximi'. Pakkush guxon të flasë atje, pakkush guxon të jetë kritik, dhe gati të gjithë janë të nënshtruar e të bindur. Dhe kjo, po, është e frikshme.

Mitat Frashëri qahet shpesh, ndjen keqardhje për faktin se Naimi, Samiu dhe i ati nuk mbajtën, nuk lanë shënime rreth veprimtarisë së tyre, me fjalë të tjera, nuk lanë "Kujtime". Këtë të metë e kanë pasur më para dhe më pas pjesa më e madhe e personaliteteve të kulturës dhe politikës shqiptare. Po dihet, ndërkaq, që kujtesa është baza e kulturës. Mitat Frashëri të paktën vetë la disa kujtime të botuara dhjetë tjera, në dorëshkrim, të cilat kemi fatin t'i gjejmë të përmbledhura në këtë vepër të re që promovohet sot nga Instituti "Lumo Skëndo".

Memuaristika si shkrim është thelbi i sendërtimit të kujtesës kulturore¹. Është një prej mjeteve të trashëgimisë shpirtërore të gjeneratave dhe një prej treguesve të nivelit qytetëruar të shoqërisë, e marrëdhënies së saj të ndërgjegjshme dhe analitike me të kaluarën, e rrjedhimisht, edhe për qenësinë e një sociumi etnokulturor në përgjithësi.

Edhe pse trashëgimia memuaristike e Mitat Frashërit nuk paraqet një shkrim sistematik, të rregullt, sipas një vijueshmërie të pandërprerë, ajo, gjithsesi, na njeh me disa segmente të rëndësishme të ngjarjeve historike e politike të Shqipërisë në agun e saj shtetformues, sikundërse na sjell nga afër portrete personalitetesh politike e kulturore të një çerek shekullit të parë të shekullit XX.

Lloji i shkrimit memuaristik të Mitat Frashërit rivalizon dorë për dorë me letërsinë artistike, pa ia zbehur aspak forcën dhe rëndësinë dëshmisë autentike. Është qartësia, thejshësia, stili i gjallë e dinamik, toskërishtja letrare e kulluar, që e shquan prozën e tij në atë nivel të ngjashëm subtil të Konicës e në disa raste, në po ato nivele koniciane shkëlqen dhe ironia therëse e grotesku. Por përgjithësisht, prozat memuaristike të Mitat Frashërit, të shkapërdara në vite të ndryshme, krijojnë kuadre të veçanta historike e nganjëherë psikologjike, zbulime, qëmtime, meditime, asociacione idesh, etj. Në këtë rast shkrimi memuaristik mpikset rreth një ideje duke themeluar simbolika e përkime, alegori, sikurse është proza memuaristike "Pylli":

Nga pylli dilte një aromë e mirë; nën shtizat e diellit këto bimë kishin dursur; një aromë e bërë prej djersës së vesës dhe prej rrezevet të diellit; kjo djersë e ngrohtë e dru-rëvet, ky avulli i hollë, i jepte njeriut një si dehje.

Tok me zgjimin dhe harlisjen e pyllit, të përshkruar me një gjuhë që është sferë e poezisë, na jepet jehona e një sëpate që pret dru: *Tak, tak, tak! - Po bëjmë dru, - më tha plakun me mjekrën e bardhë. - Të krasiturit i jep fuqi drurit, pastaj më mirë të pritët, sesa të vdesë mbërdhe prej pleqërie.* Ndërkaq, më vonë, spikat një zhurmë, klithje: *Po ky zë është? Nga del kjo klithje e çuditshme? Fare poshtë, tek qullet qyteti në ujë, në liman, një vapor i madh po ngarkon ushtarë. Djelmoshat, fshatarët, burrat e Anadollit po i shpien në Shqipëri se ka kryengritje në Kosovë.* Dhe sërish kuadri memuaristik mbyllet me sentencën alegorike: *"Të krasiturit i jep fuqi drurit; më mirë të pritët, se sa të vdesë vetë"*. Këto proza do t'i quaja shkrepje momentale fotografike që na sugjerojnë një paraqitje nga këndvështrimi i caktuar autorial. Aq më i rëndësishëm është koncepti etik dhe estetik i vëzhgimit dhe meditimit. Këtu subjektiviteti i autorit të memuarëve përfshin në vetevete interpretimin e orientuar të "subjektivitetit të fatit", vlerësimin tij për dukuri të caktuara historike dhe mishërimin e pikëpamjes filozofike të autorit mbi botën, i cili është thurur me vetëhapjen shpirtërore të shkrimtarit.

Proza të ngjashme në memuaristikën e Mitat Frashërit janë edhe "Një kujtim"; "Në Sinop"; "Netët"; "Doktorrëvet"; "Janllësh Olldu"; "Këshilli ministror në mes të natës"; etj.

Por le të marrim në shqyrtim një cilësi tjetër të prozës memuaristike të Mitat Frashërit, si fillim, përmes këtij fragmenti:

O njerëz, gjithë kështu do të vdesim! Do vijë dita që të mbulohe mi një gropë, që të na kalben e të na bëhen hi edhe eshtrat! Ahere s'na ka për të mbetur gjë nga këto poshtësit' e dheut! Ahere, nga lakmimi, nga ligësitë,

Shkrimi memuaristik i Mit'hat Frashërit

Nga Agron Tufa

poshtërsitë, djallëzitë, marrëzitë, s'do të na mbesë fare gjësend; vetëm një kujtim do të mbesë te njerëzit: si lum ata që do të kujtohen për të mirë, si mjer' ata që do të zihen ngoje për të ligë! Si mjer' ata që kanë qenë të ligj si lum ata që kanë qenë të mirë! Perëndia do na njohë gjithë punët.

Është një pasazh elegjiak, liriko-filozofik i shkëputur nga "Vdekja e Naimit", e para dëshmi autentike mbi poetin e madh, që na e përcjell Mitat Frashëri. Të tillë ishuj lirikë e mediativë e zbukurojnë prozën memuaristike të Mitat Frashërit, duke e ngjyrosur përcjelljen e dëshmitë me koloritin e përjetimeve subjektive, përshkrimeve ambientale apo portreteve e reliefeve të gdhendura saktë në kujtesën e kohës dhe vendit. Për herë të parë kemi mundësinë nga memuarët e Mitat Frashërit të ndeshim detaje konkrete nga nga jeta e e Naim Frashërit- njeri, jo thjesht ikonë poetit dhe apostullit kombëtar: *Dëftente vetë se qysh një herë, që ishte vendosur rishitazi në Tophane, në të përpjetën e quajtur Defterdar, nuk gjente dot shtëpinë mbrëmjeve dhe do të kishte fjetur jashtë, sikur të mos kishte takuar të vëllanë.* Disa detaje të tjera e zbresin Naim Frashërin në tokë, njeri si të gjithë, me nerva e shpërthime. Mitat Frashëri na e sjell figurën e Naimit tejet konkrete e njerëzore, sidomos në sitata ambientale, familjare, sidomos në rrëfimin "Naimi dhe vjehrra". Ja një situatë e tillë:

"...durimi i ungj Naimit s'ishte gjithnjë kaq i madh me të vjehrrën. Nganjëherë, edhe ajo, padyshim pas ecjes dhe formës së rëndë, që merrte sëmundja e Naimit, bëhej nervoze dhe e padurueshme.

Një ditë, me një hall të tillë dhe me atë zërin gjysëm të shuar (ahere i kishte përparuar lëngata e grykës), më tha:

- Më vjen, kështu si jam i sëmurë, të ngrihem e ta marr prej këmbë plakën time, ta heq zvarrë gjer te Kurbagal Dere, t'ia fus kokën në ujë dhe ta mbaj gjersa t'i dalë shpirt!

Kujtimet e Mitat Frashërit nuk janë një transmetim i thatë kronike apo raportimi;



ato kanë forcën manjetike të na pëshijnë në një kuadër të gjallë e organik të historisë dhe personaliteteve në rrjedhe të saj. E veçanta e prozës memuariste të Mitatit është cilësia e tyre e veçantë në kapjen, kompozicionin, penelatat e holla e të kursyera, figurativiteti dhe dialogu ekspresiv dhe, pikërisht në këto instrumente të formatimit të kujtimeve ai shkrihet njësh me veten e tij letrare – Lumo Skëndon. Kjo vihet re dukshëm në vizatimin e portreteve të burrave të shtetit, duke theksuar tiparet groteske, si në këto pasazhe:

Ja kryetari, Xhafer bej Ypi, dyzet e ca vjeç, mustaqezi, leshbardhë, shtatvogël, jo i hequr, fytyrën si akordeon, domethënë: kësula mbi vetullat, vetullat mbi syzet, syzet mbi hundën dhe hunda përzier me buzët dhe me mjekrën, sikur një grusht i dhënë majë kokës i ka shtypur turinjët, e ka shkurtuar, përmbledhur. Të folurën e ka hundore, hëm-hëm një zë i flashkur dalë prej hunde. ("Tiranë, 5 nëntor 1922")

Spiro Koleka, ministri i Punëve Botore, shquhet nga një cilësi: kur ha bukë, pësh-tyr përde, më të djathtë ose më të mëngjër.

Thonë dhe se i ndjek shumë gratë, domethënë jevgat, katundaret ose shërbëtoret, se të tijën e ka në fshat. Nja dyzet e pesë vjeç, mbase dhe më pak, pak si i shkurtër, mban erë amvise dhe është ironik.

Në dallim nga letërsia artistike veprat e letërsisë memuaristike bartin në vetvete funksione kryekëput apo kryesisht *njohëse*, pa ndonjë pretendim për novacion special artistik. Megjithatë, në "Kujtimet" e Mitat Frashërit shpesh është e vështirë të dallosh ndonjë kufi të qartë ndërmjet kujtimeve dhe letërsisë artistike. Në kujtime ka më pak rastësi; në to janë shumë më tepër të pranishëm elementët përzgjedhës, pikëprerjet e ngjarjeve. *Kujtimet* janë lloji i dytë i Letërsisë memuaristike. Nga përshkrimi i personazhit historik kalohet direkt në një situatë, të cilën mund ta klasifikosh si letërsi për mënyrën e trajtimit, prerjes dhe karekaterit anekdotik. Është filtri përzgjedhës i autorit, apo prirje e brendshme e shkrimit të Mitat Frashërit? Ja një shembull:

Po harrova të zë ngoje z. Pandeli Evangjeli, ministër i Punëve të Jashtme.

I gjatë, i thatë, me eshtrat e fytyrës të dala, me syze, kur lexon, kryet mbuluar me flokë të thinjur, i zeshkët. Pandeliu ka një fytyrë imponante, me një buzëqeshje naive, kur flet. Po s'ka vetëm buzëqeshjen si ndihmës, më tepër se nga çdo send ai ka gjestet; këto i zënë vendin fjalëve. Ahere, hyjnë në funksion, herë njëra vetëm, herë të dyja; gishtërinjtë marrin pozita të ndryshme: dy, tri bashkë, herë dhe një i vetëm, duke ndërë krahun në lëvizjet e një njeriu që pret një krye, që mbjell një arë, që këput një pe... Padyshim ai që do bëjë dëkcionarin, çelësin e gjesteve të ministrit tonë, do t'i ketë bërë një shërbim diplomacisë shqiptare. Dhe kush e di ndonjë prej përfaqësuesve të huaj nuk ka zënë që ta bëjë këtë vepër.

Pa duart dhe gjestet Pandeliu mbetet memec. Një ditë në Paris, në Rue d'Arton, na bënte një këndim gazete, duke rrahur masën e çdo fraze, e çdo fjalë me dorën e tij të djathtë, të cilën e ngrinte me gjithë parakrahun dhe e lëshonte si një çekiq mbi tryezë. Vajçë dhe ia zura krahun, ia çaktivizova dorën. U mërzi pak, po përnjëherë mendja i gjeti një pjellori dhe atë që bënte me krahun, filloi të bënte me këmbë, edhe në çdo fjalë nxirrte një tingëllim, siç e kanë zakon shumë njerëz, kur bie muzika. Vajta dhe i vura dorën mbi gjurin. Vazhdoi të këndonte gjysmë radhe, pastaj ngeci, qëndroi. "Po mor Zot, ose dorën ose këmbën lërma, si m'i zure që të dyja, si të lexoj?"

Në kujtimet e Mitat Frashërit, portretet e personaliteteve zënë një vend të veçantë. Këto kujtime të përcjella përmes përshkrimit të imët të tyre, na i vizualizojnë për herë të parë tiparet e tyre fizike, duke i ulur me këmbë në tokë, përkundër përfytyrimeve që lindin nga protagonizmi i tyre historik apo politik. Pasi përshkruan një sërë personalitetesh të parlamentit, Mitat Frashëri bën dhe portretin e tyre grupor, kolektiv:

Fjalë, prapë fjalë, akoma fjalë! Mund të themi se një deputet në Shqipëri definohet kështu: "Një njeri, të cilit i jepet rroga që të flasë". Jo makar kot, por kurdoherë kot.

Duhet pranuar një e vërtetë: sado i fuqishëm e me domethënie historike qoftë një personalitet, jo çdokush mund të shkruajë kujtime. Kujtimet si zhanër, kërkojnë një karakter të posaçëm, të paprekshëm prej sumundjes së megallomanisë, mitomanisë, apo delireve të tjera. Mitat Frashëri duket se është nga ajo prerje njerëzore që mban, si të thuash, flluskën e e nivelës në qendër, pa i shkarë skajeve. Alergjik ndaj ekzagjerimeve, karakter i esëllt, skrupuloz, ai na ka përcjellë përmes një stili të këndshëm e të thjeshtë diksionin e tij intim e mirëbesues, shpesh herë përmes humorit paradoksal e grotesku, duke mos e kursyer as veten e vet, sidomos pas serisë së portreteve të ministrave në "Kujtime 1912":

Po mbarojmë te Mid'hat bej Frashëri, ministri i Punëve Botore. Në mes të tridhjetë dhe tridhjetë e pesave, i gjatë, sykaltër. Rri me një xhakëtë udhëtimi, me kollan në mes dhe gjithnjë me pëshëllka në këmbë. Pas Myfidit dhe Gurakuqit, Mid'hati është i treti që i mba-



1 Pratt S. Lydia Ginzburg and the Fluidity of Genre // Autobiographical Statements in Twentieth-Century Russian Literature / Ed. by J.G. Harris. Princeton: Princeton University Press, 1990. P. 207—216.

het goja kur flet, po i treti edhe nga shkalla e kësaj të mete. Në xhep ka gjithnjë kartë e kalem dhe shumë herë e shohin seç shkruan, seç shënon: thonë se mban shënime çdo ditë, rri në një shtëpi me Abdi Toptanin dhe më një shok tjetër, Mustafa Krujën. Por s'do mysafirë dhe qahet që nuk e lënë të qetë në mëngjes të shkruajë dhe të punojë.

Memuaristika e Mitat Frashërit është larg së qeni himnizuese apo glorifikuese. E tërheqin sidomos dukuritë negative, prirjet e mprapshta të karakterit fatalist, ditshkurtësia e gjykimit dhe rënia lehtë pre e demagogjive. Një ndër prozat që e shpalos këtë fatalitet ciklik, si ndonjë mallkim, është situata e turbullt politike e rebelimit haxhiqamilist në "Kujtimet e motit 1914". Pri-jësit esadistë e haxhiqamilistë, mes të cilëve autori i kujtimeve ka hyrë në rolin e negocia-torit, të tmerrojnë me bindjet apriori. Ja disa si argumentojnë ata:

- Jemi me Esatin se ai do osmanllinë. Nuk e duam Aqif pashën se ai mban anën e shqipes dhe të Shqipërisë!

- Esati na mbushi torbën me pak më tepër bukë, atij i bëjmë shërbim.

- Unë për dymbëdhjetë mexhitka të bardha vras një njeri! Tani më thoni të vras kë të doni!

Po i thoshte këto fjalë me thjeshtësi si një gjë pa ndonjë rëndësi.

-Po të të japin të tjerët mexhitka për të vrasë një prej nesh, cilin vret?- i thashë.

Na shikoi të treve, pastaj me një të qeshur të hollë:

-Pasha Zotin, ty të vras, tha, ti se e ke gojën të ashpër.

- Nuk duan shqipen dhe Shqipërinë, se shqiptarët xhamitë në Elbasan i kanë bërë kisha! S'bëhemi shqiptarë, se shqiptarët marrin motrën, mëmën, çupën e tyre për grua!

Shqipëria që përshkruan në kujtimet e veta Mitat Frashëri, duke filluar nga kryeqyteti gjithë baltë, njerim, ujëra të zeza e injorancë, deri tek provincat e rebeluara që paraqesin në vetvete trekëndsha bremude në miniaturë, është ai realitet çmeritës ku grihet pandërprerë idealizmi i intelektualit që kërkon ta shohë atdheun e vet shtet normal të qytetëruar dhe moskuptimit dhe paragjykimit me të cilën pritet ky idealizëm. Më saktë këtë konflikt e përshkruan një episod në kujtimet e Mitat Frashërit për vitin e turbull 1914:

Një herë qiraxhiu ynë më tha kështu:

- Epo, sido të jetë, ju bejlerët me fitim jeni nga kjo Shqipëri!

Më qëndroi gjaku në rremba. Domethënë ky i gjojë e sheh veten të gënjer dhe neve në fitim, mbase në dëm të tij.

- Dëgjo, mik, i thashë, a më sheh mua? Jam rritur në Stamboll dhe atje kam rrojtur. Prehjen që kam pasur atje, kurrë ndonjëherë s'e gjej dot këtu; rrogën që kam marrë atje, fort vështirë që ta gjej dhe këtu. Më sheh, jam në kalë me samar; atje isha me shemendëfer, me vapor të bukur, me karrocë të hijshme dhe me tramvaj. Ato shtëpi, ato teatro, ato librari, ato rroba, ato plaçka që gjeja në Stamboll, atë ëmbëlsi rrojjeje, Shqipëria do edhe njëqind vjet që t'i gjejë. Unë, pra, për veten time dhe nga pikëpamja lëndore, kam humbur, po kam fituar një gjë të madhe moralisht; dua të shoh Shqipërinë të lumtur, dua të them, që ty duatë të shoh si jam unë dhe unë të bëhem si je ti. Edhe ti, or i mjerë, do të kesh gjithë fitimet: ti do të gjes një shtet, do të gjes një qeveri, do të kesh një rrugë dhe një urë, do të çosh djalin tënd në shkollë dhe ai djalë do të bëhet njeri!

S'e di nëse qiraxhiu më kuptoi. Apo me vete të tij thoshte: "Ky do të ketë ndonjë djallëzi, që kërkon të më gënjejë!"

Për të gjithë ata lexues, që duan të kenë një ide të jetës politiko-intelektuale në hapat e parë të shtetit shqiptar, "Kujtimet" e Mitat Frashërit u ofrojnë një album autentik. Si të gjitha veprat e mirë të memuaristikës, që shpalosin "frymën dhe kuptimin e kohës"², edhe në këto kujtime e kemi këtë shpirt, këtë frymë të kohës në një kontekst të vështirë historik.



VIKTOR EFTIMI

Rrëfimet e xhaxha Janit

Përktheu nga gjuha rumune: Pandi Bello

Vija nga Klisura në Drenovë, dy ditë rrugë. Kisha dëgjuar se këtej ka më shumë gjah nga gjetkë, por shpresat m'u shuan më shpejt se sa besoja. Gjaj nuk para kishte në Drenovë, por histori për gjahun kishte shumë. Sidomos njëri, xhaxha Jani, roja plak i pyllit, dinte shumë ndodhi, të tija dhe të të tjerëve.

Xhaxha Jani ishte një njeri i shkurtër, me rrudha dhe me mjekër të ashpër. Mollëzat e kërcyera të faqeve i mbulohehin gjithë ditën nga tymi i një pipe qelibari, që e shtërngonte në anë të gojës; shfrynte tym të dendur dhe fliste shumë, pa e hequr pipën nga goja.

Kishte shëtitur shumë. Gjithë ditën merrej me mua dhe sa herë më gjente vetëm, më tregonte. Në fillim, për të qënë i sjellshëm, e dëgjoja, veçse më pas fillonte të më dhimbte koka dhe ikja në një arë poshtë fshatit, ose në lëndinat me mana, pranë lumit. Merrja dhe pushkën me vete, jo për të gjuajtur kushedi se çfarë, por që ta kisha si shok në rrugëtim. Më ishte bërë zakon aq sa nuk mund ta lija të ndryshkej në ndonjë qoshe. Me pushkën në sup vërtitesha orë të tëra përreth Drenovës dhe kujtoja me trishtim ditët e shkuara. Nganjëherë, muzgut, shtrihesha në bar, në lëndina me duart nën kokë. Me sytë drejt copave të qiellit blu, të thurrura mes gjetheve të gjelbra të manave ëndërroja deri sa lëshohej nata.

Sa mirë ishte ashtu! Atëhere nuk dëshiroja asgjë. Më mbushej shpirti me një paqe të thellë, gjithë kthjellësinë e qiellit e ndjeja në gjoksin tim.

Hijet e gjetheve të trasha, lëkundjet e barit nga era e lehtë e mbrëmjes, rrëshqitja e ndonjë reje të vogël larg, shpër gjetheve dhe mërmërima këtu e zhurmshme, atje fëshfëritëse e rrëkesë m'i shpërndanin të gjitha mendimet dhe mallin.

Asgjë s'pati rëndësi për mua deri atëhere dhe nuk e dija ç'më priste më tej. Më mjaftonin ato pjesë të qiellit të kthjellët, plotësia e gjetheve të gjelbra dhe qetësia e thellë e buzëmbremjes.

Por mjaftonte të dëgjoja fluturimin e trembur të ndonjë guguçeje, ose ndonjë zhurmë të lehtë midis gjetheve dhe hidheshja përpjetë. Shtërngoja shpejt hekurin e ftohtë të pushkës dhe çohesha për

tu ulur përsëri i turbulluar dhe i pezmatuar. Ku isha ?

Po ku janë bredhat pa fund të pyllit të dashur ? Ku është hija e rëndë e korijes me dhiaret e thella të mbuluara nga gjethe të harkuara si një tynel misterioz ?

Ç'u bënë orët e magjishme të pritës në kryqëzimin e ulicave, anës burimeve, kur kërcëja nga thyerja e një shkarpe dhe kur shkërmoqja e një gjetheje nga ndonjë kafshë e egër më ngjante me zhurmën e hatashme të një pylli të flakëruar ?

Ah ditë vere të tretura në pritje të gjata deri në orët e muzgut, sa më mundonin me kujtimet e tyre !

Shikoja brinjën e përkulur të malit me peshën e rëndë të bredhave të mëdhenj, me mëshëknat e vogla mbi gjethet e të cilave shkëlqenin bulëza vese, shikoja qilimat e gjërë të gjetheve të verdha, të lagura, të përzjera me degë të zeza dhe me gurë plot myshk, shikoja fijet e arta të diellit në muzg, që depërtonin përmes sitës së bredhave dhe përthyeshin në gjithë bulëzat e gjetheve të mëshëknave, dëgjoja si kërcisnin degët; ndjeja si më

rrihte zemra dhe si më nguleshin sytë të koka e ndonjë capit të egër ; dëgjoja ushtimën e tmerrshme të pushkës që trondiste të gjitha hapësirat e pyllit duke jehuar gjatë dhe larg dhe duke u shuar kushedi se ku.

Tashmë isha si një perandor, të cilit i a kishin plaçkitur të gjitha thesaret.

Duhet të mjaftohesha me manat e vogla, me barin e lëndinave dhe me mëllënjat që nuk guxonin të kalonin andej.

Në netët me hënë dilja në fushë, fshihesha në hijen e ndonjë kumbulle dhe kujtoja se isha në pyllin e Klisurës, gati-gati të shtija mbi çetën e drerëve të dalë në kullotje.

Mesditët e verës më mundonin tej mase. Asnjë fëmijë nuk vraponte nëpër lëndina. Njerëzit korrnin. Ishte vapë dhe mali digjej ditën si një furrë dhe lëshonte një nxehtësi sa dukej sikur shiheshin flakët. Qielli sikur kishte marrë ngjyrë të bardhë, gjithë diell dhe pa gjurmë resh. Nuk shihje askënd.

Gjithë njerëzit kishin punë.

Vetëm xhaxha Jani s'kishte çfarë të bënte dhe me që e dinte se isha vetëm, më kërkonte gjithandej. Ç'bredh gjithë ditën me atë pushkë ? - më thoshte ai, pa e nxjerrë pipën nga goja. I dashur, nuk ka më gjah,

ta them unë.

Të kishe parë në kohën time ! Ja e shikon atë kafkë në mes të fushës ? Eshtë prej ariu. Unë e kam vrasë, para trishjetë vitesh. Gjuajta ariun, por nuk e morra mirë në shënjë. Ariu - pas meje. Kur për pak më morri në krahë i futa pushkën në gojë. Ç'kujton se bëri ariu ? I futi dhëmbët në tytë, e kafshoi një herë dhe ra i ngordhur. Ja këtë vrimë e ka bërë ai dhëmbi që shkëlqen në diell. Atëhere të kishe parë, për zotin po ! . . . Unë habitem me ty se lodhesh me pushkë këtej. Unë nuk do ta humbisja kohën, për zoti po ! . . .

Por xhaxha Jani gënjente, sepse dhe atë e shihja me nga një zogëzë të ftohtë në dorë. Madje një herë kishte vrasë edhe një lepur. Atij nuk i vinte mirë se dilja edhe unë për gjah dhe nganjëherë kish më shumë fat se ai.

Njëherë isha shtrirë në një rrap të lartë, pranë kishës të lënë shkretë të Shën Joanit, me mendimin se do ta has ndonjë gargull. Kam mbetur shumë i habitur kur pas një ore dëgjoj diçka të rëndë, që qëndroi në një majë. Zemra më rrihte si asnjëherë. Degët e sipërme tundeshin dhe mes gjetheve pashë kraharorin e gjelbër të një pëllumbi të egër, nga ata të rrallët.

Duke që zogu kishte bredhur shumë, sepse fshehu kokën nën krahë dhe po çlodhej. U ngrita ngadalë dhe mora shënjë. S'kam për ta harruar asnjëherë klithmën e vdekjes së zogut, fëshfëritjen e fshehtë të gjetheve të këputura dhe zhurmën e shurdhuar të pëllumbit që binte në këmbët e mia. M'u duk sikur një pasuri e pafund ra në këmbët e mia, kaq i lumtur isha. Nxitova të marr gjahun, kur një oshëtimë tjetër u dëgjua nga poshtë kishës. Një çast, pastaj edhe xhaxha Jani u shfaq buzagaz me pipën në gojë dhe me një mëllënjë në dorë. Por kur e pa pëllumbin e madh e të bukur u vrenjt dhe ra në mendime. E shihja mirë se i vinte çudi . . .

-Hmm! -thotë ai- . Ke qëlluar mirë. Punë e mirë, për zotin po! . . . Mirë ke qëlluar! . . .

Mua më vinnte mirë, aq mirë sa nuk e dëgjoja çfarë thoshte.

-Por mos kujto se ke bërë ndonjë punë të madhe! - vazhdoi xhaxha Jani. -Ja, po ky rrap mua më kujton një gjah të rinisë. Këtu përreth një farë Ali kishte ca misër. Një herë erdhi të më qahet se nuk e di se çfarë kafshe i hante të mbjellat ; këpuste kokrrat e arrira prej kërcellit, i kafshonte vetëm një herë dhe i flakte që të këpuste të tjera. Unë mendoja : ç'të jetë ? Ndonjë ari, ndonjë derr i egër apo ndonjë qen i egër?

Një natë mbush mirë këtë pushkë dhe hip në rrap. Rreth mesnatës vonë dëgjoj fëshfërimë pas shpine. Kthehem dhe ç'të shoh?Një ari i madh, i dashuri im, sa një dem dhe kur do ta gjuaja dëgjoj një fëshfërimë në anën tjetër dhe shoh një derr të egër, i madh sa një ari. Tani kë të gjuaja se pushka

ime është nga ato të vjetrat dhe nuk mund ta mbush mbi trung ? Të gjuaja ariun më mbetej vetëm lëkura. Të gjuaja derrin më mbetej dhe mishi dhe dhjami dhe dhëmbët . . . Thashë të gjuaj derrin se vlen më tepër. Qëlloj dhe e plagos rëndë. Dhe ç'të shooohësh? Derrin do ketë menduar se e plagosi ariu ; u sul me vrull mbi të dhe e bëri copa-copa dhe ranë të dy të ngordhur, njëri në një anë, tjetri në anën tjetër!

Dhe në vend të një gjahu u ndodha me dy!

Ditën tjetër u bë një tryezë sa e morrën vesh të gjithë. Vetë Aliu, sa besimtar ishte ai, prapë hëngri mish derri.

Lëkurën e ariut e shita mirë në Korçë . . .

Gjueti të tillë them unë . . .

-Ç'thua kështu xhaxha Jani? - thashë unë i çuditur për ti bërë qejfin.

-Kështu është për zotin, të më besosh!

Por sytë gjithë mbi pëllumbin tim i mbetën.

U nisëm pranë e pranë në prag të perëndimit të diellit. Hija e shkurtër e xhaxha Janit prekte ngadalë mbi pluhurin e rrugës hijen e vogël të mëllënjës. Pëllumbi im i ngjante një shqiponje. Kalimthi hodha sytë tek shoku im i rrugëtimit : maste me dhimbje në fytyrë hijet e të dy shpendëve.

Ndërsa kur u ndamë, nuk mundi të ikë pa më thënë :

-Kështu, i dashuri im, mos kujtosh se ke bërë ndonjë punë të madhe! . . .

2 Tinjanov Juri, "Fakti letrar", Fjala prill 2005, nr 232, perkth. A. Tufa

**Flamur! Ja ku bëhet beja!
mblidhe, mblidhe popullsinë!
përparo! zgjerò Shqipërinë!
mer Kosov' e Çamërinë!
të ndih Zoti në beteja!**

Baba Ali Tomori

Hyrje

Zbulimi i dorëshkrimeve të Baba Ali Tomorit (1893-1948), paraqet një nga ngjarjet më të rëndësishme në trashëgiminë tonë shkencore, kulturore, fetare, shpirtërore dhe intelektuale të dekadave të fundit. Ç'është e vërteta, zbulime të tilla më të mëdha apo më të vogla, ka pasur në dekadat postkomuniste të Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë etj., por zbulimet e tilla zakonisht janë përcjellë me komente të karakterit politik dhe madje ideologjik. Praninë e veprës dhe mundësisht dorëshkrimeve të tij prej rreth një çerek shekulli e kishte vënë re njëri prej editorëve, hulumtuesve dhe studiuesve më të përkushtuar të burimeve të historisë së popullit shqiptar dhe kulturës së tij, Mehmet Gëzhilli, kërkimet shteruese të të cilit tashmë janë vlerësuar jo vetëm në Tiranë, Prishtinë e Shkup, por edhe në Harvard (në SHBA).

Duke parë dosjen letrare të Baba Ali Tomorit, zbulimi nënkuptonte tri rrafsh dhe nënrafsh njohëse:

Baba Ali Tomori ishte një nga postrilindasit, i cili me veprën e tij intelektuale dhe shpirtërore, vinte nga fryma naimiane e historisë dhe i jepte brezit të tij një kulturë të re europiane të formuar fillimisht në Zosimea, e të përfunduar në Europë, atje ku Naim Frashëri theksonte se lind dielli: "Dielli lind nga perëndon".

Baba Ali Tomori ishte një nga intelektualët shumë aktivë në zhvillimet politike, kulturore dhe fetare të kohës, i cili edhe me ato pak tekste për gjuhën, letërsinë, kulturën, folklorin, trashëgiminë kulturore, materiale e shpirtërore, historike, fetare dhe çështjet e tjera me interes kombëtar, të botuara, përfaqësonte trashëgiminë kulturore të provinencës kulturore dhe shpirtërore të kohës.

Baba Ali Tomori, ashtu si edhe postrilindasit e provinencës fetare katolike dhe ortodokse, u vu në shërbim të atdheut kur Shqipëria ishte e rrezikuar nga fashizmi, nazizmi dhe madje nga ideologjia staliniste që po i vinte, duke u vënë në shërbim të lirisë së saj.

Baba Ali Tomori dhe koha e tij

Ali Abaz Skëndi, i njohur më vonë si Baba Ali Tomori, vinte nga një familje e shkolluar dhe me formim kombëtar e fetar njëkohësisht. Angazhimi i të atit në jetën ekonomike, politike dhe kombëtare e fetare sigurisht ndikoi edhe në formimin e tij shkollor, intelektual, fetar e kombëtar. Shkollën fillore e mbaroi në Berat, për të vazhduar pastaj në Zosimea, atje ku kishin mbaruar studime shumë nga etërit e Rilindjes Kombëtare, për të vazhduar në Kazan të Greqisë, dhe në Francë.

Gjurmëve të babait, Aliu do të kthehet në Shqipëri në vitet e Pavarësisë, që të merrte në dorë Teqenë e Prishtës, por krimet greke në këtë fshat më 1914, ku u dogj fshati dhe u vranë edhe gratë e fëmijët, bënë që ai të largohej në Egjipt, ku do të vazhonte krijimtarinë e tij filozofike dhe kombëtare në gjuhën shqipe.

Pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore dhe sidomos pas Kongresit të lavdishëm të Lushnjës (1920) Baba Ali Tomori kthehet në Shqipëri dhe i bashkohet djalisë shqiptare me gjithë përkushtimin e tij: duke u vënë në krye të njërit prej institucioneve fetare të Jugut, asaj të Kulmakut; duke marrë pjesë në lëvizjen më progresive qytetare; duke shkruar artikuj jo vetëm me karakter fetar por edhe kulturor, filozofik e intelektual; dhe së fundi, duke marrë pjesë edhe në organizimin e institucioneve politike-ushtarake kundër pushtimit të Shqipërisë gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Duke u vënë në krye të institucioneve fetare ai përmbushte një prej ëndrrave të tij e të babait të tij, që t'i shërbente komunitetit bektashi në Jug të Shqipërisë, duke dërguar atje frymën vëllazërore të këtij besimi. Me ligjërimet e tij në institucionet fetare, me tekstet e tij të botuara në shtypin e kohës, me diskutimet e tij në rrethet kulturore dhe shkencore ai krijonte një paralele gjithkombëtare të këtij shërbimi për fe e atdhe, madje do të thoshim ai krijoi një përmbysje për atdhe e fe, që në përmasa gjithëpërfshirëse ishte organizuar në Veri të Shqipërisë nga komuniteti katolik.

Baba Ali Tomori ishte intelektual i njohur

BABA ALI TOMORI: FRYMA NAIMIANE E NJË BEKTASHIU

Prof. as. dr. Myrvete Dreshaj – Baliu
Prof. dr. Begzad Baliu



i brezit të tij, i formuar në shkollat më të mira të kohës, në Shqipëri, në Greqi, në Egjipt dhe në Francë. Ai njihje thellësisht dhe diskutonte gjerësisht për letërsinë greke e romake duke i krahasuar ato edhe me traditën lindore e perëndimore. Ai njihje mirë dhe e vlerësonte e analizonte poezinë perse, prej të cilës ishte frymëzuar aq shumë bardi i tij Naim Frashëri; ai njihje dhe diskutonte me kompetencë letërsinë greke dhe në mënyrë të veçantë veprën e Homerit, një këngë të së cilës e kishte përkthyer edhe idhulli i tij Naim Frashëri; ai kishte studiuar me përkushtim dhe njihje filozofinë iluministe e letërsinë franceze, veprat themelore të së cilës vazhdon të i shihet si referencë për zhvillimin e krijimit me karakter kombëtar; ai kishte studiuar, e njihje me kompetencë dhe vazhonte ta studioje kulturën e dijen bashkëkohore franceze duke e funksionalizuar atë edhe në tekstet e tij mbi probleme të gjuhës, kulturës, besimit dhe komunikimit; ai njihje dhe adhuronte veprën e Shekspir-it dhe letërsinë angleze e europiane përgjithësisht.

Baba Ali Tomori ishte intelektual i veçuar i brezit të tij, që me punën baritore vazhonte traditën e frymës jetësore, krijuese dhe kombëtare të Naim Frashërit në institucionin fetar ku shërbente. Me ligjërimet e tij sa të karakterit fetar ashtu edhe të karakterit kombëtar, me ligjërimet e tij pranë varrit të Avni Rrustemit dhe të Naim Frashërit, me angazhimet e tij prej babai sa me karakter shoqëror aq edhe me karakter politik në vitet e vështira të atdheut gjatë Luftës së Dytë Botërore, me gazetën "Reforma" të cilën e drejtonte, ai e kreu misionin e atdhetarit të frymëzuar nga tradita e trashëguar e Rilindjes Kombëtare dhe e lëruar nga brezi i tij i viteve '20-'30.

Baba Ali Tomori gjatë viteve '20-'30 me jetën e përditshme baritore dhe me krijimtarinë letrare, të cilën e shkruante kohë pas kohe, me tekstet për çështje të gjuhës, kulturës, letërsisë, folklorit dhe shoqërisë shqiptare, me të cilat merrte pjesë në diskutimet mbi filozofinë kombëtare që duhet ta ndiqte populli shqiptar për kombndërtimin dhe shtetndërtimin e tij, bashkohet me personalitetet më të shquara të brezit të tij, si: me At Anton Harapin për diskutimet e tij mbi çështjet filozofike e etike; me Ndre Mjedën për çështje të njohjes së teorive mbi gjuhësinë bashkëkohore europiane; me Tajar Zavalanin, Vangjel Koçin, Branko Merxhanin e Ismet Toton për diskutimet e tij mbi çështjet filozofike, etike e sociologjike të mendësisë shqiptare etj., me Migjenin, Petro Markon e Nonda Bulkën mbi konceptet ideologjike të së majtës, gjë që do ta dëshmojë me angazhimin e tij në Luftën Nacionalçlirimtare 1939-1945 dhe doemos konceptet e Eqrem Çabejt mbi konceptet Lindje - Perëndim të kulturës shqiptare.

**Vepra intelektuale,
kulturore, shpirtërore dhe
postrilindase e tij**

E parë në tërësinë e saj, korpasi i trashëgimisë letrare të Baba Ali Tomorit përbëhet nga nëntë libra: të botuara nga autori, të përgatitura nga dorëshkrime, apo të sistemuara nga editori dhe zbuluesi i dorëshkrimeve z. Mehmet Gëzhilli. Sigurisht as kjo nuk është gjendja përfundimtare. E pazbuluar mbetet *Dosja e dënimit të tij*, në vitin 1948, "si bashkëpunëtor i anglezëve", brenda së cilës përveç vendimit për pushkatim pritet të gjenden edhe dorëshkrime të tjera me karakter

kulturor, socio-politik e letrar, mbështetur në porosinë e tij të fundit: "M'ruani dorëshkrimet!".

Vëllimi i parë i veprave të plota të tij tani përfshin katër vepra: 1. Poezi; 2. Nefeze dhe gazele; 3. Poezi (përkthime); dhe 4. Këngë popullore. Vëllimi i dytë përbëhet nga katër vepra: 1. Për gjuhën, për folklorin, për letërsinë, kujtime, publicistikë dhe tregime; 2. Naim Frashëri; 3. Xhevre ose mendime, dhe Aforizma bektashinsh të vjetër; 4. Përkthime. Vëllimi i tretë përbëhet nga dy vepra: 1. Për bektashizmin dhe 2. Historia e Bektashizmit shqiptar.

Për natyrën shkencore të dijes dhe dhuntinë krijuese të tij në studimin tonë kanë peshën e tyre të gjitha veprat e tij letrare, kulturore, historike, shkencore dhe shpirtërore. Për gjuhën shqipe dhe leksikon e saj ato përfaqësojnë një korpus të bashkuar të intelektualit, i cili gjuhën shqipe e përdorte dhe e njihje në kontekstin kombëtar, në kontekstin e formimit shkencor në institucionet më të larta shkencore të kohës dhe në kontekstin e përdorimit të saj gjatë një periudhë përpjekjesh të veçanta të djalisë shqiptare për shtetin, kombin, gjuhën dhe identitetin europian të tyre.

Vjershëtori

Vepra e parë hapet me një fjalë hyrëse të Kryegjyshit Botëror Haxhi Dede Edmond Brahimaj dhe e gjithë vepra përmbillet me një përkujtimore nga editori i këtij botimi z. Mehmet Gëzhilli. Në të parën sillet një kujtim e vlerësim brezash, përfshirë këtu edhe Baba Ali Tomorin, ndërsa në të dytin një sintezë e shkurtër e personalitetit të tij të madh, e dijes dhe koncepteve intelektuale e diturore të tij. Vëllimi i parë hapet me krijimtarinë poetike të tij, poezitë për Flamurin, Gjuhën shqipe, Atdheun, besimin, misionin e bardit shpirtëror e fetar, Shqipërinë, ngjarjet historike, dëshmorët etj.; si: *Flamurit të Shqipërisë, Hymni i Flamurit, Kombësija, Feja, Shpresa rron!, Gjuha jonë, Përfundimi i robërisë, Zot i vërtetë, Jeta ime, Dituria e duhure, Qerbelaja, Qëndrimi ynë, Jam fajtor, Himne kombëtare në vend të huaj, Kthyerja në Atdhe, Presidentit të Shqipërisë, Shpirti i vjershëtorit tonë, Jo për fe po për Atdhe, Dasma e kombit, Bilbili, Për dëshmorët të lirisë Kristaqi e Margarita Tutulani, Konferencës së Pezës* etj.

Në kontekstin historik e shoqëror krijimtaria letrare e tij ashtu sikur edhe mendimi intelektual e diturak i tij na e sjellin mesazhin e kohës, të asaj djalisë shqiptare, që me përkushtim unonte për shtetin e ri shqiptar, për identitetin europian të kombit dhe për gjuhën e pasur e të pastër të tij, prandaj nuk është e rastit që edhe përmbledhja e poezive të quhej "Vjersha për djalërin e urtë". Prej motiveve që sjellin, në plan të parë krijimtaria e tij letrare mund të quhet poezi postrilindase, poezi e ndikuar ndjeshëm nga poezia e Naim Frashërit. Në poezinë e Baba Ali Tomorit krijimtaria letrare e Naim Frashërit ka ndikuar jo vetëm me motivet atdhetare, dhe madje jo vetëm me sfondin filozofik të tyre, po edhe me organizimin e strukturës së vargut, rimariumit të tyre dhe madje përzgjedhjes leksikore të saj.

*Se pushtet ke ti o flàmur!
shënj' e shënjtë je, o flàmur!*

*(...)
Zoti madh në këtë baltë
më ka bërë Shqipëtar,
gjuhën shqip t'ëmbël si mjalte
mà ka fal për kombëtar.*

*(...)
Kombëtar të jem gjithmônë
kur se feja s'më ndalon,
"shqiptarizimën" pasha-Zonë*

zemra e shpirti m'i pohan.

E shkruar në një gjendje të re shoqërore dhe kulturore dhe e ndikuar edhe prej krijimtarisë letrare të brezit të ri, krijimtaria poetike e Baba Ali Tomorit, sigurisht është pasuruar edhe me struktura të reja rrokjesore, të vargut, të rimës dhe të leksikut.

*Shum' i shënjt' është ky flàmur,
shum' i shtrënjt' është ky flàmur.*

Apo, poezia që të kujton një nga mesazhet e Naim Frashërit për hapësirën shqiptare të "Bagëti e Bujqësia", një porosi kjo e cila përcjell edhe te disa krijues patriotë të brezit të tij, Aleksandër Stavre Drenova - Asdreni, Hilë Mosi, Mihal Grameno, etj.:

*Flamur! Ja ku bëhet beja!
mblidhe, mblidhe popullsinë!
përparo! zgjerò Shqipërinë!
mer Kosov' e Çamërinë!
të ndih Zoti në beteja!*

Apo, krijimi model i ndërndikimit të krijimtarisë së brezit të tij, Andon Zako Çajupi, Ndre Mjeda, Fan Noli, Lasgush Poradeci etj.:

*Ajo mëndje gjuhë-ëmbël tha:
Kjo jetë është e vëngër
ha e pi sa të jesh gjallë,
kur të shkosh të mos i kesh mallë;*

*Nga majë e Sharrit, majë Tomorrit,
N'atdhen' e bukur të arbnorit,
Dhe nga Preveza deri në Shkodër
Fushë më fushë e kodër më kodër.*

Një nga poezitë e fundit të tij është ajo për dëshmorët e lirisë Kristaq e Margarita Tutulani, të rënë në Luftën Nacionalçlirimtare. I motivuar prej aktit të flimit të vëllait dhe motrës dhe simbolikës së tyre që rrezato atdhetarisht në rininë shqiptare të kohës, ai paraqiti këtu edhe pikëpamjet e tij për një kohë të re dhe për një angazhim të veçantë për Shqipërinë e lirinë e saj, ashtu sikur i kishte shfaqur dikur në krijimet letrare dhe oratorinë e fillimeve të tij krijuese dhe intelektuale për Avni Rrustemin dhe atdhetarët e tjerë të kohës së tij.

**Mbledhësi dhe studiuesi i
këngëve historike**

Në vëllimin e parë të veprave të plota të Baba Ali Tomorit një vend të rëndësishëm zënë edhe dorëshkrimet, në të vërtetë tekstet nga fusha e folklorit. Në punën e tij përkushtuese ndaj kulturës së popullit Baba Ali Tomori, një pjesë të krijimtarisë ia ka kushtuar edhe identifikimit, mbledhjes e botimit të folklorit, të cilin e kishte ideuar duke vendosur edhe parathënien. Për këtë ai kishte arritur në vlerësimin: "Një folklor përbëhet prej këngësh, proverbesh dhe legjendesh, ku pasqyrohet shpirti i Kombit që e zotnon; pjesa e këngëve popullore të Kombit tonë kësi mënyre, çfaq me madhësi si një pasqyrë tejndritëse (transparente) trimërinë, besa-besën, dhëmbshurinë dhe virtyte të tjerë, që përbëjnë karakterin arbnuer".

Prej koncepteve teoriko-letrare që kishte për folklorin dhe trashëgiminë kulturore, materiale shpirtërore; prej përkushtimit në mbledhjen e kësaj trashëgimie; dhe prej mënyrës se si e kishte përgatitur dorëshkrimin e saj, mund të themi se Baba Ali Tomori me komentet, me kërkimet mbi bazën historiko-dokumentare të këngëve, me gjurmimin në etnogjenezën e tyre, me ligjërimin mbi karakterin etnik të paradigms së tyre etj., e bëri kalimin nga

mbledhës dhe botues i letërsisë popullore në botim të specializuar të saj.

Le të theksojmë këtu disa nga këngët e këtij vëllimi që më parë se sa një botim rasti përfaqësojnë një studim rasti a një histori me rëndësi për vetë trashëgiminë e popullit shqiptar. Nëse disa prej këngëve ishin edhe më parë të njohura apo të botuara edhe në vëllimet e mëvonshme të kulturës shqiptare, si *Kënga e Çerçis Topullit*, *Spiro Bellkamenit*, *Smail Qemali n'Evropë etj.*, për veprën e tij dhe për vlerësimin tonë ato kanë rëndësi për komentet me të cilat janë shoqëruar në botimet apo dorëshkrimet e jetura.

*O Çerçis ç'ë bëre mirë
që lëftove Osmanllinë;
mbloodhe djemt' e Shqipërisë
- i dhe shkelmin rrobërisë.*

Një pjesë tjetër e këngëve posaçërisht të njohura nga historia, sikur është kënga *Prishja e vitit 1914*, në botimin e tij zëvendësohet rëndësisht për faktin se historinë e këtij krimi të bandave greke e kishite parë dhe përjetuar vetë ai, prandaj e njihje dhe e komentonte secilin varg të regjistruar sigurisht më vonë, pas kthimit nga Egjipti.

*Fshatratë qajnë me lot,
me dyfek s'ia dalin dot,
ne me pushk' ay me top,
ne më pak, ay më plot.
(...)
Sot armiku është i shumë,
ne përrua, ay lumë,
ne në shtigjet e kufisë
ay në prag të shtëpisë.*

*sadoqë fëmija dhëmben
Skraparasi nuk trëmben:
me dyfek, pa xhephane
turren grekut si rrufë.*

Në ndonjë poezi tjetër, si ajo *Kongresi i Bektashijve* më 1921 në Prishtë, do të shquhet ashtu besueshëm edhe për mesazhin që jep, me faktin se ai ishte njëri prej organizatorëve, prandaj nuk është e rastit që ai do të jetë edhe autori i këngës.

Në këtë rrjedhë, ku më pak e ku më shumë të komentuar dhe ku më pak e ku më shumë të plota e me rëndësi historike, letrare e kulturore për trashëgiminë tonë kanë edhe këngët: *Kënga e Tiranës*, *Kënga e shkrimit shqip*:

*Qëkur doli Abeceja
doli në shesh mëmëdheja.
(...)
Shpirtmëdhenj ata q'ë nxuarë
mëndje-lart' ata q'ë shkruanë,*

*në Stamboll kuvënd' e bënë
shkruan libra gjuhës tënë
Vaso Pasha, Sami Beu,
Vretoja dhe Naim Beu...*

Të tilla, me shënime kryesisht në fusnotë, për përhapjen e tyre gjeografike, si dhe me shënime kryesisht të karakterit leksikografik e dialektor, janë edhe këngët ku më të reja e ku më të vjetra: *Kënga më e vjetër e Rilindjes t'onë Kombëtare*, *Kënga e pleqve*, *Kongresi i Lushnjës*, *Kongresi Kishëtar i Orthodoxsis në Berat më 1921*, *Kënga e Baba Tomorit*, *Smail Lezo Progonati*, *Lufta e Salih Butkës*, *Fejzo Arëza*, *Kënga e Tafil Buzit*, *Baba Meleq Shëmbërdhenji etj.*

Të kësaj natyre, por të vendosura në një shtrat të gjerë kërkimi, vlerësimi e studimi janë edhe dy tekste të tij me shumë interes jo vetëm për përmbajtjen po edhe për natyrën e kërkimit shkencor: *Këngët e popullit dhe Një këngë, një histori*, të përfshirë në vëllimin e dytë të veprës së plotë. Teksti i parë paraqet një kërkim sistematik me karakter monografik, krahasues dhe identifikues të ngjarjeve historike; ngjarjet më me ndikim në jetën kombëtare (Periudha e Skënderbeut, Periudha e Ali Pashë Tepelenës); temave më me ndikim në historinë e përbotshme (Periudha homerike) etj. Po kështu mund të thuhet edhe për tekstin emblemik *Një këngë, një histori*, një model ky kërkimi, i cili fillon me kujtesën popullore për Ali Pashë Tepelenën dhe vazhdon më tej, me mundësi përsiatjeje e kërkimi ndër errësira të kujtesës kombëtare.

Formimi europian i dijes linguistike të tij

Vëllimi i dytë i veprave sigurisht paraqet pamjen më të plotë të vlerave krijuese dhe intelektuale të Baba Ali Tomorit. Nëse në

vëllimin e parë janë përmbledhur tekstet letrare (poetike dhe popullore, si dhe tekstet e shkruara në frymën e letërsisë së bejtexhinjeve, qofshin ato të shkruara qofshin të përkthyer), në vëllimin e dytë është përfshirë gjithë përmasa intelektuale dhe shkencore e kulturës së tij. Nëse me krijimtarinë letrare, si dhe përkthimet e vëllimit të parë, ai dëshmonte natyrën krijuese të tij, dhuntinë letrare të tij, si dhe njohjen e kulturës popullore, historisë kombëtare dhe letërsisë botërore të Lindjes (kryesisht perse), në vëllimin e dytë janë përfshirë tekste, diskutime, vlerësime, kumtime dhe madje studime të shkollës europiane të dijes së tij.

Studimet hyrëse të këtij vëllimi të shkruara madje gjatë gjithë gjysmëshekullit të Pavarësisë (1912-1945), përfaqësojnë vlera të dorës së parë edhe për kohën tonë. Ato janë shkruar me përkushtimin e atdhetarit, sikur shkruanin pothuajse pjesa më e madhe e djalërisë shqiptare, por janë shkruar njëkohësisht me kërkesa të larta dijeje të shkollës europiane, të cilën nuk e kishin zënë pjesa më e madhe e bashkëkohësve të tij. Mjafton të lexohen artikujt *Mbi gjuhën shqipe*, *Gjuha shqipe*, *Reth Fjalorit Shqip*, *Ta njohim mirë gjuhën tonë!*, *Pak fjalë mbi gjuhën*, dhe të kuptojmë përmasën intelektuale, shkencore dhe kulturore të tij.

Prej diskutimeve mbi çështje të caktuara të leksikut dhe pasurisë e saj popullore, mbi trashëgiminë tonë gjuhësore dhe mbi përdorimin e saktë të saj në letërsinë artistike, mbi shtrirjen dialektore të fjalëve dhe mbi rrafshet semantike të përdorimit të tyre; mbi nevojën e përgatitjes së një fjalori të madh kombëtar dhe detyrat e tjera të institucioneve kombëtare në këtë fushë, mbi përparësinë e botimit të një fjalori kombëtar dhe ndikimin që do të kishte fjalësi i tij në ngritjen estetike të shkrimit të veprave letrare etj.

Pasi kujton një deklaratë shpesh të përsëritur të gjuhëtarëve, letrarëve dhe intelektualëve përgjithësisht, se: *"Shqipja nuk është edhe gjuhë shumë e pasur"*, vazhdon me një kundërtëzë: *"...nga ata që do të na dalin përpara në këtë arsye nuk është çudi se disa nëpër ta, mos shtojnë arsye tjetër: "Shqipja e pazhvilluar si gjuhë letrare përmasë kush-e-di sa mijëra vjet, duke u lëmuar me shkrim në epokën e sotshme, ka hyrë jo-keq në fushën e zhvillimit".* Pra, sikur mund të shihet prej diskutimit të tezave të pro dhe kundër atyre që shqipen e shohin si një gjuhë të varfër dhe atyre që te gjuha shqipe shohin një pasuri të madhe kombëtare, Baba Ali Tomori, jep një mbështetje shumë të rëndësishme, madje edhe për kushtet dhe rrethanat tona të sotme. Ai i mëshonte idesë se gjuha shqipe është *"latuar disa mija vjet"*, pra ishte e pranishme, kishte përdorim të gjerë popullor, identifikonte mjetet e përdorimit të përditshëm, shërbente për lutje dhe përmes saj janë krijuar e ruajtur mendime të mëdha filozofike nga kohërat më të largëta deri në ditët tona.

Në këtë rrjedhë është me shumë interes të lexojmë diskutimet mbi reflektimin dialektor, semantik dhe përmbajtjesor e krahasues të fjalëve kombëtare *"lëshë"*, *"plakonjë"*,

"këndqetëz", dhe *"pjesënim"*; në vend të fjalëve të huaja *"virigjinë"*, *"kallogre"*, *"manastir"*, dhe *"kësmet"* ose *"nasip"* ose *"destination"* etj. Në këtë diskutim, si edhe në tekstet e tjera të kësaj natyre, autori reflekton me gjithë njohuritë e tij historike mbi trashëgiminë tonë gjuhësore, si dhe me gjithë diturinë e tij shkencore të nxënë në institucionet vendore e sidomos europiane. Në gjuhësinë shqiptare, tekstet e Baba Ali Tomorit sjellin një pamje të re edhe në këndshikimet shkencore të dijes shqiptare të kohës. Njohja e teorive shkencore të kohës, duke përfshirë këtu me gjasë edhe shkollën sosyriane të sapodalë në rrethet linguistike të Francës, Zvicrës etj., na bënë të kuptojmë se studimi i fjalës mbi rrafshet semantike të folësve, nuk ishte i rastit.

Megjithëse vinte nga një trashëgimi letrare dhe diturake e jashtëzakonshme e Rilindjes Kombëtare Shqiptare dhe sidomos e asaj trashëgimie letrare e diturake e Naim Frashërit, e asaj diturie didaktike dhe filozofike e oratorike e Jani Vretos, e asaj dijeje enciklopedike të Sami Frashërit, e asaj dijeje historike, ushtarake e diplomatike e Pashko Vasës dhe sidomos e asaj dijeje të trashëgimisë popullore të Thimi Mitkos, Baba Ali Tomori e vlerësonte lartë, shumë lartë, trashëgiminë linguistike të Konstandin Kristoforidhit, prandaj e konsideronte shumë të rëndësishme që fjalori i tij të ishte botuar që më parë, madje për natyrën shkencore të tij, para veprave letrare të bashkëkohësve të tij.

Prej artikujve të Baba Ali Tomorit për gjuhën, për trashëgiminë historike të saj, për pasurinë leksikore e semantike të saj, sot mund të krijohet një ide e plotë e përpjekjeve atdhetare, kulturore dhe diturake të tij, për rëndësinë e forcimit të shtyllës së parë të kombit pas ndarjes nga Turqia: gjuhës, identitetit dhe shtetit. Në këtë numër të vogël artikujsh, po me shumë interes për risitë që sjell, kryet e vendit e zë lista e propozimeve të tij të emrave kombëtarë, me titull *Fushata për emrat kombëtar*, te gazeta "Drita", 4 prill 1937, f. 4. Intelektual me kulturë të gjerë kombëtare, me formim kulturor e shkencor për Ilirinë (që në të vërtetë ishte formim i dijes europiane) me formim rinor për kulturën e antikitetit grek e romak, apo pellazgjik, sikur thuhej në periudhën e Rilindjes Kombëtare, me njohjen e kulturës dhe letërsisë europiane në përgjithësi dhe letërsinë frënge në veçanti, me njohjen e trashëgimisë mesjetare shqiptare që ishte formim i tij i vonë por mjaft bashkëkohor, pra me njohjen e kulturës sa të Lindjes aq edhe të Perëndimit, Baba Ali Tomori, në korpusin e propozimeve ka sjellë pasqyrën emërtuese më të rëndësishme të kohës për brezin e ri të shqiptarëve, i cili bënte përpjekje që antropiminin dhe toponiminin kombëtar ta vendoste si një shtyllë bashkimi e formimi etnik.

Përcaktimin e tij shkencor ndaj trashëgimisë ilire, që përfaqëson edhe një shkallë intelektuale të ngritjes së tij kulturore, ai e ka theksuar, te manifesti i tij *Gjuha shqipe: "Në kohën e robërisë së urrejtur, kur çdo njeri ndiqej pa mëshirë vetëm po të zinte në gojë fjalën*

Shqipëri, disa idealistë të çlirimit të popullit shqiptar nga zgjedha shekullore, këndonin larg vendit të tyre meloditë e gjuhës së Ilirëve" (V. II: 14)

Le të sjellim vetëm disa shembuj, të cilët jo vetëm atëherë po edhe në vitet '60-'90 u bënë emra emblematikë, sidomos në Kosovë e ish-Jugollavi:

Emra të periudhës antike: *Akil, Ulis, Piro, Omir, Perdik, Lekë, Klito, Amind, Granik, Arjan, Mollos, Atintan, Dasharet, Dardan, Libur, Filo, Taulan, Dalmat etj.*

Emra të periudhës mesjetare: *Muzak, Aranit, Perlat, Mois, Uran (ose Vrano), Arbanas, Golem, Tanush etj.*

Emra nga formimi i leksikut vetanak: *Parmend, Shpat, Gurro, Petrit, Jetosh, Shqipo, Dijar, Mëndshor, Mundëtar, Agim, Kujtim, Shkëlqim, Dritush, Djellush, Lufto, Fortash, Bredhosh, Lisak, Ditan, Tufar, Pjellak, Njoftar, Urash, Malo, Fushan, Gazmen, Dhurash, Vërtik, Emblem, Ushëtim, Dritho, Gjakmer, Mjaltor, Kreshnik, Dorplot, Hekur etj.*

Po të bëhet një tipologji e prejardhjes së emrave sipas periudhave historike (antike, mesjetare, kohës së re etj.); sipas hapësirave etnografike (mesdhetare, kontinentale, krahinore etj.), dhe sidomos sipas strukturës gramatikore dhe leksikore të formimit vetjak të shqipes, nuk është vështirë të kuptohet përmasa intelektuale dhe linguistike e dijes së tij.

Kërkimet historiko-letrare

Po kështu mund të thuhet edhe për tekstet në fushë të letërsisë. Në qoftë se në librin e parë kishim artikuj kryesisht të karakterit popullarizues dhe të fazës së parë të shkrimeve të tij, në librin e dytë janë botuar tri studime me karakter eseistik dhe monografik, të cilat paraqesin njëkohësisht edhe përmasën intelektuale, kulturore, letrare, sociologjike dhe madje filozofike në letrat shqipe të viteve '30. Në këtë vëllim dalin në pah dy njësi: *Duke kënduar një libër* dhe *Mbi dorëshkrimin shqip-bektashian të Abdyl Saidit*. Studimi i parë është një diskutim brilant për intelektualin Ismet Toto, që ishte bërë shembull i madh për djalërinë shqiptare dhe librin e tij *Mystika e re*, e cila u bë objekt diskutimi dhe vlerësimi e polemike në shtypin e kohës. Studimi tjetër *Mbi dorëshkrimin shqip-bektashian të Abdyl Saidit*, është një kërkim me interes jo vetëm për lexuesin e një gazete, po një hulumtim me i thellë dhe shumëdimensional për historinë e letërsisë shqipe edhe për kohën tonë. Pa dashur të merrem gjerësisht me të dhënat që sjell autori për dorëshkrimin e Abdyl Saidit në studimin e tij, sot mund të themi kërkimi i këtij niveli këmbëngulës i mungon dijes historiko-letrare shqipe. Ky studim jo vetëm mund ta quajmë një xhevahir të rrallë në studimet historike letrare, por ajo që ka rëndësi dhe vlerë unike është aktualiteti i sotëm që ka ai studim për cilindo, shtetar apo qytetar i thjeshtë qoftë.

Një hapësirë të gjerë të vëllimit të dytë të Baba Ali Tomorit përfshin publicistika, e cila më shumë se prej tekstesh bashkëkohore përbëhet prej tekstesh me karakter historik. Në të vërtetë për aq sa publicistika e tij është memoaristike ajo është njëkohësisht edhe e letrarizuar dhe për aq sa është publicistikë bashkëkohore ajo është e pasuruar me përbërës dokumantarizues e historik. Në këtë vëllim publicistikën në të gjitha rrafshet e bashkon dhe e integron kultura dhe diskutimi intelektual i saj.

Theksojmë këtu artikujt *Diogjeni Haritos nd' Athinë*, *Kur erdhë grekërit në Prishtë*, *Fjala e At Ali Tomorit*, *Një vizitë përmbi Fronin e Nalt' të Shqiptariës*, *Për monumentin e Themistokli Gërmënjit*, *Fati i kombeve*, *Kujtime t' ëmbla e të hidhura pas tridhjet e një vjet!!*, *Kur do të flasin psikologët*, *Shtegëtime të rrezikshme*, *Mbi edukatën shoqërore bektashiane*, *Kujtime të kohës 1914-1932*, *Një bisedim mi ngjarjet e Shqipërisë në vitet 1821-1852*, *Kujtime nga vitet 1914-1916*, *Letër Mit' hat Bej Frashërit etj.*, në të cilat shfaqet një anë tjetër e komunikimit të Baba Ali Tomorit me bashkëkohësit dhe historinë.

Vepra për apostullin e shqiptarizëm

Në vëllim e dytë botohet edhe kryevepra e tij e karakterit letrar dhe filozofik për Naim Frashërin, e cila ndonëse nuk e ka strukturën e një monografie mund të quhet një vepër e kësaj natyre. Vepra për Naim Frashërin hapet me një poezi kushtuar *Naim Frashërit*, vazhdon



Zhanri i shkurtër në letërsinë moderne Z dhe bashkëkohore has zhvillime të diskutueshme. Nga njëra anë, ka qenë në gjendje të konvergjojë rreth vetes reflektive dhe kuptime të thella, të zbuluara përmes historive me bukuri absolute dhe ekuilibër të përsosur. Nga ana tjetër, për arsye editoriale vërtet të panjohura për mua, ai konsiderohet prej shumë vitesh një zhanër i vogël, i paafte për të shitur kopje librash, sikur të ishte shkruar me dorën e majtë, në krahasim me zhanrin e referimit të vërtetë dhe të gjithëdijshëm: atë të romanit që përbën tërësinë e botimeve vjetore në Itali – dhe gjetkë.

Personalisht, jam i mendimit se nuk ka zhanër më të aftë për t'u lidhur me realitetin bashkëkohor sesa *short story*. Jetojmë me fragmente, duke ngërthyer me klikime spazmatike ndërfaqet virtuale me të cilat lidhemi me botën, përmes linqeve që na çojnë menjëherë gjetkë, pa qenë nevojë të përfundojmë atë që kishim filluar të lexonim. Tregimi funksionon pikërisht në këtë mënyrë. Lulëzon falë përjashtimeve, presupozon një plotësim instinktiv të kuptimit, përqendron rreth disa detajeve të pashpjeguara plotësisht – dhe, për rrjedhojë, të pashterura në funksionin e tyre narrative – histori ekzemplare, të cilat gjejnë, siç zbulohet në finalen paralizuese, një shpjegim në një çelës filozofiko-ekzistencial.

Por jo vetëm. Në një epokë në të cilën – përjashtuar profesionistët e sektorit dhe pensionistët – koha që i dedikohet letërsisë rezulton vërtet e limituar, ato pak faqe që zë një tregim, krahasuar me mesataren e 150 faqeve të një romani, duket se përfaqësojnë masën më të përshtatshme për kë dëshiron të konsumojë një përmbajtje imagjinate e kulturele në të njëjtën kohë. Një kontekst i aftë të pasurojë ata persona që vendosin të lexojnë, por, pa hequr dorë nga angazhimet e përditshme. Në vend të kësaj, në mënyrë befasuese dhe ndoshta të dyshimtë, sapo kemi parë sesi tregu vendos jo vetëm të shpërblejë romanin, por edhe të favorizojë një tendencë të pashpjegueshme, të krijuar këto vitet e fundit, sipas së cilës vihen në treg vepra voluminoze, në gjendje të kalojnë 500 apo 1000 faqe dhe askush nuk skandalizohet nga ky fakt. Sa persona do të kenë kohë t'i lexojnë seriozisht këta libra?

Mekanizmi i kondensimit të formës së shkurtër dhe historia e saj në letërsinë italiane të Shekullit të Njëzetë.

Pikërisht për shkak të atyre karakteristikave të antagonizmit editorial krahasuar me romanin, të cilat u përpoqa t'i shpjegoj shkurtimisht në hyrje, një përkufizim teorik efektiv për zhanrin e shkurtër mund të lindë vetëm në një paralel të kundërt me formën e zgjeruar. Duke qenë se është qartësuar që nuk mund të jetë gjatësia i vetmi parametër që përcakton dallimet kryesore mes dy mënyrave të rrëfimit, prodhimitaria teorike – veçanërisht e pasur në dy dekadat e fundit – është përqendruar në aspekte të mëtejshme, si ekskluziviteti i ngjarjes së treguar dhe statuti i veçantë i finales. Në fakt, format e shkurtra më efektive sillen gjithmonë rreth episodeve unike, fakteve të spikatura, aventurave të jashtëzakonshme. Intensiteti dhe veçantia e qartë e ngjarjeve të rrëfyera ndihmojnë në krijimin e një tregimi kompakt dhe linear, pa digresione të rëndësishme, në një skemë njëdrejtimëshe që përqendron drejt finales – me një ritëm gjithnjë në rritje – të gjitha përvetësimet më të rëndësishme të kuptimit. Prandaj, nëse romani tregon një jetë, një biografi të plotë të një personazhi, forma e shkurtër do të kujdeset të tregojë vetëm një fragment të saj. Nëse romani ka si ambicje të grumbullojë shumë fakte rreth ngjarjeve themelore, forma e shkurtër do të interesohet për një fakt të vetëm. Nëse romani e shpërndan peshën e fabulës në disa faqe, forma e shkurtër do ta mbledhë atë, duke e zhvendosur në mënyrë të pashmangshme drejt faqes finale. Në këtë teknikë, e cila favorizon një përshpejtim të kondensuar të ngjarjeve dhe frekuencave, luhet ekuilibri thelbësor i tregimit.

Në mënyrë absolutisht të përmbledhur



UDHA E DORËS
Rubrikë e përdyjavshme mbi letërsinë italofone shqiptare
DR. FABIO. M. ROCCHI

**EPISODI I DYMËDHDJETË.
FORMA E SHKURTËR
NË PANORAMËN
E NARRATIVËS
ITALOFONE. HISTORI
TË SHKURTRA QË
ARRIJNË TË RRËFEJNË
VETËM NJË GJË.**

Nga Dr. Fabio Rocchi

dhe jo të plotë, do të doja të shpërfaqja disa reflektime pa ndonjë rend të veçantë për zhanrin e shkurtër, mbi të gjitha në lidhje me vendin tim të origjinës. Le të marrim rastin e Italisë, duke pasur parasysh traditën e saj narrative të Shekullit të Njëzetë. Përballë një serie të konsiderueshme tregimesh të shkurtra – nga novela e deri tek *short story* bashkëkohor – që u mundësoi autorëve të kanonizuar si Pirandello, Tozzi, Svevo dhe Calvino (vetëm për të përmendur disa) ta bënin tregimin element thelbësor në veprën e tyre, vitet Dymijë duket se konfirmojnë një përmbyse në lidhje me konceptin e zhanrit. Në fakt, qysh prej fundit të viteve Nëntëdhjetë, tregimi gjendet i vendosur në një pozicion marginal të tregut editorial, deri në atë pikë sa të arrijë të kushtëzohet vetë instinktin krijues të autorëve, të cilët, gjithnjë e më tepër kanë vendosur të mos aplikohen në këtë formë; aq sa nuk ekzistojnë më autorë italianë që shkruajnë vetëm tregime, siç ishte Tondelli në vitet Tetëdhjetë për shembull. Edhe kur ekzistojnë (të shkëlqyera tregimet e Francesco Pecoraro, sot tetëdhjetëvjeçar), janë të konceptuara në mënyrë absolutisht spekulare dhe paralele me logjikën e romanit, duke nënkuptuar me këtë një mungesë të vrullit eksperimental në ato që konsiderohen versione në miniaturë, të reduktuara, krahasuar me fabulat romanceske.

Por nuk ka qenë gjithmonë kështu. Duke filluar nga vitet Pesëdhjetë e në vazhdim, tregimi i autorit (Fenoglio, Moravia, Bassani) ka pasur padyshim një fizionomi shumë tradicionale, armiqësore ndaj çdo hipoteze eksperimentimi narrativ. Ishin vitet Gjashtëdhjetë ato që shndërruan këtë ekuilibër: avangarda e re e shtriu kushtëzimin e saj edhe në formën e shkurtër – nga Malerba e Manganeli deri te Calvino kombinatorik – duke e transformuar tregimin në një laborator në të cilin testoheshin

zgjidhje të reja narrative. Shkurtësia lejonte ndërtimin e teksteve krejtësisht anti-narrative ose, gjithsesi, të lindura për të zhgënjyer pritshmëritë e lexuesit. Një prirej e tillë konfirmohet – madje ndoshta edhe theksohet – në kontekstin letrar të shekullit të ri, të karakterizuar nga imperativi i romanit si formë shprehëse e një shoqërie që dëshiron të përshkruajë veten përmes një përfaqësimi sa më gjithëpërfshirës e të dallueshëm që në pamje të parë, pa pretenduar ama përpjekje të tepërta interpretimi nga lexuesi.

Pra, për ta përmbyllur: formës së shkurtër i caktohet edhe një herë sot një vlerë eksperimentale krahasuar me ndarjen në zhanre që rregullon ligjet e krijimit të romanit, duke iu referuar një praktike narrative të afirmuar në vitet Gjashtëdhjetë dhe rikonfirmuar nga disa raste shumë interesante të njëzetëvjeçarit të parë të viteve Dymijë, me emra si Giorgio Vasta, i ndjeri Vitaliano Trevisan, Giorgio Falco e Vanni Santoni.

Po shkrimtarët italofonë me prejardhje shqiptare, argument i studimeve të mia prej fundit të vitit 2018 dhe mbi të gjitha subjekt i kësaj rubrike, si janë sjellë në momentin kur kanë vendosur të vihen në provë me zhanrin e shkurtër?

Përmbledhje tregimesh që i shmangen temave standarde dhe sjellin një koralitet të ndryshëm nga ai i romanit.

Ndërkohë që botuesit promovonin formën e romanit duke detyruar autorët italofonë të thurnin histori "emigrantësh" që trajtonin kryesisht aspekte biografike dhe përkujtimore të protagonistit, një rrymë paralele e përbërë nga zëra indiferentë ndaj kërkesave të tregut, vazhdonte të rrëfente në

mënyrë krejtësisht të pavarur nga stilemat e krijuara nga kjo formë. Në vëzhgimin diakronik të njëzet e pesë viteve të lëvizjes italofone me prejardhje shqiptare, ekzistojnë të paktën pesë përmbledhje tregimesh të cilat, sipas këndvështrimit tim, meritojnë vëmendje, pikërisht sepse kanë dëshmuar një vitalitet dhe shpesh një "ekstravagancë" të vërtetë ndaj temave tradicionale të diasporës.

E kam fjalën për këta libra: *Bevete cacao Van Houten!* i Ornela Vorpsi, i shkruar në vitin 2005 në gjuhën italiane dhe i përkthyer menjëherë në frëngjisht nga shtëpia botuese Actes Sud, para se Einaudi ta sillte në Itali pesë vite më vonë; *Amputazioni prolungate*, i Arben Dedja i vitit 2014; *Briciole* i Alketa Vako i vitit 2016; *Dal tuo terrazzo si vede casa mia* i Elvis Malaj i vitit 2018 dhe, për ta përmbyllur me një vepër e cila përfshihet në mënyrë perfekte në këtë linjë, duke përmbledhur në njëfarë mënyre temat dhe karakteristikat e saj, *Da un'altra porta* i Durim Taçi, publikuar këtë vit. Bëhet fjalë për përmbledhje tregimesh që konsideroj domethënëse dhe që arrijnë të vënë në pah elementë inovativë dhe një vullnet narrativ gjithnjë koherent në brendësi të lëvizjes italfone.

Konceptin "përmbledhje tregimesh" duhet të konsiderojmë si një lloj makrozhanri me funksione të rregulla të qarta. Tregimet i kërkojnë kryesisht ata redaktorë të cilët, nëpërmejt instrumentit të antologjisë, përpichen të ofrojnë një mostër të të rejave që ofron panorama e prozës italiane, duke zgjedhur më së shumti tekste të publikuar në revista të pavarura – të printuara ose online – që përfaqësojnë një magmë pa formë ku mund të kërkohen e të nxirren disa konstante. Përmbledhja, e nënkuptuar si ekuilibër konceptual i përbërë nga një përzgjedhje tekstesh, arrin të jetë e tillë kur përshkohet nga një mendim koherent dhe kur arrin, nëpërmjet shumës së pjesëve që e përbëjnë, të demonstrojë një teori apo të vërë në dukje një mendim i cili është reflektim i një vizioni personal të botës. Kur kjo arrihet, kemi përballë thesarë të vegjël që spikasin ndaj uniformitetit të shkrimeve mbizotëruese, dëshimtarë të një vene rrëfimore të lirë dhe jo të ndërtuar mbi bazën e imagjinareve të referimit të një lloji letërsie e cila akoma sot nuk arrin të dalë përtej gardhit në të cilin e kanë vendosur – dhe ku shpeshherë ka treguar se i pëlqen të qëndrojë. Nëse temat e diktaturës komuniste, të kapërcimit të Adriatikut, linjat magjike të narrativës së fshatit dhe të vështirësisë së përshtatjes ekzistenciale me paradigmat perëndimore dhe kapitaliste të vona kanë zënë pjesën dërrmuese të kësaj letërsie, nga ana tjetër – kryesisht falë formës së shkurtër që i lejon më tepër liri autorëve – gjejmë eksperimente dhe rrëfime pjesërisht të ndryshme.

Tregime që lënë një shenjë.

Në mënyrë krejtësisht personale, e për pasojë arbitrare, do të doja të vazhdoja me citimin dhe një koment të shkurtër të atyre tregimeve që, të zgjedhur në rend kronologjik nga përmbledhjet e përmendura më sipër, kanë arritur të shfaqin në mënyrë të arrirë karakterin e një periudhe kohore dhe njëkohësisht të përfshihen me elementë risie në aspektin formal e atë gjuhësor në standardin e lëvizjes italofone me prejardhje shqiptare. Si premisë, po marr hua një përsiatje të Roland Barthes, i cili shpjegon shumë mirë «karakterin e funksionalitetit» të detajit narrativ, sidomos nëse vihet në raport me tërësinë e tekstit në të cilin bën pjesë (në *Sul racconto*, f. 27-39). Përbërës i strukturave më koherente, detaji, nëse funksionalizohet në mënyrën e duhur, është tregues i një poetike shprehëse që përkthehet në imazhe nisur nga një vullnet i qartë, i përcaktuar më herët. Këtu dua të saktësoj se më shumë se nga gjykimi i vlerës (që i përket një sferë tepër subjektive për t'u bërë objekt i një shqyrtimi kritik) kjo përzgjedhje frymëzohet nga mënyra e ndërtimit të atyre tregimeve që mahnisin për korrespondencën ndërmjet frymëzimit narrativ, që është baza e idesë, dhe metodave formale të përdorura për ta vënë në jetë atë frymëzim, pra për ta përkthyer në faqe letrare.

Po filloj me shkrimtaren e parë në absolut që ka ditur të çndërtojë nga brenda qëndrimet dhe pozat e një enkalve letrare që atë kohë, në vitin 2005, sapo kishte filluar të formohej. I referohem Ornella Vorpsit dhe tregimit të saj *Della bellezza* (*Bevete cacao Van Houten*, 2005). Nga ajo përmbledhje – vepra më e mirë e Ornelës sipas meje, e destinuar t'i rezistojë kohës – mund të përmenden shumë tregime të rrallë për nga bukuria dhe pastërtia formale. *Lumturi disparue*, *Mauro di via dei Gracchi*, *Storia di una pensione*, *Venerdì sera*, *Storia di scarpe*: në secilin prej këtyre fragmenteve mund të perceptohet origjinaliteti i vështrimit të rrëfyesit, një vështrim i depozituar në hapësirën rrethuese, që arrin të zbulojë dinamikën dhe mekanizmat shoqërorë falë përkatësisë vetëm të pjesshme në vendin ku është shpërngulur. Këndvështrimi i *tjetrit*, i të huajit i cili nuk harron se ngelet gjithmonë i tillë, tregon pa filtra gjithçka që i shfaqet para syve, duke dhuruar reflektime që marrin jetë nga pranëvënienë të padëgjua më parë, arsye për të cilën rezultojnë zbuluese. Është pikërisht ky rasti i *Della bellezza*, në kontekstin e së cilit shoqëria multietnike që po vetëdijësohej pikërisht në ato vite në Itali përzihet me nevojat e një komuniteti të ri – atij të *njerëzve të natës* siç quheshin në vitet Nëntëdhjetë, ngushtësisht i lidhur me botën e diskotekave. Bëhet fjalë për një komunitet thellësisht hedonist, i fiksuar e i varur ndaj arteve restauresive të kirurgëve plastikë, të cilët, nëpërmjet konsumimit të pamasë së silikonit, modelojnë format nga brenda dhe kanë fuqinë të përmirësojnë përkohësisht papërsosmëritet estetike. Përpjekja për t'u dukur të bukur me çdo kusht përkthehet në tregimet e Vorpsit në një koralitet të shpërbërë e të përballur me vetminë, të fiksuar nga kulturi i imazhit të vetvetes dhe erotizimit të vazhdueshëm të një trupi që ngelet pezull mes dy ekstremeve, atij të narcisizimit dhe pornografisë. Të ndërjerit i izoluar edhe pse jeton në një grup është në fund të fundit një nga temat e mëdha të letërsisë bashkëkohore. Dhe kur një hallkë e dobët e zinxhirit, e gjora Lolly, shkëputet, duke u zhdukur në moshën njëzetë e shtatë vjeçare pa lënë asnjë gjurmë, dhimbja ekzistenciale që përmban kjo histori ndihet në të gjithë shkretimin e saj.

Krejt i ndryshëm paraqitet rasti i Arben Dedja, i cili me tregimin *Piccole esplosioni* (*Amputazioni prolungate*, 2014) na dhuron një tekst të përkthuar nga një humorizëm i tipit iluminist dhe një kulturë e thellë, në harmoni të plotë me shifër stilistike që dallon të vetmin autor italofofon, i cili, për momentin – bashkë me Alketa Vako – ka praktikuar vetëm zhanrin e shkurtër, duke i qëndruar larg arkitekturës së romanit. Tregimi është shumë i thjeshtë për t'u përmbledhur: flet për rastet në të cilat gazrat natyrore të lëshuar prej pacientëve gjatë operacioneve kanë shkaktuar aksidente apo shpërthime të vogla në momentin që kanë rënë në kontakt me shkëndijat e bistorive elektrike. Nëpërmjet një lidhjeje tipike të historive të trilluara, të animuar nga kujtime erudite, përfundohet në qytetin e Padova të Shekullit të Katërbëdhjetë, në Kapelën Scrovegni të afreskuar nga Giotto dhe, ndoshta, të referuar nga Dante në një varg të famshëm – dhe të çuditshëm – nga Ferri. Ndjenja e gjallërisë dhe e bollshmërisë së arsyetimit të narratorit që bën të mundur kalimin nga tema të parëndësishme në disertacione të ngritura në vetëm tre faqe, të shkurtra dhe mjeshtërore, janë absolutisht të paprecedentë në panoramën italofone, shumë të këndshme për t'u lexuar, ashtu si shumë tregime të tjera të shkurtra shkruar nga Dedja.

Në *Vita morte e miracoli di Xhufi* Alketa Vako (*Briciole*, 2016) rrëfen nëpërmjet syve të një vaje viktimë të patriarkatit, historinë e shkurtër të një qeni, i cili hyn në familje si një leshator i hijshëm për t'u transformuar shumë shpejt – pothuajse në osmozë me babain padron që e kishte burgosur – në një bishë të egër. Natyra e pakuptueshme e ndërjegjes së kafshëve mirëmenaxhohet nga fillimi në fund, në një sërë personifikimesh që e bëjnë bishën të ngjashme me njeriun, duke e mbivendosur viktimën mbi xhelatin, ndërkohë që përmasë një *unicum* – përmbledhja është e orientuar drejt vënies në skenë të situatës së një feminiteti që vuan nga maskulli deri në atë pikë sa ndonjëherë dhuhet brutalisht – Vako arrin të krijojë një diversion shumë efikas.

Në *Luomo con la cravatta con un motivo a fiori* (*Dal tuo terrazzo si vede casa mia*, 2018) asistojmë në vëzhgimin e një burri – një vetëvrësës potencial ndoshta, ose gjithsesi një i huaj i margjinalizuar – që zvarritet nga njëra anë e një periferie industriale në tjetrën, ulur në ndenjësën e një autobuzi, ndërkohë që protagonistja Vera bisedon me zë të lartë me shoferin, mike e saj. Moskockëçarjes së dy mikeshave i kundërvihet vështrimi i burrit, i fikur, i heshtur, i pafjalë, që spikat vetëm për informalitetin dhe papërshtatshmërinë e kravatës së tij. Prezenca e tij përvijohet, në mënyrë paradoksale, në mungesë batutash, me përjashtim të një të vetme që shqipton në fund. Ky detaj na lejon të vlerësojmë aftësitë përshkruese të Elvis Malajt të hershëm, i cili në atë libër demonstroi të zotërojtë një talent të madh, veçanërisht në ndërtimin e situatave paradoksale, të pasura me tensione të fshehura, gati për të shpërthyer. Nëse njëri nga qëllimet – krejtësisht i arrirë – e përmbledhjes së tij të tregimeve është padyshim ai i përshkrimit të shoqërisë italiane, barra e një ekzistence pa një synim (ajo e Altinit, burrit me kravatë) i sillt publikut në mënyrë të përkryer në një seri të pathënash e implikimesh. Janë gjurmë që i dorëzohen lexuesit në mënyrë që fantazia e tij t'i plotësojë.

Pra, në terma teorikë, tregimi i Malajt plotëson kërkesat e nevojshme për të pohuar se jemi në prani të një proze që i atribuohet zhanrit të shkurtër. Thelbësia e historisë, rindërtimi vetëm i pjesshëm i fakteve, detaje të pazgjidhura nga të cilat mund të nënkuptohet konteksti, një finale enigmatike që mbërrin pas një zhvillimi të përshpejtuar ngjarjesh të vogla, të mbyllura në një hark kohor të kufizuar. Thesoj sërish këto elemente sepse jo gjithmonë, edhe pse në prani të një numri të kufizuar faqesh, mund të pretendojmë se kemi të bëjmë me një *short story* apo një tregim. Ndodh për shembull qe përmbledhja e bukur e publikuar pak muaj më parë nga Durim Taçi (*Da un'altra porta*, 2023) të përmbajë në brendësi disa tekste të shkurtër por përsosmërisht të përmblyllur, arsye për të cilën i atribuohen formës së romanit dhe jo asaj të tregimit. Nëse analizojmë rastet e *One Up* dhe të *Labito*, ndoshta edhe të *Dollia*, një ekzistencë e tërë, ajo e protagonistëve, e ndërthurur me jetët e personazheve të tjerë plotësues, arrin të përvijojë një ngjarje të përfunduar dhe tërësisht të shpjeguar, e tillë që rezulton në konflikt me teorinë e formës së shkurtër. Ndërkohë që tregimi *Sulle tue orme* mund të veçohet jo vetëm si shembull i përkryer i tregimit bashkëkohor, por ofron edhe disa sugjerime interesante mbi një tjetër aspekt të formës që është antitezë e romanit: aftësinë e saj për të tërhequr stilema nga zhanre të tjera narrative të kodifikuara gjerësisht. Në këtë rast gjejmë të shkrirë në tregim elementë të denjë për një *spy-story* dhe një finale sugjестive të hapur, prej së cilës historia mund të vazhdojë në shumë versione të mundshme. Në të njëjtën mënyrë, është lehtësisht e dallueshme shifra mbizotëruese e shkrimit të Taçit: rrëfimi në vetën e dytë.

Janë veç disa shembuj, që dëshmojnë ama, edhe një herë, pasurinë e varianteve dhe sipërfaqet e shumta të nënvizuara nga lëvizja italofone me origjinë shqiptare. E vëshguar në tërësinë e saj, siç kam patur mundësi të bëj në raste të mëparshme, shfaqet si një nga fenomenet e reja më domethënëse të letërsisë italiane të dhjetëvjeçarëve të fundit, sidomos po të konsiderojmë numrin e autorëve dhe veprave. Një komunitet vërtet i gjerë shkrimtarësh të ardhur nga të njëjtat troje, në një moment të caktuar ka marë fjalën – në një gjuhë të adoptuar – dhe ka arritur të futet me origjinalitet në një sistem editorial që në atë periudhë po ndryshonte disa prej zakoneve të veta socio-kulturore, në njëzetëvjetorin e parë të viteve Dymijë. Dhe, për të ofruar prova të mëtejshme mbi këtë pasuri, në të cilën mahnisin burimet stilistike, transformimi krijues i gjuhës dhe përdorimi i zhanre të ndryshëm, në dy episodet e ardhshme do të braktis përkohësisht fushën e narrativës për t'u përqëndruar në zërat italofofonë që janë shprehur – gati ekskluzivisht – në vargje.

(Vijon nga faqja 7)

me studimin sigurisht më të mirë të kësaj natyre deri më tash *Spiritualizma shqiptare*, një ese kjo brilante për Naim Frashërin; trajtesën *Naim Frashëri dhe bektashizmi*, brenda të cilës si rrallë kund trajtohen raportet e tij me filozofinë panteiste bektashiane; si dhe përmbillet me fjalimin e tij pasionant e nderues për misionarin e kombit, babain e gjuhës moderne, me titull *Apostulli i shqiptarizmit, lëronjësi i gjuhës amtare, predikonjësi i vëllazërimit Naim Frashëri*. Në pjesën e dytë të kësaj vepe naimiane Baba Ali Tomori ka botuar gjashtë studime të përqendruara në gjashtë poezi të zgjedhura, në të vërtetë në gjashtë poezi, të cilat atë kohë dhe më vonë, deri në ditët tona do të përfshihen pothuajse në të gjitha antologjitë më të mira të letërsisë shqipe. Zor të gjenden studime më shumë për poezinë e Naim Frashërit sa për poemthin “Bukuria”. Poezitë e zgjedhura për studim në veprën e Baba Ali Tomorit përfaqësojnë shembuj tipik për kërkimet naimiane atëherë dhe përfaqëson shembuj të tillë edhe për kërkimet e sotme.

Në këtë vëllim sikur mund të shihet, janë përmbledhur studimet: *Naim Frashëri duke kënduar “Jetë-n” te “Lulet e verësë”; Naim Frashëri në këngën “Dita e re” te “Lulet e verës”; Si shprehet te kënga “Besojmë” në librin “Lulet e verësë”; Naim Frashëri në “Lulet e verësë” si e këndon “Bukurinë”; Naim Frashëri në “Lulet e verësë” qysh ligjëron te kënga “Zëmëra”; Naim Frashëri si e hymnon “Ujë e bekuar” në “Lulet e verësë”, kënga “Fyelli”; Naim Frashëri dhe kënga e shënjtë “Perëndija” në “Lulet e verësë”.*

Le të kujtojmë këtu se portreti i parë i Naim Frashërit dhe poezia e parë e botuar në Kosovë (1949) është “Bukuria”, ndërsa studimi i parë i thelluar mbi filozofinë letrare dhe raportet e tij me bektashizmin është bërë nga Profesor Rexhep Qosja në vitin 1961. Nuk e dinte autori i këtij studimi (Profesor Qosja) atëherë dhe nuk do ta dijë më vonë kur e botoi monografinë më të mirë të Naim Frashërit (1986) deri më sot, se poezitë “Zëmëra”, “Jeta” dhe “Bukuria” ishin zgjedhur poezi përfaqësuese për studim në veprën e tij për Naim Frashërin, kur i zgjodhi t'i përfshinte në rrethin e nëntë poezive më të bukura për *Antologjinë e lirikës shqipe* (1970) dhe nuk e dimë nëse Baba Ali Tomori, i ka studiuar dhe i ka përgatitur për botim edhe poezitë e tjera të kësaj natyre.

Prej kohës dhe revistës ku janë botuar nuk është vështirë të vihet re edhe një veçori e tyre: të gjitha të botuara në revistën autoritative “Tomori i vogël” dhe të gjitha gjatë vitit 1942. Nuk e dimë nëse artikuj të tjerë të kësaj natyre do të ketë shkruar edhe për poezi të tjera dhe nuk e dimë nëse kishte planifikuar të shkruante artikuj të kësaj natyre dhe për poezi të tjera të veprës më të mirë të Naim Frashërit “Lulet e verës” apo për vepra të tjera me karakter filozofik, sikur janë *Fletore e Bektashinjet* dhe sidomos poemën e madhe “Qerbelaja”.

Edhe sot, pas shumë studimeve, Naim Frashëri dhe vepra e tij hyjnë në rrethin e shkrimtarëve me bibliografinë më të pasur studimore, është vështirë të gjendet një autoritet shkencor, që e ka sjellë në veprën e tij zanafillën krijuese të poezive dhe veprave të Naim Frashërit, në ato përmasa që e ka bërë Baba Ali Tomori.

Misionari

Në vëllimin e tretë janë botuar dy veprat e tij: *Vepra Për bektashizmin* dhe *vepra Historija e Bektashinjet Shqiptarë*. Në të parën ashtu si edhe në të dytën, Baba Ali Tomori ka sjellë pasuri të madhe intelektuale dhe kulturore për trashëgiminë botërore të bektashizmit si lëvizje historike, kulturore, materiale e shpirtërore në Shqipëri dhe në botë.

Vepra e parë *Për bektashizmin* përfshin kryesisht artikuj të botuar për zhvillimet historike, kulturore dhe fetare të bektashizmit në Shqipëri, në Ballkan dhe madje Europë e Azi; për organizimin e tij institucional, sikur është artikulli *Kongresi i Përgjithshëm Bektashian në Teqe të Prishtës*; për personalitetet e saj më me ndikim në jetën shpirtërore të vendit; për orientimet konceptuale të disa prej personalitetëve dhe institucioneve bektashiane; për reformat fetare e institucionale brenda kësaj lëvizjeje; për dokumentet dhe veprat më me ndikim në jetën shpirtërore të besimtarëve të saj etj. Mjafton të theksojmë këtu artikujt e shkruar me kompetencë profesionale dhe përkushtim prej bardi të këtij besimi për shërbimin e madh të bektashinjeve shqiptarë në Turqi, kontribut të cilin vetëm tash së fundi e kanë vënë re madje më shumë studiuesit e huaj se ata shqiptarë; artikullin mbi vendin e myslimanizmit në Orient, një artikull krahasues mbi bektashizmin

në shoqërinë turke dhe atë shqiptare, tekstin për rolin e besimeve në botën anadollake, dhe atë ballkanike; për rëndësinë institucionale, shpirtërore dhe kombëtare të riorganizimit të bektashinjeve të Shqipërisë; për rolet e besimeve në jetën ballkanike; për përhapjen e bektashizmit në Europë dhe Afrikë; për institucionin fetar të kishës, xhamisë dhe teqesë në jetën shqiptare; për rëndësinë e reformave fetare, me theks të veçantë riorganizimin e bektashizmit shqiptarë dhe pavarësisë së saj; për misionarët e bektashizmit shqiptarë: Gjyshin Ahmet Baba Turanin, Mymin Dedejen e Qerbelasë, Shemim Babanë e Krujës, një misionar i madh ky në përhapjen e bektashizmit në Shqipëri, si dhe rolin patriotik të klerit në Shqipëri etj.

Pjesa e dytë e vëllimit të tretë të veprave të Baba Ali Tomorit paraqet edhe një vepër të përmasave pak të njohura dhe pothuajse të papërsëritshme edhe në kushtet dhe rrethanat e reja të kohës sonë. Bektashizimi, si lëvizje e madhe kulturore dhe shpirtërore ka pasur historinë e tij dhe ka lënë gjurmë të rëndësishme jo vetëm në Shqipëri po edhe në Europë dhe më gjerë. Vepra *Historija e Bektashinjet* është pothuajse e vetmja vepër e tij e përmblyllur në përmasa të një monografie. Ajo hapet me disa studime thelbësore të cilat paraqesin karakterin kombëtar të bektashizmit si doktrinë, institucionin e organizimit kombëtar, reformën dhe rolin e saj në Shqipëri, perspektivën, etj.

Pjesa e parë e kësaj vepe ka karakter historik dhe paraqet anën e brendshme të organizimit të Bektashizmit si lëvizje dhe si ide universale. Pjesa e dytë, *Historia e Bektashinjet* përbëhet prej hyrjes, njëmbëdhjetë krerëve dhe një shtojce mbi gjendjen e bektashizmit dhe institucioneve të saj pas Luftës së Parë Botërore. Vepra përfshin një format të gjerë të dhënash historike, kulturore dhe shpirtërore të bektashizmit si rilindje e brendshme dhe si strukturë e organizimit të jashtëm. Mjafton të shihen kapitujt mbi periudhat para lindjes së bektashizmit, mbi faqen spirituale të historisë së Haxhi Bektashit, mbi përhapjen e bektashizmit në Europë dhe Afrikë, mbi bektashizmin në Gjirin dhe në Shqipëri, mbi përmbysjen e madhe të bektashizmit në kohën e Sulltan Mahmutit, mbi gjendjen e bektashizmit pas vdekjes së Ali Pashë Tepelenës, mbi qëndrimin nacionalist të bektashinjeve shqiptarë, mbi aktivitetet e teqeve pas mbledhjes së Frashërit dhe krimet greke të vitit 1914 etj. Le të thuhet gjithashtu se në këtë vepër janë përmbledhur, janë sistemuar dhe janë ridizajnuar idetë filozofike, diskutimet e karakterit historik dhe publicistik, konceptet shpirtërore dhe fetare të autorit, të cilat ku më pak e ku më shumë i kishte thënë në disa nga artikujt e ligjëruar apo botuar edhe më parë.

Përfundime

Përmbledhja e veprave të plota në tri vëllime, të njohura deri më tani, që na e jep zbuluesi dhe editori i shtëpisë botuese “Argeta” z. Mehmet Gëzhilli paraqesin një ngjarje të veçantë në jetën tonë kulturore në disa rrafshë:

e para, brenda këtyre veprave krijohet portreti kryesisht i panjohur i njërit prej intelektualëve të rëndësishëm të gjysmës së parë të shekullit XX;

e dyta, e njohur kryesisht përmes disa artikujve të botuar në shtypin e kohës, vepra e tij tani shfaqet me gjithë përmasën gjuhësore, oratorike, polemizuese, letrare, intelektuale, krijuese, historike, fetare dhe shkencore;

e treta, studimet e tij mbi apostullin e shqiptarizmit, sikur e quan Naim Frashërin, në këto vepra paraqiten të plota. Në këto vëllime ajo reflekton njëkohësisht edhe vlera të larta shkencore.

e katërta, studimet mbi bektashizmin dhe lëvizjen kulturore e shpirtërore në Shqipëri dhe në botë, të njohura kryesisht në artikujt e botuar në shtypin e kohës, tani paraqiten si një tërësi problemore dhe madje monografike.

Për të gjitha këto dhe arsyet e sipërthëna, vepra e Baba Ali Tomorit sot paraqet sa një monument të karakterit fetar po edhe kombëtar. Autori, me jetën dhe veprën e tij, në këtë vepër plotësojnë njëri-tjetrin, ashtu sikur plotësonin dikur e jep shembullin e tij edhe sot, apostulli i tij e apostulli i shqiptarizmit, Naim Frashëri. A nuk është kjo arsyeja pse vepra e tij, ashtu si edhe jeta e tij, në këtë vepër shfaqen si frymë naimiane e kohës së tij, e njëkohësisht edhe kohës sonë.

Prishtinë, më 18 gusht 2021

Në këtë temë, ka mendime të ndryshme: Nasi që anojnë pastër nga krijimtaria, pavarësisht fatit të saj, por edhe të tillë që ia japin përparësinë tregut; me të drejtë. Duhet ta shohim të vërtetën në sy: Një krijim artistik përbën arritje kur përmbushen disa kuota, ndër të cilat më të rëndësishmet janë: gjetja artistike, vlerësimi nga Kritika Letrare dhe, më në fund, Tregu. Në shumicën e botimeve të huaja, në shënime që përcjellin veprat, vihen në dukje pikërisht këta tregues. Pra, jemi të detyruar ta pranojmë - jam shprehur edhe në shënimin "Ka ardhur koha të vlerësojmë më shumë tregun" - ky i fundit përbën një nga të vërtetat kryesore dhe më të rëndësishme në letërsi dhe art. Shpesh, ai nuk është në anën tonë, por s'duhet pasur frikë prej tij; thjesht, duhet përballuar.

Çfarë po ndodh realisht? Teknikat e reja përmes të cilave zhvillohet komunikimi, i kanë tronditur tregjet. Historia digjitale, sajimet elektronike, lehtësia e publikimit, ndjekësit anonimë, klikimet për pa lexuar asgjë, qasja në reklama dhe fitime marramendëse e ndonjëherë të pakuptueshme, ky është pak a shumë 'skanari' në ardhje. Libri-letër dhe arti i përcjellë në publik si më parë (po themi në kinema e teatër ose në salla koncertale apo galeri artesh) tash janë në vështirësi. Mund të thuhet se dy mënyrat e publikimit (të krijimtarisë) po ecin paralel, sado që versioni digjital fiton gjithnjë e më shumë terren. E vërteta është se shumë filma ndiqen pak, kurse raftet me libra (që nuk shiten) po krijojnë një botë pothuaj groteske.

Kam parë me kujdes një sërë shpalosje në këtë temë, për disa kohë. Nuk ka asnjë statistikë serioze (!) Megjithatë, përtej statistikave, që dikush e disa edhe i kanë dhe i kërkojnë, i shpallin - këtu përfshij edhe veten - problemi është që ne e kemi tregun copë-copë. Shpërndarja (distribuimi) apo çuarja në publik e librit dhe arteve të tjera, është në krizë, nëse nuk është fare. Libri nuk shkon në rrethe. Të mos flasim për komuna e fshat. Të mos flasim për vende të tjera ku flitet shqip. Botuesit, në masë, mjaftohen me 3-4 librari në Tiranë. Pikërisht pse kemi këtë ngërç, disa shtëpi botuese të njohura kanë krijuar (secila më vete) një librari (!) Por ka edhe më keq: një pjesë e botuesve ua japin librat autorëve (pra: vrisni veten!) dhe këta i dhurojnë ose i mbajnë në shtëpi, ndonjëherë bëjnë presion mbi libraritë që s'ua përfillin fare. (Shpesh dëgjon krijues që thonë se librin mund ta gjeni te kioska e Tutit ose të bregu i Cenit, ka madje që thonë... tek unë,

TREGU: E VËRTETA PËR ARTIN

Nga Vangjush Saro

pra, hajdeni t'ua shes... Ej, është komike nga çdo anë që ta kapësh.)

Panairot janë një mundësi që të bëhet diçka më shumë, publicitet e shitje. Ndonjëherë, ato vijnë si një dështim total; promovimet nuk u përgjigjen vlerave reale. Pa shkuar vetëm pak ditë, harrohen librat dhe, ca më keq, edhe fituesit. (Të mos kujtojmë pastaj që u thua botuesve: A je në Panairin e Torinos? Për typen. Do jesh në Panairin e Prishtinës? Gëlltiten...) Megjithatë, kam lexuar se për ndokënd a për disa, panairot kanë shkuar edhe mirë. (Veç, nëse gënjehet, si puna e atyre klikimeve të shtuara; dëgjoja në një TV për këngët e ndjekësit... kaq milionë aso... kurse shqiptarët bëhen a s'bëhen gjithë-gjithë nja 5 milionë, pa le që shumica s'duan t'ia dinë as për art e as për tallava.) Dhe meqë ishim te TV-të (qasja është në parim, jo si një përvojë e imja) ato luajnë rëndë për çdo ngjarje a marrëzi të politikës, ndonjëherë edhe të muzikës bastarde; sa për librin, e kanë interesimin të limituar. TV-të, mediat në përgjithësi, mund t'i jepnin një dorë Tregut; por në fakt, ato shpesh e konfuzojnë atë, sepse përzgjedhin nën një presion të pandërprerë dhe sipas shijesh që jo gjithnjë vlejnë.

Tregu është miku ynë; sot është bërë 'armiku' ynë. (Dhe prapë e them në parim, nuk dua të personalizohet; vetë mund të kem tjetër përvojë, që fundja s'ka rëndësi.) Tregu duhej të ishte ndryshe; dhe në këtë çështje, institucionet kanë përgjegjësinë dhe

rolin e tyre. Por edhe kjo përgjegjësi është vetëm një pjesë e këtij rrëfimi; duam apo s'duan ne, libri, muzika, filmi, në një kuptim shesin veten. I them këto sepse - ka ndodhur edhe herë të tjera - kur publikohet ndonjë shkrim i kësaj natyre, të parët që vërsulen me komente dhe ankesa, janë autorët të cilët nuk gjenden asfare në publik. Dhe ata më kot ngarkojnë me përgjegjësi entet. Ka krijues që e dinë hapin e tyre, mbeten në suazën e përpjekjeve dhe kërkojnë ndihmë më shumë sesa japin mend. Por... një shumicë dalin me flamurin e të keqtrajtuarit, a thua këta po shkruajnë kryevepra dhe e kanë të tjerët fajin që s'u ecën.

E pikërisht, një nga problemet kryesore të artit e të tregut, është mbingarkesa. Ka një epidemi shkrimesh, poezish (me gjasë të tilla), librash, muzike, filmash, e kështu më tej. Në këtë epidemi, kryesojnë grafomanët dhe snobët, që janë njëllor barre për artin, por edhe për tregun. Sado që ata mund të duken ndryshe, në fakt janë një pendë dhe po e konfuzojnë seriozisht lexuesin e po e trazojnë si kurrë më parë tregun; edhe pse rëndom shpërblehen me heshtje nga Tregu dhe nga Mendimi Letrar. (Pauzë: Kur themi Mendimi Letrar, nuk kemi parasysh çdolloj zhgarravitës; se shoh që përzihen ndonjëherë diletantë e asi që, përveç të tjerave, as shkollë e as formim letrar nuk kanë.)

Për fat të keq, në panoramën që po e vizatoj pa pikë dëshire, ka edhe shkrimtarë deri diku të njohur e që botojnë prej një jete,

por nuk kanë lexues, s'kanë pasur asnjëherë, nuk dallohen për ndonjëfarë stili a veçorie; s'mund të thuash se nuk marrin vesh, por e kanë të pakët hapin. Por ka edhe më. Një koleg thoshte diku se... nuk shkruan për t'i shitur librat, nuk e ka problem (!) Kjo 'modë' është bërë pak rëndë tani. Nga njëra anë, pohojnë se nuk u intereson; por nga ana tjetër, bëjnë çmos për të publikuar krijimet, paguajnë botuesit, u luten kolegëve të shkruajnë ndonjë gjë për ta, duan të bien në sy me çdo kusht. Nëse nuk i shkruan librat (edhe) për t'i shitur, atëherë bëj si F. Kafka ose E. Dickinson, që e mbanin të fshehtë krijimtarinë e tyre. Përndryshe, jemi te Dhelpira që s'i donte rrushtë, se... ishin të thartë. Por nuk ka zgjidhje tjetër, arti s'bëhet për t'u mbyllur në sirtar apo në parashkallët e pallatit a të banesës. Krijimtaria i drejtohet publikut; çështje tjetër se jo çdokush e ka fatin të shkojë të publiku apo edhe që Tregu vetë, siç thamë, ka probleme të rënda.

Në një vështrim më paqësor, treguesi i shitjes së librave dhe i ndjekjes së artit në përgjithësi, mbetet një problem vetjak i çdo autori. Megjithatë, vlerësimi nga Tregu dhe nga Mendimi Kritik nuk i ikim dot. Për më tepër, statistika i kapërcen kufijtë e interesimit vetjak kur vjen fjala për institucionet dhe entet botuese; këta duhet të ndërrojnë fokusin. Është parë që në shumë raste, paratë e hedhura (ç'të hedhur se!) për disa filma, kanë shkuar kot. Filmat janë ndjekur shumë pak dhe këtu s'ke nga ta kapësh më parë problemin: Disa skenare janë të dobët, nuk thonë asgjë ose thjesht përsërisin traktate e debate politike, nuk krijojnë dot drama reale, romanca gjithashtu, u mungojnë karakteret, interpretimi është diletantesk, episodet janë të zbehta, shpesh tejet të ngarkuara me politikë e ideologji dhe nuk e prekin dot spektatorin, sepse fundja, ej, kolegë, jemi në film e jo në ndonjë konferencë apo muze historik....

Ka filma e krijime të tjera që janë viktimë e snobizmit të autorëve ose thjesht ofrojnë një rrëfim mediokër; ata i stisin gjërat për disa pak si vetja e tyre, kurse këto krijime lipset të bëhen të afërta për çdo lexues a spektator. Dhe çfarë ndodh më tej? Pasi e kanë botuar a shfaqur njëherë 'veprën' e tyre të pafat, autorët sërish bëhen dësh për sponsorizim, bien përmbys te 'tetoja' Ministri apo te ndonjë botues-mik që i ecën fjala, pastaj vuu paratë e taksapaguesve, dhe dikur, atë gjënë pa të ardhme e shohim të përkthyer... Kështu, edhe pse nuk ka gjetur asfare publikun vendas, e nisnin tatëpjetë, a thua do të ketë më shumë fat në gjuhën tjetër. Por kujt i duhet kjo? Edhe nga ai 'lëmë', nuk ka të dhëna çfarë është korrur e shirë...

Përballja me lexuesit dhe spektatorët është një problem i hershëm; tash është bërë edhe më i ndjeshëm. Nuk është fundi i botës, por duhet pranuar që kur nuk kemi 'katranosur' gjë, lipset të jemi më modestë; ne dhe ata që na 'mbulojnë'. Në këtë udhë, mendoj, duhen parë e 'darovitur' projektet, financimet, çmimet, vlerësimet. Madje, mund të duket një konstatim i ashpër, por duhet të kuptojmë se një krijim, për pa u vlerësuar nga Tregu dhe Kritika, nuk është ende krijim; është thjesht një dëshirë, një tentativë. Veças Tregu... e nxjerr zbuluar çdolloj loje, anësie a miqësie.

Në këtë 'histori' mund të ketë versione të ndryshme. Sidoqoftë, krijimtaria që sjell një gjetje dhe që, e thënë me njëllor kakofonie, është realisht e realizuar, herët a vonë e takon edhe Tregun, edhe Mendimin Kritik. Ndërkaq, çdo arritje, edhe për pa u dalluar si e tillë, patjetër lyp përkushtim e vëmendje; sikundër ç'janë pokeri a grafomani, sigurisht do të ndjekin fatin e tyre të vështirë e nuk ka pse të brohoriten në mënyrë false. S'duhet nxirosur edhe më keq tabloja, që ashtu se ashtu është...



Botimi i veprës së zgjedhur të një autori, vetvetiu paraqet një ngjarje letrare e kulturore në kuadër të një ambienti konkret letrar, shkencor e kulturor. Vepra e zgjedhur e një autori e prezanton dhe e legjitimon autorin në formë më të plotë, e krijon mundësinë e një vlerësimi më afirmativ po edhe më kritik. E prezantuar në një perspektivë kronologjike dhe askeologjike, veçmas kur është seleksionim e finalizim i vetë autorit, vepra e prezanton jo vetëm nivelin artistik, po edhe oscilimet e afiniteteve e koncepteve estetike, të cilat janë të paevitueshme, kur një autor ka një jetëgjatësi si shkrimtar dhe një opus të madh letrar e studimor. Pse? Në esenë monumentale "Mbi strukturalizmin", Jan Mukarzhovski konstaton diçka që vlen plotësisht edhe për autorin tonë: "Zhvillimi i strukturës individuale të veprës së autorit nuk është i atillë që të mundësojë ndryshimin e strukturës me kërcime të papritura: kontinuiteti i saj nuk ndërpritet as nga ndryshimet radikale, gjithmonë ekziston rivaliteti ndërmjet asaj që mbetet dhe asaj që vazhdon, prandaj edhe autori është i mbyllur në kufijtë e individualitetit të vet, të cilin me veprën e vet, në të vërtetë, e përsosë pandërprerë, por pikërisht për këtë arsye nuk mund të dalë jashtë kufijve të saj." Pra, edhe Bashota si poet, sado që ka bërë evoluime dhe kërcime estetike ndër decenie, prapë e ka ruajtur kontinuitetin e krijimtarisë së vet artistike, duke e përsosë dhe duke e legjitimuar fort stilin e vet. Sot është njëri nga zërat më kumbues të poezisë shqipe në nivelin e saj kombëtar, pikërisht me atë kontinuitet brenda kërkimit estetik bukur radikal. Për ilustrim po iu sjell disa vargje nga libri "Albumi i grisur" (1986) dhe disa nga libri i fundit i autorit, në të cilat mund të evidencohet edhe kontinuiteti, po edhe ndryshimi i konceptuar, por edhe ndryshimi në strukturën e vargut:

*Secili e gris hisen e fatit të vet
Nën qiellin e hapur
Kaq vonë ("Vjeshtake")*

Ndërsa po ajo kategoria e fatit, në poezinë "Secili e vizaton fatin e vet" tashmë ngërthen edhe një shtresëzim filozofik e etik dhe realizohet me një leksik më të shtruar emocionalisht, por duke e ruajtur kontinuitetin me preokupimin me fatin jetësor dhe konceptin estetik:

*Secili e vizaton fatin e vet
Në shuplakë të dorës
...
Secili e vizaton fatin e vet
Me dorëzat e bardha
Nëse ngjyrat treten si frika
Në fund të shpëtimit
Secili e vizaton fatin e vet*

Përtej kuadrit të kufijve konceptualë e estetikë, të vendosur nga autori, vepra e markon autorin edhe në rrjedhë më të gjërë kontekstesh shoqërore, politike kombëtare, pasi që Zeitgeist është prezente në të. Lidhja me brezin e viteve tetëdhjetë, sikundër u tha më herët, është lidhje organike, është participim aktiv në formësimin e asaj fryme tematike e stilistike. Pra, e kuptueshme që brenda atij brezi, Bashota mund të cilësohet si njëri nga përfaqësuesit qendrorë të brezit.

Duke qenë edhe studiues i letërsisë dhe mësimdhënës i saj në universitet, Sali Bashota e ka ruajtur edhe një lidhje diskrete me letërsinë shqipe të traditës e sidomos edhe me rrjedhat e poezisë moderne botërore. Pra, edhe nga këto relacione me traditën dhe me rrjedhat aktuale të poezisë botërore, poezia e Sali Bashotës mbetet një poezi që aspron harmoninë dhe sintezën e elementeve që në dukje të jashtme duken si të kundërvëna, siç në fakt janë tradita dhe moderniteti. Por, vlerat zakonisht nuk janë papajtuëshmërisht të kundërvëna, përkundrazi në të shumtën e rasteve mund të jenë esencialisht komplementare.

Po ta skicojmë shpejt dhe vetëm në nivel informimi kronologjic e veprave poetike të Sali Bashotës, e kuptojmë se si janë të ndërlydhura edhe ato aspekte që i përmendëm më herët, rivaliteti dhe kontinuiteti i asaj që vazhdon, lidhja me brezin e me frymën e kohës, stili personal, vlera estetike në rritje etj.

Vëllimet poetike të poetit Sali Bashota kanë këtë letërnjoftim titujsh e këtë kalendër botimi: «Albumi i grisur» (1986), «Zogu me profil vjeshte» (1989), «Plagomë» (1994), «Dalje nga trishtimi» (1999), «Bukuri e nëmur» (2006), «Dorëshkrimi i ngjallur» (2011), «Në fillim ishte Drita» (2017) «Asnjë

Parathënia e kompletit *Vepra të zgjedhura 1- 6*, Logos - A, Shkup, 2023

VEPRA LETRARE DHE STUDIMORE E SALI BASHOTËS

Nga Milazim Krasniqi

zë tjetër» (2018), «Lutja e parë e shpirtit», (2020), «Pëshpëritja e agonisë - libri i karantinës» (2020) dhe «Matanë dashurisë është një lumë» (2023), si dhe vëllimet me proza poetike: «Ëndrra në parajsë» (2006), «Sytë e vetmisë» (2011), «Zemërimi i heshtjes» (2014), «Shkallët e natës» (2020) dhe «Mëkati i buzëqeshjes» (2023.) Titujt shpalosin një mesazh njohjeje traumatike të botës, me oksimoronin si njëra nga figurat qendrore të figuracionit të mbarë poezisë së poetit. Ndërsa kalendari i botimeve dëshmon për një ritëm pothuajse marramendës të shkrimit, ndoshta për shkrimin si një frymëmarrje intelektuale që e ndihmon autorin të jetojë, pak a shumë ashtu siç thotë Cvetan Todorovi në traktatin "Letërsia në rrezik" se "letërsia na ndihmon të jetojmë".

Brenda këtij opusi krijues voluminoz, lexuesi do të mund të komunikojë, sado që nganjëherë me një gjuhë jo shumë dekoduese, gjendjet emocionale, njohjen e aspekteve të ndryshme të jetës personale e sociale, idealet dhe ëndrrat, zhgënjimet dhe pësimet, bukurinë dhe shëmtinë e dukurive dhe të realitetit. Ligjërimi i rënduar poetik në disa raste lidhet me përvojat direkte jetësore, fjala vjen me luftën e fundit në Kosovë, meqë Bashota është nga ata poetë të cilëve iu është djegë bashkë me shtëpinë edhe e tërë biblioteka dhe dorëshkrimet. Kjo përvojë e hidhur reflektohet në disa nga vëllimet poetike të autorit. Kjo përvojë jetësore e shkrimtarit dhe studiuesit që i janë djegë librat dhe dorëshkrimet e bën Saliun të jetë në grupin e atyre shkrimtarëve që kanë pësuar nga praktika dhe ideologji të skëterrshme si inkuizicioni, fashizmi, nazizmi, komunizmi.

Në një rast, menjëherë pas çlirimit të Kosovës, në vitin 1999, për librin e tij "Dalje nga trishtimi" kam shprehur këtë vlerësim, i cili vlen edhe sot dhe vlen për gjithë produksionin poetik të Bashotës. Në atë shkallë të stresit autorial, Sali Bashota në diskursin poetik më



shumë ka shpalosur veten, duke u përafëruar me konceptin e subjektivizmit romantik. Jeta e krijuesit në një ambient shtypës në fillim dhe shfarosës më vonë, e ka detyruar që përgjigjet t'i kërkojë nga shpirti i vet, e jo nga reagimet e jashtme, sepse as që ka pasur kohë të hulumtojë jashtë vetes. Kjo është në pajtim me logjikën sipas të cilës rreziku direkt për individin, kërkon edhe reagimin direkt të tij. Mund të konstatohet lehtë se edhe leksiku që semantizohet më shumë në vargun poetik të Sali Bashotës, është i fondit që mbulon kuptime dhe gjendje stresuese: fantazmat, frika, gjarprinjtë, skeleti, vdekja, jetëvdekje, thika, trishtimi, dheu i zi etj. Duke u bërë qendra semantike të vargut, këto fjalë dhe togfjalëshat e krijuar nga to, funksionalizojnë estetikisht një atmosferë poetike të fuqishme. Edhe vetë përsëritshmëria e disave prej tyre, vjen e bëhet element i konstruksionit artistik të poezive.

Këtë mënyrë formësimi të vargut e të figurave Bashota e ka kultivuar edhe në

vëllimet e mëvonshme. Sigurisht duke e ngritur në nivele më të larta e duke e begatuar, gjë që e kam konstatuar edhe në një rast tjetër. Ligjërimi poetik me intonacione të larta, gati me klithma, e bën bindës këtë konceptim. Sikundër që pohonte Llotmani, "nuk udhëheq vetëm tema shenjën gjuhësore, por edhe shprehja gjuhësore udhëheqë temën". Pra, koncepti për poetin si iluminues e si ëndërrimtar mbetet aktiv, por ligjërimi gjuhësor-poetik i ndryshuar për të, ndikon që edhe ai status të shihet si i ndryshuar. Saktësisht siç është në realitetin jetësor! (...) Për ta bërë sa më të qartë këtë raport, po iu njoftoj se në librin "Lutja e parë e shpirtit", pra cikli "Imazhi i pestë: Dhimbja", me vënien e imazhit në plan të parë, i cili sikundër dihet është elementi më i ekspozuar i përjetimit postmodernist të jetës/botës, dëshmon se Bashota tashmë ka avancuar shumë në ligjërimin me këtë frymë. Intonacionet e pasuruara të vargut, të bashkuara me nivele të tjera të ligjërimin poetik, në mënyrë intuitive marrin përsipër të bëhen shenja të realitetit të kohës në të cilën jetojmë në panik, ndërmjet kaosit e anarkisë, antivlerave dhe dehumanizimit. Llotmani ka sinjalizuar moti: "Për shqyrtimin e korrelacionit ritmik të intonacionit dhe semantikës së vargut, si pikë nistore duhet të shërbejë bindja që rendi ritmik-intonativ nuk është strukturë e pavarur, por është element që shërben për një varg nënstrukturash, të cilat në bashkëveprim konstituojnë sistemin unik të tekstit, i cili quhet poezi dhe i cili paraqet shenjë të përmbajtjes së caktuar dhe model të realitetit të caktuar."

Falë përvojës së gjatë si poet dhe si studiues i pasionuar i letërsisë, Sali Bashota është autor që i njuh këto vibracione intonativ-ritmike, ideologjike, stilistike e sociale, prandaj edhe arrin t'i definojë gjuhësisht në pajtim me realitetin.

Prozat poetike, të cilat jam i prirur t'i shohë si pjesë komplementare e vargut poetik të Bashotës, janë brenda kornizave motivore e stilistike të vargut të tij. Në poezinë tonë nuk di ndonjë autor tjetër të ketë vëllim kaq të madh të prozave poetike dhe sigurisht edhe kaq arritje artistike në këtë formë sinkretike të shprehjes poetike.

Sikundër është përmendur më herët, Sali Bashota është edhe studiuesi i njohur i letërsisë shqipe. Me këtë rast veprat e tij studimore do të prezantohen vetëm telegrafikisht.


Në gjashtë librat me ese dhe studime letrare, Sali Bashota, bën analiza, interpretime dhe vlerësime kritike, në radhë të parë, për vepra të rëndësishme të shkrimtarëve të letërsisë romantike dhe të letërsisë moderne shqipe. Në mesin e tyre, dallohen studimet për shkrimtarët e mirënjohur, siç janë: Naim Frashëri, Sami Frashëri, Jeronim de Rada, Gjergj Fishta, Françesk Anton Santori, pastaj Faik Konica, Mid'hat Frashëri, Mitrush Kuteli, Ernest Koliqi, Migjeni, Musine Kokalari etj., si dhe për vepra të shkrimtarëve të letërsisë bashkëkohore shqipe.

Po kështu, në librat me studime, Sali Bashota, trajton dukuri dhe fenomene letrare e estetike, që ndërlydhën me autorë dhe vepra të caktuara, para së gjithash, të poetëve, prozatorëve, kritikëve letrarë, të cilët i përkasin periudhave të ndryshme të letërsisë shqipe.

Studimet letrare të Sali Bashotës shquhen me gjuhën e tyre të qartë e argumentuese, me stilin e rrjedhshëm e original, si dhe me sistemin e dijeve më të avancuara në fushën e kritikës letrare bashkëkohore. Në këto studime, dallohet aftësia dhe përkushtimi i studiuesit për t'u përqendruar kryesisht në qasjen analitike dhe krahasimtare, por në raste të veçanta edhe për të bërë sinteza të suksesshme studimore, siç është monografia letrare për Mitrush Kutelein.

Me veprat e tij studimore Sali Bashota ka dhënë një kontribut të çmuar, duke e pasuruar kritikën letrare shqipe me ide, mendime, pikëpamje, por edhe vlerësime të qëndrueshme kritike.

Për fund: botimi nga Shtëpia Botuese "Logos A" i kësaj kolane me veprat e zgjedhura të poetit e studiuesit Sali Bashotës, është një projekt që e legjitimon edhe më fort këtë botues si një vatër e vlerave dhe e afirmimit të tyre. Ndërsa lexuesit i mundëson ta vazhdojë e ta rivendos komunikimin me veprën poetike e studimore të një autori të njohur dhe që tashmë është referencë në poezinë shqipe. Kur bëhen bashkë në një projekt të këtillë një shtëpi botuese serioze, sikundër është "Logos-A" dhe një autor serioz, sikundër është Sali Bashota, lexuesi është pala fituese.



Këtë muaj mbushen katër vjet prej ndarjes së parakohshme nga jeta e gazetarit dhe publicistit të njohur Fatos Baxhaku. Ai ishte i pranishëm në shtypin e shkruar dhe në kanale televizive të vendit si një kryeredaktor plot kulturë, vërtetësi dhe kandje. Ndërkohë, ai nuk la pas dore krijimtarinë letrare dhe shoqërore, duke botuar disa libra të veçantë dhe mjaft tërheqës për publikun shqiptar.

Fatos Baxhaku kishte studiuar për histori në universitetin e Tiranës dhe pas përfundimit më 1986, ai u aktivizua si punonjës shkencor pranë Institutit të Historisë të Akademisë së Shkencave deri në vitin 1992. Gjatë viteve 1993-1998 ai kreu detyrën e kryeredaktorit tek "Gazeta Shqiptare", mandej si kryeredaktor i televizionit "Klan", më pas edhe i "Vizion Plus". Në kohështrirjen 2006-2015, ai drejtoi me mjaft zotësi gazetën e njohur "Shqip". Në të gjitha këto detyra ai u shqua për aftësi e kulturë edhe për korrektesë me bashkëpunëtorët dhe lexuesit e këtyre organeve.

Përgjatë këtyre viteve Baxhaku u dallua edhe për trajtimin me frymë origjinale dhe kulturë të reportazheve e serialeve televizive me tema mbresëlënëse. Veçojmë ndër to: serialin "Tunel" (të cilin e kam ndjekur me shumë kërshtëri dhe vëmendje) tek "VizionPlus", atë "Rrugëtim" tek "Top Chanel" dhe "Shtëpia e vjetër" në platformën "Digitallb". Në këto emisione televizive shpërfaqej vëmendja e tij për probleme të natyrave të ndryshme, historike, shoqërore, kulturore dhe politike. Po ashtu, duhet shënuar se Baxhaku është autor edhe i disa skenarëve të filmave kinematografikë si: "Atentatet e mëdha", "Sytë e Lumit", "Shenjrat" dhe "Vetmia", çka flet për horizontin e gjerë kulturor të tij.

Ndër botimet e Fatos Baxhakut shënojmë përmbledhjen me reportazhe "Gur" (2008), "Në Mirditë & rreth e rrotull" (2009), "Roje" (2010), "Çadra e kuqe: histori fatësh austro-shqiptare në shekujt XIX-XXI" (2013), në të cilat gëlon një publicistikë elegante. Tepër i veçantë mbetet botimi i tij (me bashkëautore) socio-psikologjik me titull "Gra të përgjithshme" (2014) me vlera të shumta për jetën shoqërore në vend në disa kohështrirje. Për disa kohë Baxhaku falë personalitetit të tij, ishte zgjedhur edhe anëtar i "Komitetit Shqiptar të Helsinkit", ku u dallua për qëndrime të guximshme dhe parimore. Pas vitit 2015, ai doli në profesion të lirë, por natyrisht pa u shkëputur nga krijimtaria letraro-artistike.

Fatos Baxhaku u nda nga jeta më 16 gusht 2019, duke pikëlluar thellësisht familjarët, por edhe miqtë e tij të shumtë. Shuarja e tij e parakohshme u pasqyrua gjerësisht nga të gjitha mediat në gjuhën shqipe, print

Me rastin e Katërvjetorit të ndarjes nga jeta të publicistit të njohur

FATOS BAXHAKU DHE FOTOJA "DORËZIMI I ARMËVE"

Nga Qerim Vrioni



apo elektronike, në Shqipëri, Republikën e Kosovës, Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut. Një vit më vonë, në "Panairin e librit 2020" në Tiranë, Baxhaku u vlerësua si "Autori më i mirë" për librin e tij "Në emër të Nojes". Pak më vonë, për të nderuar veprimtarinë e tij u emetua konkursi vjetor kombëtar për mediat "Çmimi Fatos Baxhaku". Po ashtu, me një vendim të posaçëm të Këshillit bashkiak të Tiranës, një rrugë e kryeqytetit për kujtim të tij u emërtua "Rruga Fatos Baxhaku". Duhet shtuar se të gjitha këto nuk mund të lejnë në hije natyrën dashamirëse dhe tërheqëse

botimet dhe shikuar serialet e tij tërheqëse.

Gjatë viteve kisha pirë disa herë kafe me Baxhakun, bisedat me të cilin ishin përherë mbresëlënëse dhe rridhnin këndshëm. Temat e trajtuara brenda tyre ishin shumë të larmishme; flisnim për letërsi, gazetari, fotografi, muzikë, madje edhe për politikë dhe çështje shoqërore. Ai shquhej gjatë bashkëbisedimeve për originalitetin dhe largëpamësinë në debat.

Kthehemi tek titulli i shkrimit dhe lidhja e Fatos Baxhakut me foton e njohur të Kel Marubit "Dorëzimi i armëve".



të Fatos Baxhakut, çka shpërfaqej edhe nga shoqëria e madhe dhe e zgjedhur e tij, madje jo vetëm në Tiranë.

Veprat e botuara dhe emisionet televizive, i kanë siguruar Fatos Baxhakut kujtesë dhe përmendje të përhershme, jo vetëm nga miqtë e të afërm, por edhe nga të tjerë që e njohin dhe do ta njohin vetëm duke lexuar

Rreth 22 vite më parë, në shkurt 2001, botova shkrimin tim të parë për fotografinë. Asokohe bëheshin rreth dhjetë vjet që merresha me fotografi, kryesisht duke realizuar peizazhe, por edhe me "leximin" e fotove të vjetra. Në vitin 2000, shoku im i vjetër, Qemal Agaj, më kishte dërguar nga ShBA albumin fotografik "The Photo

Book" (2000), të shtëpisë botuese angleze "Phaidon", me 500 foto të zgjedhura nga e gjithë bota dhe kohët. Aty përfshiheshin edhe dy foto të lidhura me Shqipërinë. E para ishte fotoja e njohur e Gjon Milit, "Picasso duke vizatuar me dritë" (1949), në album me titullin "Picasso", tjetra shkrepja e Kel Marubit "Kapiteni Mark Raka dhe Bajraktari i Shalës" (1922).

U përqëndrova tek kjo e dyta. Teksti shoqërues i fotos nuk kthjelloste se çfarë po ndodhte me ata 11 burra përreth një pushke mbrapsht. Aty, ndër të tjera shkruhej se: "Sot është vështirë të përcaktohet natyra e ngjarjes të përjetësuar në këtë foto të Kel Marubit" ("Il Mondo della Foto"-Phaidon, London, 2003, f.302, botimi italisht). Duke hulumtuar për subjektin, gjeta në Historinë e Shqipërisë se në vitin e fotos, 1922, në vend ishte zhvilluar nga shteti një fushatë e gjerë me bazë ligjore për çarmatimin e popullsisë civile. Krijova shpejt bindjen se fotoja pasqyrore pikërisht një skenë nga ky aksion i madh politik dhe shoqëror.

Shkrova diçka, rreth një faqe A4 dhe me ndihmën e shokut tim Pandeli Koçi u lidha me publicistin Fatos Baxhaku, i panjohur prej meje, atëherë kryeredaktor i revistës së përjavëshme kulturore-shoqërore "XXL", të cilit i dhashë shkrimin. Ai, pasi e lexoi, më telefonoi në shtëpi e më kërkoi që sa më shpejt t'i jepja edhe foton. Pas pak ditësh, ai e botoi artikullin me titullin tim "Çarmatimi në një fotografi të Kel Marubit", dhe pas një jave më kërkoi të shkoja të bisedonim dhe të tërhiqja në zyrat e redaksisë (te Piramida) edhe një kopje të revistës.

Në takimin dytë Fatosi, me të folurën e tij të ngadalshme dhe të ngrohtë, më përgëzoi shumë për shkrimin, dhe më nxititi të hulumtoj më tej, jo vetëm për dy figurat historike të fotos, Kapitenin Mark Raka dhe Bajraktarin e Shalës, por edhe të personave të tjerë.

Fjalët e tij kurajuese më shtytën që të vazhdoj më tej kërkimet për foton. Ashtu veprova, dhe pas një viti e gjysmë e plotësova shkrimin me emrat e thuajse të gjithë personazheve dhe të dhëna të tjera historike për kohën dhe njerëzit, shumica figura të njohura të asaj periudhe. Mandej e botova tek dyfaqëshi i brendshëm i "Gazeta Shqiptare" më 2 maj 2002. Titullin e ndryshova duke menduar se nuk po çarmatoseshin me forcë civilat (të paktën në foto), por po i dorëzonin vetë shtetit armët, të cilat ligjërisht nuk ju takonin. Pra, fotos i vendosa emërtimin e ri "Dorëzimi i armëve në një foto të Kel Marubit".

Tanimë nga ky titull ka mbetur vetëm "Dorëzimi i armëve", e cili e shoqëron rëndomë këtë foto në shtyp dhe në botime të ndryshme dhe jo emërtimi zanafillor "Kapiteni Mark Raka dhe Bajraktari i Shalës", si ndodhet edhe në regjistrin e Fototekës "Marubi". Prej atëherë nuk jam shkëputur nga studimi i fotografisë. Vështirë se do kisha vazhduar më tej në këtë fushë, pas artikullit "Çarmatimi në një fotografi të Marubit", nëse nuk do shikoja entuziazmin dhe nxitjen dashamirëse të Fatos Baxhakut.

Takimi im i fundit me të ishte në Galerinë "FAB", në vjeshtë të vitit 2018 gjatë një ekspozite të fotografit dhe piktorit të njohur Leon Çika. Aty folëm edhe për takimin e ardhshëm, që fatkeqësisht nuk u realizua.

Gjithsesi, Fatos Baxhakut do ti jem përgjithmonë mirënjohës, i pastë dritë shpirti



Romanin “Nessun Dorma” të Roland Gjozës, nisa ta lexoja me kënaqësi, i bindur në talentin e autorit, ngaqë ruaja një përshtypje shumë të mirë nga romani i tij; “Franc Baron” Prej këtij shkrimtari në Kosovë janë botuar mbi 12 romane nga shtëpia botuese Buzuku. Por pak është shkruar për të, mesa kam kuptuar, ai hyn tek ata autorë që nuk iu pëlqen publiciteti. Lavdia është dielli i të vdekurve, shkruan Balzaku. Një stoicism ky, një vetëpërshtim, për të mos rendur pas zhurmës e bujës së ditës dhe që përbën përjashtim nga rregulli. Bisedoja shpesh me Abdullah Zenelin për këtë rrallësi të çuditshme në sjelljen e autorëve në raport me reklamën. Ky është Rolandi, më thoshte, ai mendon se vepra dhe autori kanë jetë të ndarë nga njëri-tjetri. Vepra duhet të ecë me këmbët e veta, ndryshe s’ka dinjitet.

Sapo nisa leximin e këtij romani të Roland Gjozës, m’u kujtua “Dekameroni” i Bokaçios. Jemi në kohën e Monarkisë. Në ditët e fundit të saj. Në rrethanat e parapushimit italian të Shqipërisë. Kudo ndjehet aromë lufte dhe frike. Në jetën e njerëzve ka hyrë ankthi e pasiguria. Sikur gjithkund hetohet një parashthurje, një kaos. Njerëzit janë të brengosur për fatin e tyre. Kjo sikur ua shton atyre dëshirën dhe epshin për një jetë të shfrenuar deri në absurd e banalitet. Autori, mjeshtër i mendimit dhe i rrëfimit, sjell në roman, krejt natyrshëm, paralajmërimin e një të keqeje të pashmangshme, që po i afrohej Shqipërisë.

Por çfarë ndodh në të vërtetë në Shqipërinë e asaj kohe?

Një mjek italian është vendosur në Tiranë, ka hapur një klinikë mjekësore. Fati e do që ai të takohet me Frosinën, një grua me bukuri të rrallë, që të kujton gratë e Renesansës, gratë e afreskeve të Mikelanxhelos. Kështu nis një romancë që shndërrohet në një dashuri të thellë pasioni. Por, a ndodh vërtet kjo mrekulli, apo është thjeshtë një nga ato dashuri që shuhen papritur një ditë? Ata nuk arsyetojnë asgjë, por vetëm i jepen njëri-tjetrit, sikur të jenë rinjohur pas një mungese të gjatë. Adriano vuan nga një sëmundje tepër e rëndë dhe misterioze, për të cilën ai nuk mund t’i rrëfëhet askujt. Ngjashmëria e Frosinës me gruan që është bërë shkak i sëmundjes së tij, e shtyn atë që ta dashurojë çmendërisht gruan e bukur. Por, mjeku detyrohet të shkojë në luftë dhe Frosina ndërkaq mbetet fillikat vetëm, e pafuqishme t’i rezistojë joshjeve dhe tundimeve.

Aria Nessun Dorma e operës Turandot, do të përshkrojë si lajtmotiv të gjitha ngjarjet në roman. Ajo do të këndohet në situatat më dramatike dhe në çastet më intime, ne gjendjet më të thella shpirtërore, si për të paralajmëruar se është e vështirë, ose gati e pamundur që bukuria e dashurisë të triumfojë mbi mizoritë e luftës. Herë për të shprehur gjithë dramatikën, që bart jeta në kohë lufte, herë për të përmbushur një çast a një skenë deliri apo ekstaze shpirtërore, veç aries së famshme të Puçinit, kemi dhe letrat e padërguara të Frosinës që u bënë libra. Vuajtja dhe vetmia e shndërrojnë Frosinën në një Colette, në shkrimtaren franceze të skandaleve, që rrëfen gjithçka, pa fshehur asgjë, qofshin ato dhe mëkate vetjake, apo skena të një shturrjeje morale.

Pastaj do të shfaqen një grusht personazhesh, që në shikim të parë na duken të paktë për të bartur e shprehur gjithë ngjarjet dhe dramën, aq të shumta e aq të mëdha në roman dhe tronditjet, ndryshimet, që shkaktojnë përplasjet dhe pjesëmarrja në konfliktin “e dy perandorive”, (siç do të shprehet Rolandi). Kaosi dhe konflikti, që krijohet në këto rrethana, e vështirësojnë shkajshëmërisht drejtimin e rrugës te secilit. Kahjet janë të ndryshme, qëndrimet kontradiktore, me një mundësi rreziku gjithmonë, me pandehmën e gjithëkohëshme të një humbjeje totale. Këto rrethana shndërrohen në një sfidë të vërtetë si për mbretin ashtu edhe për qytetarin, si për oficerin ashtu edhe për ushtarin, si për tregtarin ashtu edhe për lypësin, si për të dashuruarin ashtu edhe për të shturuarin, ne botën e tundimit dhe epshit.

Frosina, (kryepersonazhi ne roman), rreth të cilës ndërthuret i gjithë rrëfimi, është një femër tmerrësisht e bukur, por fatalisht

Romani “Nessun Dorma” të Roland Gjozës, Buzuku, Prishtinë

FATALITETI I NJË GRUAJE MËKATARE, POR TË PAFAJSHME

Nga Gani Bytyçi



e mjerë dhe fatkeqe. Ajo është një grua e pambrojtur që, ose duhet të dorëzohet pa kushte, ose duhet të qëndrojë duke sakrifikuar gjithmonë e më shumë në përballje me rralitetin. Ajo e përshkon këtë kalvar dhe i mbijeton gjithë këtij kaosi shoqëror e moral, rrebesheve të kohës e përplasjeve tronditëse në arenën botërore. Kësaj gruaje natyra i ka dhënë bukuri përrallore, por si paracaktim, asaj i ka rezervuar dhe fatkeqësinë. E mbetur e ve në moshë të re, joshëse dhe tunduese deri në tronditje për secilin mashkull, ajo kthehet në fatkeqësi e vetvetes. E bukur, në përmasë të magjishme, me një dhunti të skajshme talenti ajo, nga dëshmitare e të gjitha ngjarjeve të mëdha e dramatike, shndërrohet në dëshmitare të vetvetes. Ajo bëhet interprete e egoizmit dhe fatkeqësisë së vet që mundohet t’u shmanget, por pa ia arritur gjer në fund. Është një rënie e lirë e saj, një vetëdorëzim para rrethanave të jashtëzakonshme, por gjithsesi ajo mbijeton. Herë e qetë dhe krejt e ftohtë, herë e zjarrtë e gjithë epsh. Sa njerëzore, aq edhe e pashpirt (në dukje) ajo merr fuqi për të lëvizur neper

ngjarje e rrethana aq të paimagjinueshme dhe krejt të pamundshme.

Pjesën më të madhe të librit e përbëjnë letrat, që Frosina ia shkruan së bijes. Ajo kishte qenë një nga dashnoret e mbretit dhe tani ndodhej me te në egzil. Por letrat e Frosinës, të shkruara për të bijën, kurrë nuk iu dërguan asaj. Ato ngelën një formë rrëfimi intim për vetë Frosinën. Njëlloj katarsisi dhe ngushëllimi në orët e vetmisë. Më vonë ato u botuan si libra dhe autoren e bënë të famshme.


I biri, me të cilin Frosina kishte humbur kontaktet prej shumë kohësh, ishte një i ri fatkeq. Fatkeqësia e tij ishte e kundërta e fatkeqësisë së saj. Asaj fatkeqësia i vinte nga bukuria, ndërsa të birit nga shëmtia, ai vuante nga sëmundja e akromegalisë. Ai jeton i përbuzur dhe i terrorizuar, endet rrugëve në izolim të plotë. Në mëshirën e të pashpirtëve. Leonardo do të kryejë atentat ndaj gjeneralit italian, në çastin kur e ëma është duke darkuar me të. Autoritetet italiane arrijnë ta kapin Leonardon. Ai do të dënohet me varje! Por ja, përsëri, pushteti i bukurisë e kapërcen fuqinë e çdo pushteti. Komandanti

i Gestaposë, me të parë Frosinën, dorëzohet para bukurisë së saj, si para një magjie. Ai do t’ia falë jetën Leonardos për të kaluar vetëm një natë me gruan që zotëron një bukuri kaq magjepsëse. Leonardo lirohet. Ai sërish do të ngjitet në mal për t’iu bashkuar partizanëve. Autori (si për të dhënë përmasën e fatkeqësisë së pafundme të Frosinës), na jep dhe një detaj tejet tronditës e rrëqethës. Në mbarim të luftës, pas kapitullimit të fashizmit, Leonardo do të hartojë listën e të dënuarve me vdekje të bashkëpunëtorëve të armikut. Aty, ai ka vënë dhe emrin e Frosinës, nënës së tij. Me këtë autori na jep kumtin e lig se vendin po e pushtonte një fatkeqësi tjetër, që do ta denatronte njeriun, duke i marrë lirinë, në një mënyrë tjetër, pa ndjenjë, pa shpirt e pa asnjë kod moral, për një kohë shumë të gjatë. Por këtë herë, shkrimtaren, tashmë të njohur, do ta shpëtojë oficeri partizan, që e donte letërsinë, të cilit i kishin pëlqyer shumë librat e saj. Por ai kishte edhe një peng tjetër; donte te shpetonte nga pushkatimi Frosinën si nënë. Librat tani, në rrethanat e reja, ato ç’ka ajo kishte rrëfyer me aq ndjenjë dhe bukuri stili, nuk do të ishin fare aktuale. Pa dyshim librat e saj do të ndaloheshin, do të zhdukeshin nga duart e lexuesit, si të dëmshëm. Kjo do të ishte edhe një “njollë” e fatkeqësi për gruan e bukur, shkrimtaren, që nuk besonte se ishte e tillë. Mbase kjo do të ishte edhe përmbyllje e fatalitetit të një gruaje, sa të pafajshme, aq edhe mëkatore. Adriano shpëton nga lufta. Por nuk ndodhet ne Shqipëri. Emrin e Frosinës e ka hequr nga lista e të dënuarve me vdekje vartësi i Leonardos. I biri donte ta ekzekutonte vetë të ëmën. Vartësi e qorton; si mund të vritet një nënë? Leonardo, që tashmë mban një post të lartë, pajtohet që ekzekutimin të mos e kryejë vetë, por ia beson këtë shoqeruesit të tij. Janë vërtet çaste dramatike, kur duket se gjithçka do të mbarojë me aq, por jeta tregohet e mëshirëshme me Frosinën. Leonardo nuk do që të jetë i pranishëm në ekzekutimin e nënës së tij dhe largohet. Këtu autori bën një kthesë radikale. Në një gjendje tmerrri, kaosi dhe amoraliteti të pafund, ai sjell diçka njerëzore. Adriano vjen nga Italia dhe, pas një sage kërkimi gati të pashpresë, e gjen atë më në fund. Dhe i rrëfen gjithë historinë e sëmundjes së tij. Shoqëruesi i Leonardos nuk e kishte vrarë Frosinën, por e kishte fshehur në shtëpinë e tij. Faqet e fundit të librit janë nga më tronditëset.

Në nënshtresat e këtij romani dashurie, në ato që Heminguej i quan nëntë të dhjetat e ajtsbergut, lëvizin metafora dhe simbole poetike. Autori ka bërë kujdes që ato të fshihen nën rreshta, duke i dhënë mundësi lexuesit për një interpretim vetjak. Ky është një roman i lirizmit të thellë, i gjuhës elegante, i detajeve dhe i gjendjeve emocionale, që të lënë mbresa të forta.

Shkrimtari Roland Gjoza, me këtë mbyllje të romanit, tërheq një paralele letrare dhe historike dhe kështu krijon ndërlihdjen e kohëve dhe të epokave ndërmjet tyre. Ai, nëpërmjet këtij motivi, na e kujton edhe njëherë frymën tragjike të kompleksit te Edipit. Autori këtu sikur na thotë se tragjedia e Edipit mbret, nuk i takon vetëm antikës. Ai na e sjell në vëmendje edhe njëherë se kompleksi i Edipit dhe fryma tragjike e tij, është e pranishme po aq edhe në kohën e sotme dhe të gjithëhershme të jetës dhe të dramës njerëzore!

Mendoj se ky është një ndër romanet më të mire të letërsisë shqipe, botuar vitet e fundit,



“Fros, tashmë një heroinë unike e letrave shqipe, vjen nga një penë e sigurt nga një kohë vllimesh, intrigash, zhvillimesh, ambiciesh si dje, si sot!”

BUZUKU

1

Flitet shumë sot për "tjetrin". Dhe siç ndodh shpesh me bisedat apo me motivet e vjetra, që pas një harrrese ose pushimi rikthehen në jetën tonë, ne kujtojmë se edhe për "tjetrin" jemi ne që po flasim për herë të parë.

Në të vërtetë biseda, më saktë, trazimi për "tjetrin" duhet të jetë tepër i mot-shëm. Ka gjasë të jetë po aq i vjetër sa zbulimi i seksit, i tmerrit ose i vdekjes. Ka gjasë që historia të ketë nisur qysh atë ditë kur njeriu i shpellës është kthyer tek të vetët, me një fytyrë të lemeritur, për të njoftuar se ka parë një gjë tejet të frikshme, tejet të përcudur, diçka që desh ia ka marrë gojën. Ndaj dhe kur shpellarët e tjerë i bërtasin: *Ç'ishte ajo? Quest ce que était ça? Cto eto byllo? Wer da? Who's there? Stand and unfold yourself!*

Por njeriu primitiv nuk e ka lehtë të shpjegohet. Nuk ka parë as vetëtimën, as bishën e egër, as vullkanin, por diçka më tronditëse: një qenie që duhej të ishte ai, por që s'ishte ai, një trajtë, që ngjante si e dalë, e pjellë prej atij vetë, por që në vend që të ishte si i tillë, të ishte i pranueshëm, ishte i kundërt, i papranueshëm, madje kërcënues.

Njeriu i shpellës ndeshet për herë të parë me "tjetrin".

Në shpellë vazhdonte gjyqi kundër tij. Kërkohehin shpjegime, bëhej hetim, pritej përgjigje. *Halte et explique toi! Stoj i objavis! Steht und gebt Euch kund! Qëndro e shfaqu! Stand and unfold yourself!*

2

Historia duhet të jetë aq e vjetër, saqë ngjarjen e natës së 22 qershorit të vitit 1602, mund ta marrim si pjesë të kronikës sonë moderne.

Teatri "Globus" i Londrës si zakonisht ishte plot. Ishte premiera e një drame, që tregonte për njëfarë Hamleti, që do t'i merrte gjakun t'et. Ishte e dyta apo e treta herë që kjo histori vihej në skenë. Teatri që po mbushej, ashtu si Londra, në prag të shfaqjeve të tilla, ishte plot thashetheme. Është një histori si gjithë të tjerat, nga ato që na kanë ardhur në majë të hundës. S'është fare ashtu, përkundrazi, është një kryevepër. Ka të bëjë me oborrin mbretëror danez, ndaj autori i ka ndërruar emrat e personazheve, për të mos pasur incident diplomatik. Jo, more! Unë kam dëgjuar se drama fillon me një fantazmë. Vërtet? Unë vdes për fantazmat. Kurse unë s'i duroj dot, e sidomos ime shoqe, që vuan nga nervat.

Spektatorët mezi ç'prisnin fillimin e shfaqjes. Dhe ja, ajo nis ashtu, siç ishte pëshpëritur: Natë me mjegull në muret e kështjellës së mbretit danez. Një rojë me heshtë që kryen shërbimin. Dikush që afrohet nëpër mjegull. Këmbimi i famshëm i replikave midis ushtarëve:

Who's there? Nay, answer me. Stand and unfold yourself!

Është folur gjatë për këtë fillim të "Hamletit" të Shekspir. Atmosferën e mosbesimit, dyshimin e rojave, frazat e tyre të prera, shumë studiues i kanë lidhur me ankthin që ishte përhapur në Danimarkë për shfaqjen e fantazmës së mbretit. Të tjerë studiues e kanë shfaqur habinë për këtë fillim të rëndomtë, me ca replika banale ushtarësh, të kryeveprës së teatrit botëror. T. S. Eliot e shpjegon si të bërë enkas, për kundërthënie me ngjyrimin hijerëndë që marrin befas vargjet, sapo biseda vjen te fantazma.

Biseda midis dy rojave është pak a shumë ajo që është bërë dy milionë vjet më parë te hyrja e shpellës së dikurshme. Fantazma që pritet, ajo që do të shfaqet pas pak në skenë e jep thelbin e atij që ne përmendëm sot me aq zell: TJETRIT. Është "tjetër" në radhë të parë në trajtë. Për ne, njerëzit, asgjë në botë nuk mund të jetë më "tjetër" se fantazma e njeriut. Është tjetër nga lëkura, nga flokët, nga sytë, nga gjatësia e gjymtyrëve, nga lëvizjet, nga zëri a nga heshtja e saj. Por tjetërsia nuk mbaron kurrsesi me kaq. Ndryshimi nis nga pamja, për të zbritur thellë e më thellë. Ai prek



HISTORIA E "TJETRIT"

Ese nga Ismail Kadare

thelbin e saj. Fantazma është e ndryshme në vetë statusin e saj të dyfishtë: jetësor dhe vdekësor. Por ajo është e ndryshme në shumëçka tjetër, p. sh. në dijet që ka, në vizionin e botës, në enigmat që ndryn, në kumtin që sjell, shkurt, në gjithçka. Ajo di atë që të tjerët nuk e dinë, sheh atë që ne nuk e shohim, shpall një të vërtetë që për disa ngjan e rreme, ose një rrenë që mund të jetë e vërtetë.

Na ngjan e rrezikshme në të gjitha rastet, edhe kur duket se vjen për të na dhënë ndihmë, edhe kur vjen gjithë pezëm e kërcënim. Fantazma e Hamletit mbret, në ledhet e kështjellës së Elsinorit, duket se vjen për të ndrequr një padrejtësi, për të sjellë një drejtpeshim. Por, në një bilanc të fundit, ajo nuk sjell në skenë veç një seri vrasjesh e një varg kufomash.

T'i besojmë, apo jo? Kjo është pyetja e Hamletit e, bashkë me të, pyetja jonë. Ndaj britma e njerit prej rojave: "Qëndro e shfaqu!", në fillim të dramës, është njëherësh britma dhe ankthi ynë: "Mos u fshih më, shfaqu!"

3

Njerëzimi nuk rri duarkryq para fantazmës së "tjetrit". Ai nuk ka qëndruar kurrë duarkryq. Ai mund të jetë kapur në befasi, të jetë mpirë përpara gjarprimit, tigrit, tërmetit, por asnjëherë përpara shëmbëllimit të vet. Ai ka qenë syçelët dhe ka dhënë shumë herë kushtimin kundër vërsimit të lumit ose sulmit të bishës, por ky kushtim ka qenë i rëndomtë. Kushtimin e vërtetë, atë më të madhin, atë më të thekshmin ai e ka dhënë kundër shëmbëllimit të vet: njeriut. Kundër atij ai është përgatitur më gjatë dhe më me përkushtim se për çdo gjë tjetër. Ka bërë gati rrëfenja të gjata, libra, muzikë, emblema, mure, porta dhe, sidomos, armë. Ka nxjerrë ushtrinë në kufijtë e shtetit, ka dërguar zbulues në thellësi të vendit armik, ka vënë roja majë pirgjeve për të përgjuar. Roja nga ato që klithin: Ndal! Unfold yourself!

Vocërrakët në shkolla mësojnë historinë e popullit të vet. Në të ka shumë ngjarje, emra të shquar, zotërinj trima dhe zonja të bukura, shpesh të pabesa. Ata mësojnë e mësojnë shumë gjëra, gjersa një ditë kujtojnë se tharmi i kësaj historie, kripa e saj, është "tjetri". Pa atë, "tjetrin" kënga heroike ngjan e zbehtë,

fitorja pa shije, festa pa kuptim. Shkurt, pa të jeta jonë ngjan e fishkur, e dështuar, për të mos thënë, e kotë!

Vargu i robërve të kapur në luftë, që parakalojnë kokulur përpara fitimtarëve, flamurët armiq, të kapur njëllor si njerëzit, që hidhen si plaçkë lufte, komandantët apo mbretërit e mundur, që parakalojnë gjithashtu me pranga në duar, të gjitha këto janë pamje të paharrueshme pas fitores.

Kronikat japin një rast lufte të çuditshme, atë midis hititëve dhe huritëve, ku problemi kryesor nuk ishte ndeshja me armikun, por gjetja e tij në shkretëtirë. Ushtritë hitite niseshin, por kthimi, nëse të tillë kishte, zgjaste shumë. Dhe atje në shkretëtirë nuk dihej se ç'ndodhte, kush fitonte, kush humbte. Mostakimi, avullimi i "tjetrit" ishte krejtësisht çoroditës për të gjithë. Ai prishte ligjet e jetës. Popujt nuk kënaqeshin vetëm me përfytyrimin e "tjetrit". Ata donin ta shihnin atë, ta rroknin, për të mos thënë, ta goditnin.

Për të mos shkaktuar kompleksin, më saktë, zhgënjimin, hititohurit, vendet komuniste, pasi e bënin të njohur "tjetrin", me anë të propagandës, filmave dhe teatrove të tyre, si një dhuatë befasuese, organizonin procese gjyqësore, me armiq të gjallë, në mënyrë që "tjetri" të shfaqej me mish e me kocka. *Unfold yourself!*

Që shpëshjtjellja e "tjetrit" të ishte sa më mbresëlënëse, duhej që të shoqërohej nga padurimi për të. Padurimi për të parë "tjetrin" të rrezuar do të thoshte në gjuhën komuniste "mbajtja lart e frymës revolucionare", çka mund të përkthehej: mbajtja lart e urrejtjes së palodhur, pra e ahtit për të zhdukur "tjetrin" pa mëshirë.

Që kjo të kryhej ashtu siç duhej, duhej që ideja se "tjetri" ishte i pashmangshëm të mos vihej kurrë në lodhje, e aq më pak në dyshim.

"Tjetri", me fjalë të tjera, shkaktari i grindjes dhe i luftës është kudo: në lëkurë, në gjuhë (barbare, sipas grekëve), në fé, në ide, në doktrina a në qytetërimi. Virusi i armiqësisë guxon të futet atje ku nuk pritët: brenda klanit tënd familjar apo politik. Ai prish lidhjet e gjakut, madje ai arrin të depërtojë në zonën që duhej të ishte e pamundur për ta, në hapësirën e dashurisë midis dy qenieve njerëzore. Ky është një nga ngadhënjimet më të mëdha të tij.

4

Ka diçka tragjike, diçka fatale në këtë gjendje të gjërave. Me fjalë të tjera, a mund të ketë përgjigje pyetja: përse kaq shumë urrejtje, kaq shumë luftëra? Përse për gjithçka vjen ora e lodhjes, veç jo për to? Pyetjet e mësipërme mund të duken tejet naive.

Ne e dimë që njerëzimi sa vete mençurohet. Krijohet shpresa se tani që e keqja dihet, ka ardhur koha që duke qeshur me marrëzitë e kaluara, njerëzimi të ndahet prej saj. Mirëpo në sytë tanë ndodh e kundërta. Sepse në sytë tanë njerëzimi është katandisur në atë shkallë marrëzie saqë, siç thotë Karl Popperi, ai të kujton dy të çmendur, që bëhen gati për të bërë duel, duke vringëlluar secili disa dhjetëra-mijëra mbushje bërthamore. Dhe kjo, gjithmonë sipas Karl Popperit, është njëllor sikur dy duelistë të shkonin në takim, jo me nga një revole, aq sa çdo të ishte e nevojshme për të vrrarë "tjetrin", por me pesë mijë revole secili!

Përballë kësaj gjendjeje, e cila vazhdon në kohën që po shkruhen këto radhë, ne e humbim të drejtën të cilësojmë si naive cilëndo pyetje të ngjashme me ato të mësipërmet.

Atëherë le të vazhdojmë me to: A ka qenë e pashmangshme e gjitha kjo? Ku është bërë gabimi, a ka shpresë që diçka të ndreqet? Deri tani, luftërat janë shpjeguar si vazhdimi me armë i politikës, e kjo e fundit, rrjedhojë e ekonomisë, e kështu me radhë, dhe pastaj është folur për anët e errëta të natyrës njerëzore, e kështu me radhë, duke ardhur te mendimi se bota jonë, pamjet e saj, ngjarjet, gjithçka, perceptohen nga miliarda e miliarda kamera, që janë sytë dhe mendja e miliarda njerëzve, me fjalë të tjera, për secilin qenie njerëzore ka një gjeografi, një histori, një kalendër të përditshëm, që ajo e ndjek ditë e natë, çdo orë e çdo minutë, dhe se këto miliarda vizione vetjake, këto miliarda bërthama "tjetra"-sh përbëjnë një mundësi katastrofike, si ato që përfytyrohen në përplasjet kozmike?!

Neve na duhet të refuzojmë një rendje të mendimit përtej mundësive që natyra i ka dhënë trurit tonë. Neve na duhet të kthehemi te një gjendje më e kthjellët, që na e dikton kushtëzimi, domethënë kufizimi ynë njerëzor. Në këtë rast, ne s'mund t'i bishtnojmë pyetjes së thjeshtë: a ka shpresë që diçka të ndreqet? Pa dyshim që po. Sado e mjegullt të ketë qenë fantazma në muret e kështjellës së mbretit Hamlet, ata që e panë ose e përfytyruan: rojat, shokët e princit, vetë princin Hamlet, guxuan t'i thonë: "qëndro dhe shfaqu!"

Kjo duhet të jetë pyetja jonë në këtë forum ku po bisedohet për "tjetrin". Pa u ndrojtur ne mund t'i kthehemi kronikës së vjetër, atje ku historia, ndoshta, ka nisur.

Në fillim ka qenë një histori që mund të quhet "e syrit". Ka qenë syri që është habitur ose trembur nga pamja e "tjetrit", në radhë të parë nga ngjyra e lëkurës, e pastaj të tjerat. Syri njerëzor ka gjithmonë një lidhje me veshin. Te grekët e vjetër ishte veshi, që u bezdis nga gjuha e "tjetrit", e cila pa asnjë lëkundje u quajt "barbare" e, bashkë me të u cilësuan të tillë njerëzit që e flisnin atë. Më pas, në skenë hyri pjesa më e ndritur, por edhe më e rrezikshme e njeriut: mendja. Ishte ajo që u bezdis prej "tjetrit" jo vetëm për lëkurën e gjuhën, por për ato që nuk dukeshin me sy, e as dëgjoheshin me vesh: tregimet e tij të brendshme, thënë ndryshe, mitet, besimet, zakonet, kujtimet ose frikërat e tij. S'ishte vetëm raca ose gjuha që përcaktonin "tjetrin". Bashkë me to ishte tjetër gjë, po aq dramatike, në mos më tepër. E pas kësaj, shkallëzimi do të merrte përmasa tragjike: ishin kombe të tëra që viheshin përballë, e pas tyre, kultura, doktrina, për të përfunduar te vetë qytetërimet, që mendohet se do të përplasen.

Ajo që kishte nisur nga syri dhe nga veshi, shkoi shumë më larg se ç'pritej.

5

S'mund të thuhet se njerëzimi ka qenë shpërfillës ndaj rrezikut. Në një mënyrë ose

një tjetër, në mos drejtpërdrejt, tërthorazi, ai është përpjekur të krijojë antidote kundër këtij tmerr. Kërkimi i kriterëve për të përcaktuar "tjetrin" ka qenë një nga përpjekjet për kufizimin e së keqes. Përtej pamjes dhe gjuhës, që në mënyrë tepër të dukshme, por tepër të rëndomtë, përcaktonin "tjetrin", njerëzit edhe në zonën e trupit, kërkuan diçka më të thellë. Te shumë popuj, në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri, vëmendja u përqendrua te gjaku. Ka mbetur jo fort e qartë përse u kërkua dallimi pikërisht te diçka, që jo vetëm nuk e dëshmonte dallimin, por dëshmonte të kundërtën. Mund të interpretohet kjo si një thellim i së keqes, pra, i kërkimit të dallimit edhe atje ku ai është i fshehur mjeshtërisht, ose e kundërta, për ta vënë në dyshim xanxën ndaj tij.

Gjaku ka tërhequr gjithmonë kureshtjen e popujve. Si rrjedhojë e kësaj ai ka marrë një ngarkesë të theksuar simbolike, mitike e shpesh fataliste. Përfytyrimet e kryehershme për të mund të merren si skicimet e para tepër primitive e, natyrisht, fantaziste të gjenetikës së ardhshme. Ngjyrimin fatalist ia jepte fakti që për grekët e vjetër p. sh., gjaku që del nga trupi njerëzor nuk kthehet më kurrë në trup (çka në kushtet e mosnjohjes së transfuzionit ishte e vërtetë). Ky moskthim i gjakut identifikohet me "të pakthyeshten" në përgjithësi. Një ngjyrim tjetër të ngjashëm ia jepte ajo që quhej "lidhje e gjakut", e cila, sipas të vjetërve shpjegonte afeksinin midis njerëzve të familjes, të fisit, madje të një klani të gjerë. Që këndej nuk ishte e vështirë të kalohej te pastërtia ose fëlligështia e gjakut, me të gjitha ndërlikimet që sillte ajo, për të përfunduar te "zënia e gjakut", zanafilla e parë e pendimit, e brerjes së ndërjegjes, me të cilat është marrë aq shumë tragjedia greke.

Përftimi i gjakut si një identifikim i brendshëm, njëfarë karte identiteti e një fisi, e një klani, madje e një kombi të tërë, do të jepte dy rrjedhoja tragjike: e para, krimet në emër të pastërtisë së tij, e dyta, krimet në emër të gjakmarrjes. Të dyja modelet i gjejmë në poemat homerike e ende më qartë në teatrin grek. Ndërkaq shekujt e mëvonshëm do të kapërcenin dukshëm modelet antike, për të arritur gjer te Holokausti i lemerishëm kundër hebrejve, në mesin e shekullit XX.

6

Kronika e "tjetrit" ka pasur e, me sa duket, do të ketë nevojë për ushqim të ri. Ankthi i dikurshëm i mosgjetyes së huritëve prej hititëve, në njëfarë mënyre është përsëritur shumë herë në botën tonë. Është një e vërtetë e njohur se kur "tjetri" mungonte ai do të kërkohet. E natyrisht, kur nuk gjendej, do të shpiket.

Luftërat civile, ato ku kundërshtarët e kishin gjithçka të njëjtë, pamjen, gjuhën, madje dhe atë që ishte vështirë të vërtetohej, gjakun, ishin po aq të egra, në mos më shumë se të tjerat. Iidetë e ndryshme ishin të mjaftueshme për të prodhuar urrejtje po aq sa derdhja e gjakut. Besimet fetare, gjithashtu.

Një rivalitet i çuditshëm u shfaq midis lidhjeve të gjakut dhe atyre të doktrinës. Nazistët, ndonëse ishin të magjepsur pas mistikës së gjakut, gjersa iu hynte në punë kundër hebrejve dhe popujve të nënçmuar prej tyre, nuk mëdysheshin ta shkelnin atë me këmbë kur ishte puna për besnikërinë ndaj nazizmit dhe Führer-it të tij. Kurse për tiranitë komuniste shkelja e lidhjeve njerëzore, në emër të besnikërisë ndaj doktrinës, u kthye në një bast të madh. Për familjen e re, atë të "doktrinave" u ngrit një propagandë e tërë, e ndihmuar nga artet, filmat, poemat dhe dramet e pafundme të një epoke të çmendur.

E, pavarësisht se kjo fjalë përdoret përherë e më shpesh, në gjykimin e ngjarjeve, asgjë nuk pengon që tmerrin të përsëritet. Si rrallëherë në historinë e njerëzimit po kërkohet, po shpiket, po jepet alarmi, po përgatiten armët, për të goditur "tjetrin".

Pyetja e vjetër, atje te gryka e shpellës, përsëritet e përsëritet pa pushim.

7

"Një fantazmë po vërtitet në Europë, fantazma e komunizmit".

Me këto fjalë fillon "Manifesti Komunist" i Marksit e Engelsit. Të kujton disi fillimin e "Hamletit" të Shekspirin. Ashtu si rojat e kështjellës së Danimarkës, shumë njerëz do të kenë pyetur në kohën e botimit të tij: "Ç'është kjo fantazmë e re?" Dhe më pas, pa dyshim do të vinte pyetja tjetër: Përse po shfaqet, ç'kumt po sjell?

Fantazma te "Hamleti" u shfaq për të kumtuar një krim dhe, natyrisht, për të kërkuar gjakmarrje. Manifesti komunist gjithashtu kumton një krim dhe kërkon një përmbyse, thënë ndryshe, një revansh. Këtë herë dhe krimi dhe përmbyssa që kërkohet janë botërore. Dhe revanshi, merret me mend, ashtu do të jetë: i lemerishëm.

Në të vërtetë ndodhi pikërisht ashtu. Historia dihet, është pjesë e historisë së "tjetrit". Një nga më të zymtat në kronikën e njerëzimit. Miliona viktima, burgje, tortura, tmerr i pafund. Këshilli i Europës pak kohë më parë, pas shumë mëdyshjes, u kërkoi, më në fund, vendeve ish-komuniste dënimin e krimeve të komunizmit. Ka vite që mendimet ndeshen e përplasen për këtë çështje. Madje qysh kur perandoria komuniste ishte ende në këmbë.

Në atë kohë, sidomos pas vdekjes së Stalinit, u gjet njëfarë konsensusi për të shpjeguar tragjedinë. Ishte një ngushëllim, më saktë, një justifikim. Thelbi i ngushëllimit ishte dënimi i Stalinit. Me fjalë të tjera, komunizmi ishte i drejtë, por ai u përcudnuar. Më saktë: Lenini mbetej i shenjtë, por ishte Stalini ai që i leu duart me gjak.

Nuk arritën njerëzit të marrin frymë të lehtësuar, kur e vërteta u shfaq me fytyrën e saj të plotë: Stalini nuk kishte bërë gjë tjetër, veç kishte kryer porosinë e Leninit. Pra, ky i fundit, ishte rrënja e së keqes, njëlloj i egër si pasardhësi, madje më i pashpirt.

Konsensusi u modifikua: Të dy së bashku, Stalini dhe Lenini, madje dhe Trocki, i dënuar prej tyre, ishin të mbrapshtë. E bashkë me ta, njëlloj si ata, ishin pasardhësit e tyre, të mëdhenj e të vegjël: Mao Ce Duni, Causheku, Ulbrihti, Hoxha, Kastro, etj. Ngushëllimi megjithatë mbetej Karl Marks!

Po të perifrzojmë frazën e parë të *Manifestit Komunist*, mund të themi se kohët e fundit një pyetje vërtitet nëpër Europë: zbrit apo nuk zbrit faji gjer te Marksit? Përgjigjja

kërkon gjakftohtësi, paanësi, mungesë mllëfi. Duke qenë ithtarë të botës së letrave, ne, shkrihtarëve, na lejohen, ndoshta, më shumë se të tjerëve referencat nga bota e letërsisë. Në këtë rast, kemi të drejtë më shumë, ngaqë qysh në krye të "Manifestit Komunist", Marksit i qaset vetë këtij përfytyrimi, duke e identifikuar njëfarësoj veten e tij me Fantazmën shekspiriane. Ashtu siç u shfaq ajo në përgjigjet e kështjellës daneze, Marksit, në kullën e Europës shpall kumtin e "fantazmës së komunizmit". Kumti dhe programi janë të ngjashme: shpallet një krim, kërkohet vënia në vend e padrejtësisë. Krimi është bërë prej borgjezisë, kundër proletariatit botëror, rrjedhimisht kërkohet revanshi i tij: përmbyssa e borgjezisë, vendosja e diktaturës së proletariatit.

Ky është thelbi. Dhe pyetja tani bëhet më e rrokshme: faji i komunizmit ka lidhje me thelbin, me rrënjët, apo me ato që ndodhën më pas, me degët?

Pyetja e vjetër, t'i besojmë apo mos t'i besojmë kumtit të fantazmës (të çdolloj fantazme që shfaqet në jetën tonë), te Marksit merr një përgjigje të qartë. Analiza që i bën ai kapitalit, pra anketa e krimin, është e saktë dhe e besueshme. Problemi shfaqet fill pas saj.

Te kështjella daneze fantazma mesjetare, duke i kërkuar Hamletit marrjen e hakut (e bashkë me të përmbyssen e uzurpuesit, etj, etj.) nuk harron t'i japë hakmarrësit një porosi themelore. Ajo i kërkoi atij të jetë i përmbyssur në revansh.

Ideja nuk është e re. Nuk është as e Shekspirin, as e Saxo Grammaticus, tek i cili dramaturgu u mbështet, e as te sagat islandeze, ku u mbështet Saxo. Ideja është e vjetër sa bota. Përmbyssa! Mos e tepro hakmarrjen. Këtë porosi e gjen në maksimat, gojëdhënat, rrëfimet, kodet zakonore, kronikat poetike të shumicës së popujve. Atë e gjen në themelin e poemave homerike, në tragjedinë antike, madje në rrënjët e qytetërimit grek. (Zotat e Olimpit i ndëshkuan grekët kur ata e tepruan revanshin e tyre ndaj trojanëve.) Ka qenë dhe mbetet një nga idetë më emancipuese, që ka prodhuar njerëzimi në të gjitha kohërat.

Është e mundur që Karl Marksit, njeriu që gjithë jetën u mor me çështjen e përmbyssjes së rendit borgjez dhe zëvendësimin e tij nga diktatura e proletariatit, të mos e njihje këtë ide? Të mos i shkonte mendja asnjëherë se kjo përmbyssa klasash, më e madhja, më rrënjësorja në historinë e botës,

do të shoqërohej nga përrenj gjaku, nga shkallmime, tmerre e mllëfe hakmarrëse të papara kurrë ndonjëherë në këtë planet?

Përfundohet çdo hamendje që Marksit të mos e dinte atë që e dinte çdo rapsod i pashkollë e shumica e gjysheve që me përralla i vënë në gjumë vocërrakët. Nuk është rrjedhojë e asnjë pezmi, por rrjedhojë e logjikës, mendimi se Marksit e dinte, por ai parapëlqeu të mbyllte sytë e ta linte të kryhej ajo llahtarë.

Disa paragrafë, që mezi gjenden në veprën e tij e ku Marksit shtron, më në fund, këtë "problem" (hakmarrjen e tepruar), në vend që ta lehtësojnë, e rëndojnë më keq. Naiviteti i tyre është ulëritës, për të mos përmendur një shprehje më të rëndë. Kuptohet që larg që ata paragrafë janë shkruar sa për të larë duart, si Pilati. Në ata paragrafë ai, më në fund, ia jep porosinë klasës punëtore, që të përmbahet në revanshin e saj. Por, porosia është fund e krye e rreme. Sipas Marksit, proletariati i zemëruar nuk duhet të shprehë dufin e tij kundër ndonjë duzine miliardësh, që mbajnë çelësat e kapitalit. Gjithmonë sipas Marksit, kjo tufëz miliardësh duhet të veçohen në një ishull, ku të ngrysin të qetë ditët e tyre! Është vështirë të mos bësh pyetjen: Herr Marks, vërtet kaq naiv keni qenë, sa të mos e dinit se, kur një rend botëror kapitalist përmbyset nga themelet në kulm, nuk janë vetëm një duzinë miliardësh, por miliona zyrtarë e shërbyes të këtij rendi, aradha të tëra oborrtarësh, bankierësh, gjykatësish, klerikësh, tregtarësh, policësh, nëpunësish, fermerësh, artistësh, ushtarakësh, kodoshësh etj. etj., që do të jenë në shënjestër të urrejtjes e të hakmarrjes? Se do të ndodhte ajo që ndodhi vërtet në të gjitha vendet komuniste, ku dhjetëra miliona fate njerëzish u përmbyssen nga uragani i urrejtjes klasore.

Jo disa paragrafë të humbur, por pjesën themelore të veprës së tij Karl Marksit duhet t'ia kushtonte porosisë që jepte fantazma daneze dikur. Një "Manifest i dytë Komunist", ai që do të duhej të fillonte me fjalët se "një fantazmë hakmarrëse do të vërtitet në Europë, pas fitores së proletariatit, etja e revanshit pa frë", ishte i domosdoshëm.

Me atë shpallje të dytë të programit të tij, Karl Marksit, në mos do të shmangte gjithë krimet e ardhshme, së paku do të shpëronte një pjesë të njerëzimit nga furia e revanshit të verbër.

Dhe historia e "tjetrit" do të ishte ndryshe.





BOTOHET NË ITALISHT ROMANI "DIKTATORI NË KRYQ" I MIRA MEKSIT

Është botuar këto ditë në Itali romani "Diktatori në kryq" i Mira Meksit. Nën përkthimin e Giovanna Nanc-it, romani mban titullin "Il Dittatore in croce". Ai vjen si pjesë e katalogut të botuesit prestigjioz "Gruppo Editoriale Bonanno" e krijuar në vitin 1960 nga Giuseppe Bonanno-s, i biri i librarit Mauro Bonanno sikurse shkruan "La Repubblica" në një artikull të 2010. "Diktatori në kryq" ishte fitues i Çmimit Kombëtar të Letërsisë për vitin 2019 me motivacionin "Për krijimin e vlerave dhe risive origjinale në prozën romanore shqipe, ku ndërthuren mjeshtërisht motivet e një historie besimi në trajektoren e një epoke politike, atmosferën dhe prirjen për rikthim në realitetin që tashmë nuk i përket më".



Romani "MI MANCHI" lëviz në sfondin e një realizmi të bazuar mbi saktësinë e një vëzhgimi të mprehtë por mbi të gjitha, mbi origjinalitetin dhe interpretimin transformues të tij, në të cilin objektet, pejsazhet dhe fizionomitë e personazheve, janë riprodhuar me tipare tejet të personalizuar.

Janë pikërisht përshkrimet, qofshin ato të paraqitjes së personazheve të treguara si dhe vëzhgimi i portreteve të fotografuara që e paralajmërojnë lexuesin për ngjarje të thella e përvoja ndjenjash të dhimbshme në të shkuarën, si dhe shprese për të ardhmen.

"Fytyra. Përtej Identitetit" e titullon Fate Velaj një nga ekspozitat fotografike të tij.

Protagonistët e këtij cikli, kërkuar dhe gjetur brenda ambienteve të së përditshmes së tyre, ndërtojnë një galeri të larmishme që përbëhet nga elemente të artit fotografik si dhe atij lirik të Velajt. E thënë shkurt: ajo që Fate Velaj bënë në roman, është pikturimi me fjalë e me shprehje i burrave dhe grave që, një herë i trajton duke bashkëbiseduar dhe një herë duke jetuar si gjithë të tjerët e dhënë atyre tipare sipas eksperiencës së jetës që kanë përshkuar gjatë të cilës, u janë rrokullisur gëzime, fatkeqësi apo humbje njerëzish të dashur.

Dhe pikërisht këtu kryhet dhe ndërthurja mes artit gjithpërfshirës të Velajt: pikturës, fotografisë dhe lirikës -, por edhe vetë jetës së tij.

Fillimi i romanit është kronika e një udhëtimi që e sjell autorin nga Vjena në një qytet të vogël të Salentos, Negromonte, i dëgjuar vetëm për verën Negramaro.

Autori tregon impresionet e udhëtimit që e shoqërojnë lexuesit në një atmosferë të veçantë e që bëhet kornizë e gjithë romanit. Përshkrimet e gjalla të peisazheve dhe personave që ai takon gjatë këtij rrugëtimi, që si përherë në librat e tij vijnë përmes një dialogu e monologu kërkojnë të rrëzojnë pengesat dhe të krijoj lidhje shpirtërore midis popujve, dhe në këtë rast: Austrisë, vendi ku Velaj jeton, Shqipërisë vendi i origjinës së tij si dhe Italisë, vendit të tij - mund të them pa frikë i adoptimit shpirtëror të tij -, nisur kjo nga ndjeshmëria e thellë me anën e së cilës është shkruar romani të cilin e trajton plotë dritë dhe ndjenja bazuar kjo në njohuritë e pamata që ai ka për tiparet, karakteristikat dhe zakonet e popullit italian.

Nëse rrugëtimi i tij ka një pikë mbërritjeje, një kronologji, ai është vetëm një pretekst, sepse në fakt, gjatë rrugëtimit, përqëndrimi i autorit ndalet për një kohë të shkurtër mbi një objekt apo person, si për të trajtuar një proces analogjie, abstraksioni, apo një dalldisje lirike të momentit që po përjeton. Në këtë mënyrë, ndërthuren fragmente të mbushura me elemente që rindërtojnë pjesërisht kujtimet fëmijërinë dhe adoleshencën e tij: zhvillime artistike, figura njerëzish të dashur dhe pse jo, situata shpërthuese ëndrrash me sy hapur.

Në këtë proces rrëfimi, bëhet evident takimi i elementeve heterogjen ku kontrasti është provokuar prej trukeve dialektike që rrjedhin nga vetë natyra e autorit herë fotograf, herë piktor dhe herë shkrimtar.

Më kujtohet kur Heinrich Heine në një tregim dedikuar Detit të Veriut në ato që ai i quante "Reisebilder" (përshkrime udhëtimesh) i njihte Goethes kapacitetin e veçantë të vëzhgimit, të ndjeshmërisë dhe mendimit, që në fakt, janë po ato që ka dhe Fate Velaj.

Dhe në të vërtetë, ai u jep këtyre elementeve shumëformëshe një ekuilibër sinergjik deri në atë pikë, saqe justifikon refleksionin e qartë të tij, duke ja dalë të lëvizë mes frymëzimit, entuziazmit mbi ambientin që e rethon si dhe mendimit racional dhe kritik ndaj vetvetes.

Zbarkimi në Negromonte, zhytja brenda një klime atavste, apatike dhe artistikisht të përgjumur të qytetit, bëhen nxitje për ide të reja, për t'i shtuar elemente të tjera vetvetes dhe këtu Fate Velaj, falë aftësisë fantastike që ka për të vëzhguar efektet, nxjerrë në pah rolin e katërt të tij -, i heq vëllon e trishtë të atmosferës qetësisht biblike qytetit.

Është pikërisht ai, Velaj i së kuqes së zjarrtë nëpër pikturat e tij, i syve të gjallë mbushur me habi dhe plot dëshirë për jetën i portreteve fotografike që nuk mund të bënte gjë tjetër veçse të gjente një shkak për t'i shkundur iluzionet pa energji shtytëse qytetarëve të Negromontes, të cilët janë mbyllur brenda vetes nga ankthi, dhe kjo, ndoshta nga që akoma nuk janë çliruar nga momentet tragjike sado që në pamje, mundohen t'i fshehin mirë ato.

Kështu, "MI MANCHI", dedikimi i shkruar në një portë të mbyllur nga një person i identifikuar me gërmën B për të dashurën e tij G, është vetëm një shkak. Një mijë pyetje që i lindin për identitetin e të dyve, për historinë e dashurisë së tyre si dhe përfundimin e saj, hyjnë e dalin nga mendja e autorit që edhe pse vihet në rolin

EFEKTI ZEIGARNIK NË ROMANIN "MI MANCHI" TË FATE VELAJ

Nga *Maria Sinatra*
Profesore në universitetin e Barit
dhe në Matera

e investigatorit e në kërkim të çdo detaji, nuk harron se është një romancier dhe krijon një histori në histori të mbushur me kodime ndjenjash.

Dhe është pikërisht kjo historia e tjetrit që e nxit atë të verë në punë rolin e tij të katërt duke i detyruar disa personazhe të shtrihen në "Divanin Frojdian" me të vetmin qëllim, t'i shkëpusë ata nga jeta monotone dhe t'i fus në një proces të brendshëm, t'i rrëfejnë atij, momente të veçanta të jetës së tyre, shpeshherë edhe të dhimbshme. Dhe Fate Velaj ja del ta zgjoj qytetin nga grija normale e agonisë që e ka mbërthyer.

Përdorimi i një stili gjuhësor të mprehtë, realist dhe të rrjedhshëm, lehtëson hyrjen e lexuesit brenda romanit i cili, edhe pse shpesh herë merr kthesa ngjarjesh intime, fsheh një mesazh të thellë e sublim: nevojën për të dashuruar jetën, pavarësisht çfare ndodh gjatë saj. Dhe këtu arti, pavarësisht nga format e tij, është lokomotiva e nevojshme shtytëse.

Është sinjifikativ fakti që, edhe pse Velaj mund ta bënte prezente identitetin e B-së dhe G-së si dhe vetë historinë e tyre, ai lë çdo gjë pezull duke shkaktuar kështu një efekt Zeigarnik. Dhe kjo, ose nga dëshira për suspansë apo nga vetëdija se, nëse do ta bënte një gjë të tillë, do ta vendoste përsëri në gjumë Negromonte-n.

Këtu mbaron dhe detyra e tregimtarit Fate Velaj: Të shkruaj jo vetëm për objektin e romanit, për një akt të lirisë imagjinare apo thjesht për një kënaqësi egocentrike, por për një vizion artistik si faktor i rëndësishëm komunikativ dhe ndërmjetësues.



Ishin çift shqiptar si janë shumica prej nesh, të martuar në moshë të pasherr kur s'dinin më mirë, kryesisht pse ashtu deshën pleqtë; tolerantë me pahir ndaj njëri-tjetrit, me ndarje të prerë detyrash, seks të çrregullt, tradhti të rregullta, fqinj të çmendur, e çaste të rralla lumturie në një rrëke të errët e rrëmbyese krizash, shfryrjesh e pendimesh që ua kishin nxirë jetën që të dyve. Kishin një djalë, të dalë nga shtëpia qëmoti. Kjo çiftet o i rehaton, o ua nxin jetën, e në rastin e tyre vlente kjo e dyta. Me folë kah del shpirti, në vende të qytetëruara ata do të ishin ndarë qëmoti. Por ç't'i bësh jetës, kjo e shkretë është si apostrofat e dyfishtë. Duhet pranuar gjërat ashtu si janë, se s'varen prej teje. Ai kish nisur të shkojë gjithnjë e më shpesh në "udhëtime zyrtare". Ajo ish fantaksur në kuzhinë. Gatuante gjithçka bio organike si te ato videot në Youtube, bukë shtëpie, djathë shtëpie, suxhuk shtëpie.

Mirëpo, u ndodh nganjëherë edhe çifteve shqiptare më të rutinuar që ferri i përbashkët thjesht t'u bëhet i padurueshëm. Ky kulminacion zakonisht vjen kur u vdesin pleqtë, e çifti me menopauzë çlirohet më në fund nga burgu i pritshmërive. Atëhere diqysh u ngordhin edhe arsytet për të bashkëvuajtur. Pse të rrih në burg, kur gardianët s'janë më. Ose ndodh kur burri a gruaja marrepsen mbas dikujt të tretë, kur ndonjë nga ato tradhtitë rutinore mbarsen me rëndësi koti dhe bëhen shkas për ndarje e melodramë lagjesh që preokupon me javë e muaj familjarët, miqtë, e fqinjët e afërm e të largët, deri larg në fshat të lindjes e në mërgatë. Se këtë do thënë, për ty që s'i njeh çiftet shqiptare, se jeta e tyre gjithçka mund të quhet përpos e tyrja.

Këtë rrethanë, pak a shumë, po e mejtonte atë ditë fatprerë edhe ai, tek kthehej në shtëpi nga "udhëtimi zyrtar". Prindërit kishin vdekur dhe ai kish vendosur

që të flasë shkoqur me të shoqen, pa të dalë ku të dalë. Biseda s'do të ishte fare e lehtë, këtë e dinte. Ajo ndodhej në atë fazë harmonie e opsioni me kuzhinën, e cila i vinte sa herë që kish dalë nga një krizë e radhës, dhe ky e dinte fort mirë se biseda do ta fërfëllonte në një krizë të re. Por e dashura e kish mbështetur me shpatulla për muri gjatë "udhëtimin zyrtar". Le të themi kështu, më mirë t'i fliste ky gruas, se t'i fliste e dashura. Po ta mbaronte bisedën sot, e premte mbrëma, do të kalonte një fundjavë super me të dashurën. Ai pështyu, shau me vete, e hapi me çelës derën e apartamentit.

Ajo i doli para si rëndom, nga forcë e shprehisë. Ai pa sërish figurën e njohur, të majmur nga vitet, me flokë të ngjyrosur e të veshur në tuta gri, tek po i gjuhej me buzë të fryra në një si O të puthjes. Mpuq, mirë se erdhe, a u lodhe. Sa e shtrova tavolinën, tava del nga soba për dhjetë minuta. Kam nisur suxhuk shtëpie, bleva mish e qepë e zorrë, do ta nis nesër që të turet. A të ka marrë malli. Ish vështirë ta kuptojë në e kish fjalën për suxhukun a për atë vetë. Ai foli buzërrudhur, jo jo në rregull jam. U lodha, rrugë e gjatë. Dua të pushoj pak se do të dal prapë, por a ulesh një çikë të lutem. Se kam dy fjalë për t'i thënë.

Ajo u ul pranë tavolinës së ushqimit me një vetull të ngritur përpjetë në mënyrë demonstrative. Hë, mbarë qoftë, athua ç'paska ndodhur tash.

Ai i foli, gjerë e gjatë. Ajo dëgjoi e stepur. Vetulla e habitë u ul dhe fytyra i mori ngadalë një pamje të ngrirë asgjëthënëse, teksa po shikonte të shoqin përballë, ulur siç ishte atje tej tavolinës së shtruar, matanë reliefit të pjatave të nxjerra, almiseve, gotave, botilës së verës, qiririt të ndezur. Një zdap i gjatë, veshur me kostum



UDHËTIMI

Tregim nga Shqiptar Oseku

si gjysh, qeros, puçërran, meskin hidhnaq e inatçor. E kish duruar sa vite, së pari për hir të prindërve, mandej për hir të djalit, mandej thjesht se ish mësuar me praninë e tij, me cenet e hujet e tij idiote. E tash, ky debil po i tregonte sharte të burrnisë. Imagjino a, të lutem. Në veshë i oshëtinte pulsi i zemrës e qarkullimi i gjakut, e fjalët e tij i vinin si jehonë nga larg, pa arritur dot që t'i rrokë e t'i zbërthejë të gjitha. Por përmbajtja qe e qartë. Ai do të kujdesej për ekonominë e saj. Asaj s'do t'i mungonte asgjë.

Një zile ra në largësi dhe ajo, si të ishte në trans, u nis drejt kuzhinës. Qe ora për të nxjerrë tavën. I veshi dorashkat e sobës, u përkul. Ajri i valë e goditi si shpullë në fytyrë, ndërsa ai vazhdonte me lehjet nga fundi i botës, atje tej nga tavolina në dhomë të ditës. I fryu tavës, si rëndom. Atij s'po i pushtonte goja. Kreditë bankare ishin në rregull. Xhironlogaritë i kishin ndarë qyshkur. Ai po dërdëlliste me një zë të tensionuar, që kësaj iu bë sërish si zëri i babait të tij të ndjerë. Sa qe gjallë i vjehrrit, i kish ngatërruar shpesh në telefon zërat e tyre. Hë zemra, si je sot. Jo moj nuse, jam unë. Kjo qeshja e tyre idiote. Ajo mori tavën dhe hyri në dhomë të ditës. Ai vazhdonte të flasë, me sytë ngulitur te një cigare që kish ndezur. Ajo e pa nga lart. Kryet e tij qeros po shkëlqente nga djersët, në një si rreze të veçantë të dritës. Ajo mori frymë thellë, e ngriti tavën, e ia plasi me sa forcë që pati mu në rrashtë.

Kur i doli kllapia, pa veten të ulur në karrigen përballë. Trupi i tij ish nderë aty ku kish rënë, përposh tavolinës. Jashtë kish nisur të bjerë muzgu. Zhurmat e trafikut që vinin nga matanë dritaresh ishin mbarsur me si një tension nevrrik. U ngrit si e mpirë, e hoqi zvarrë trupin e tij drejt banjës. Mandej u kthye që andej, e lau dhe fërkoj me klorin për dy orë rresht dyshemenë në dhomë të ditës. Kur iu duk se u kënaq me punën e vet, shkoi së pari në kuzhinë, ku rrapëlliu për ca kohë. Mandej vajti e ndenji gjatë në banjë.

Të nesërmen u çua herët, e doli së pari me ca qese mbeturinash. Komunalja bënte xhiron herët paradite. Kur u kthye, griu qepë e mish me orë, duke mbushur zorrë të lara me suxhuk shtëpie. Mandej u la, ngjyu

flokët me një të zezë si pendë korbi, veshi fustanin e bardhë që ia kish ëndja furrtarit, vuri grim e parfum. Mori suxhukun e shtëpisë, e doli. Te furrtari arriti në orë të saktë. Ai ish një burrë i zoti, të cilit i kish ëndja të fryhet se kish nisur nga zero dhe sot kish sa furra anembanë qytetit. I kish ëndja edhe të komplimentojë gratë e huaja. Kësaj ia kish ëndja ta qortoje me lezet, e t'ia kujtojë se është e martuar. Po pse nuk vjen kurrë jot shoq këtu, e cimbsi ai. Është në udhëtim pune, u përgjigj kjo. Prapë?! pyeti ai me habi të shtirë, shiko punën tate zonjë se jot shoq ka gjetur një tjetër. Ku ta gjesh atë fat, se na nxorët për hundësh ju burrat. E ditke si mbushet suxhuku i shtëpisë zonjë, ia paske marrë dorën.

Në jetën e saj kuadrate, ky flirt i përsëritur pa sherr ishte si mëlmesë e lehtë, që as ia ndërton shijen as aromën jetës, po thjesht e bën më të durueshme.

Fundjavën e hoqi para televizorit. Të hënën vajti për të marrë suxhukun e tymosur, e veshur në fustan të kuq. Pse s'vjen yt shoq zonjë. Është në udhëtim pune.

Shiko hallin tënd zonjë. I njëjti dialog, e njëjta mëlmesë, që kësaj radhe i erdhi më e ëmbël. Sa mbërriti në shtëpi, i cingëroi telefoni. Ishte thirrja që po e priste, nga puna e të shoqit. Jo nuk di se ku është, s'ka qenë në shtëpi nga e enjtja. Ai më ka thënë se e keni nisur ju në udhëtim zyrtar gjer të martën. Një ndërprerje e sikletshme, ndërsa kolegë solidarë sigurisht po diskutonin se si të mashtrorjnë gruan mendjelehtë. Po po, natyrisht që ju thërras po u lajmërua, më bëtë një çikë merak. Të nesërmen ajo foli prapë me punën. Mandej thirri policinë.

Policët që erdhën në shtëpi ishin figura origjinale, një i ngjeshur e i shkurtër dhe tjetri zdap i hollë. Ajo i priti me trazim të kuptueshëm të gruas shqiptare, që pak ka frikë për burrin, e më fort se mos humb fytyrë. Apo nuk shkruanin gazetatat për kufoma burrash të gjetura në motele, nga ato motele ku dhoma merret me orë. Ç'do të thonë gjindja. Policët ishin plot mirëkuptim. Shihej se ky s'ishte rasti i parë. Meqë ishte kohë dreke, ajo i ftoi që të hanin, sa kish bërë suxhuk shtëpie. Policët së pari refuzuan, jo po detyrë zyrtare, jo po s'u lejohej. Por ajo ngulmoi. E policët

dikur pranuan, si t'ia prishnin një gruaje në krizë? Ua mbushi pjatat me suxhuk, e bukë, e kripë e qepë, me një repete të dytë, e mandej edhe një të tretë, se kurrë s'kishin ngrënë suxhuk më të mirë. U ndanë miqësisht, ata me gogësimë, e ajo e qetësuar ca nga një premtim i tyre se do ta njoftonin përditë rreth hetimit. Një shembull shkollor i policimit lokal në shërbim të komunitetit.

Policët kthyen aty prapë të nesërmen, sa për të treguar se s'kishin lajm prej burrit. Ajo u nxori prapë suxhuk përpara, me repete të dytë teksa ata po i tregonin me nge për hollësitë e hetimit. Rasti e donte një qasje me gjithë taktin e finesën që kërkon detyra zyrtare. Tek flisnin, policët shikoheshin shpesh, si për të kërkuar ndihmë e konfirmim nga njëri-tjetri. I thanë se kishin intervistuar shefin dhe kolegët në zyrën e burrit, së pari bashkërisht dhe mandej një nga një. Por asnjë syresh s'po gjente dot detajet e udhëtimit zyrtar për të cilin u kish folur zonja. Ajo u duk e stepur. Ra një heshtje e zorshme. Këto lëndë ishin të vështira. A mos i kish gjë lekë borxh dikujt bashkëshorti? A mos kish, ahëm, të njohur në tjera qytete? A mos kish dyshuar e shoqja gjëkafshë? Kish vërejtur gjë diçka të parëndomtë?

Ajo, e tronditur dukshëm, vajti e mekur gjer në kuzhinë. Kur u kthye, po ua mbante në duar porcionet e treta. U përgjigj me jo në të gjitha pyetjet e tyre, por shihej qartë se po e brente një krimb dyshimi i paemër. Ata shikuan njëri-tjetrin. Kuptohet se edhe ata kishin tashmë dyshimet e veta. E pra, nuk i kthehet dora një gruaje të në këtë gjendje. Natyra e gruas është delikate, dihet kjo. Ndenjën pak më gjatë se rëndom, duke e qetësuar me fjalë aq sa mundeshin. Do ta hetonin punën me kolegët në qytete tjera. Do të flisnin me dëshmitarë të tjerë. Ajo u tregoi se kish folur të premtën me mishtarin për burrin, ata i thanë menjëherë se do ta dëgjonin edhe atë. Do të

ktheheshin prapë të nesërmen. Dhe u kthyen vërtet të nesërmen në mbrëmje, të dy bashkë si rëndom, e gruaja u nxori prapë para suxhukun e shtëpisë. S'kam mundur ta fus gjë në gojë qëkur ndodhi kjo zezonë, u tha, më bëni nder po ta mbaroni këtë që ka ngelur.

Ata nuk ia prishën qejfin. Por lajm nga burri nuk kishte.

Në fund të javës, ajo lajmëroi policinë se do të shkonte në shtëpi të djalit të vet, që rastiste të banojë në një tjetër qytet. Gratë shqiptare shkojnë shpesh djali në raste të tilla, dihet kjo. U la adresë e numër telefoni, por ata s'u lajmëruan më. Suxhuku kish mbaruar dhe hetimet kishin hyrë në një fazë më pasive. Mbas gjashtë muajsh, i erdhi një informacion me shkrim se policia e kish kaluar lëndën në togun e rasteve të ftohta. Pista e vetme që i kish mbetur policisë ishte ajo më e besueshmja, se burri mund të kish shkuar jashtë vendit. Apo nuk ndodhnin të tilla raste përditë. Nga konsiderata për situatën e ndjeshme, ata nuk i treguan për relacionin jashtëmartesor të burrit, as për shkëmbimet e tij në chat me të tjera gra shqiptare në Perëndim. Natyra e gruas është delikate. Pse ta helmosh kot një të mjerë me dyshime që s'i ndreqin punë.

Ishin çift shqiptar si janë shumica prej nesh. Tolerantë me pahir ndaj njëri-tjetrit. Me folë kah del shpirti, në vende të qytetëruara ata do të ishin ndarë qëmoti. Kështu e ka jeta, askush s'e zgjedh vendlindjen e vet. Mirëpo, u ndodh nganjëherë edhe çifteve shqiptare më të rutinuar që ferri i përbashkët thjesht t'u bëhet i padurueshëm. Policia e kishte këtë shumë të qartë. Dhe atëhere, gjërat duheshin lënë ashtu siç ishin.

LOUISE GLUCK

1943-
Çmimi Nobel për vitin 2020. Më parë, Pulitzer
Prize për Poezinë, si dhe Poete Laureate
për ShBA-në.

MONOLOG NË ORËN 9 TË PARADITËS

Nuk është gjë e vogël të arrish
Këtë arie. Të jetosh
Me të ka qënë si ethe që prej fillimit
Gjashtëmbëdhjetë vite më parë. Për 16 vite kam
ndejtë
Që gjërat të shkonin më mirë. Më duhet të
qesh,
E merrni vesh, mësova të ëndërroj zbatice-
vdekjen papritë
Ose që ai të binte në dashuri prapë, Dhe ta
kthente
Zorrën poshtë drejt një gruaje tjetër. Këtë besoj
se e ka arritë.
Mendoj se vura re një mungesë, sot e kishte
lënë vezen e zier
Si një sy që jep shpirt, dhe bukën e thekur pa e
prekë.

CHARLES SIMIÇ

Serb-amerikan : 1938-2023
Dushan Simiç, i njohur si Çarls Simiç, është
një poet serbo-amerikan dhe redaktor për
poezinë i 'Paris Review'. Ka marr Çmimin
Pulitzer për poezinë në vitin 1990 (" Bota
nuk merr fund"). Ka qene i nominuar si Poet
Laureate Consultant për poezi në Library of
Congress, në vitin 2007.

**ÇFARË I THANË FALLXHORËT-
JEVGJITË GJYSHES TIME KUR AJO
ISHTE VAJZË**

Lufta, sëmundjet dhe kriza e urisë do të bëjnë
ty mbesën më të zgjedhur.
Do jesh një e verbër që sheh një film pa zë.
Do t'i hedhësh qepët e grira dhe copat e zemrës
tënde në të njëtin tigan.
Fëmijët e tu kanë për të fjetë në një valixhe
lidhur me litar.
Burri yt do t'i puth gjinjt çdo natë sikur të qenë
gurë varri.
Tashmë korbat po përgaditen dhëndurë për ty
dhe për njerëzit e tu,
Djali yt më i madh do të shtrihet me mizat e
ulura në buzët e tij
pa buzëqesh dhe pa mundur të ngre
dorën,
Do ta kesh zili çdo milingonë që ke ndeshur në
jetë dhe çdo bar të buzërrugëve.
Trupi yt dhe shpirti yt do rrijnë ulur në
paradhoma të ndryshme
duke përtypur të njëjtin
çimçakez.
Vogëlushe e bukur, mos je për shitje? - ka për të
thënë djalli.
Sipërmarrësi ka për të ble një lodër për nipin
tënd.
Mendja jote do jetë një fole me grerëza madje
dhe kur të jesh në shtratin e vdekjes.
Ti vetë do t'i lutesh Zotit, por Zoti do të vër një
tabelë
ku shkruhet- Mos më shqetësoni!
Mos më bëj pyetje të tjera, kjo është e gjitha
vetëm çfarë di unë!

SERGEJ CHUDAKOV


Rusi : 1937- 1990 (?) Sergey Ivanovich
Chudakov është një variant rus i Francois
Villon. I përjashtuar nga Universiteti
shtetëror i Moskës, filloi të shkruante, që të
mund të jetonte, nëpër gazeta dhe revista
me pseudonime të ndryshme. Ka qenë poet,
pornographer, pimp dhe hajdut librash.
Mendohet të ketë vdekur a ta kenë vvarë në
vitet e hershme pas 1990-tës.

LOZININ PUSHKININ NË PIANO

(Nga Rusishtja)
Loznin Pushkinin në një piano të madhe.
E vranë Pushkinin një ditë në duel.
U kërkoi një pjatë manaferra tundrash,

**POEZITË MË TË
BUKURA NË BOTË**

*Pjesë e përmbledhjes me poezi e përgatitur
dhe përkthyer nga Rudolf Marku*

**MARIN SORESCU**
(Rumani, 1936-1996)

Së bashku me studiuesin, historianin dhe
kulturologun e mirënjohur Aurel Plasarin,
kam patur fatin të njihem me poetin me fame
botërore, Soreskun, aso kohe sapo i emëruar
minister, në Bukuresht, në vitin 1993. Një ditë
më vonë Presidenti i Rumanisë na u anku se
Soresku është ministri më i keq i Qeverisë së tij,
ngase kishte munguar në të gjitha mbledhjet
e Qeverisë: "Zhduket me muaj të tera dhe
askush nuk e di se ku fshihet. Më thonë se
shkon në fshatin e lindjes dhe punon token
dhe zien çujka!". Soresku na shprehu dëshirën
e madhe që kishte për të vizituar Shqipërinë.
Dëshirë që nuk u realizua kurrë ngase pala
shqiptare e Ministrisë së Kulturës nuk i dergoi
kurrë një ftesë zyrtare!

SHAKESPEARE

Shekspiri e krijoi botën në shtatë ditë.
Ditën e parë krijoi qiellin, malet, thellësitë e
shpirtit,
Ditën e dytë krijoi lumenjt, detet, oqeanet,
Dhe të gjitha ndjenjat,
Për t'ia dhënë Hamletit, Çezarit, Mark Antonit,
Kleopatres, Ofelisë,
Othellos dhe të tjerëve
Që këta ndjenja të jenë të tyre dhe të
pasardhësve të tyre,
Shekuj pas shekujsh.
Ditën e tretë
Thirri të gjithë njerëzit që t'u mësojë shijet:
Shijen e lumturisë, të dashurisë, të dëshpërimit,
Shijen e xhelozisë, të lavdisë, e kështu me
rradhë
Deri në fundin e shijeve;
Atëherë ca njerëz të vonuar erdhën në minutin
e fundit,
Shekspiri u përkëdheli kokat me dhëmbshuri
Dhe u tha se ata do bëhen
Kritikë letrare,
Që ta shajnë veprën e tij.
Dita e katërt dhe e pestë qenë rezervuar për të
qeshuren.
I la kllounët të vijnë,
Për të bërë pirueta;
Bëri që Mbretërit, Perandorët,
Dhe të gjithë fatkeqët e tjerë të kësaj bote, të
harronin.
Ditën e gjashtë
U mor me zgjidhjen e ca punëve
administrative;
Lëshoi një stuhi,
Dhe i mësoi mbretit Lir
Se si të vendos në kokë një kurorë prej kashte.
Ngase kishin mbetur ca hedhurina nga krijimi
i Botës,
Me to bëri Rikardin e Tretë.
Ditën e Shtatë, vështroni nëse kish gjë tjetër për
të bërë.
Drejtorët e Theatrove e kishin mbushur
planetin me afishe;
Shekspiri mendoi se pas një pune aq të
lodhshme,
E meritonte dhe ai vetë të shihte një shfaqje,
Por, ngase qe i lodhur në ekstrem
Shkoi që të vdiste pak!

Mbështet pranë një raft librash, ndërroi jetë.

Në ujëra të akullt, me plisa të ngrirë
E varrosen Pushkinin, lavdëruar emri i qoftë.
Por dhe ne kërkojmë t'i ndeshim plumbat,
Ne varim veten, damarët i shqyejmë copë.

Të gjithë ne, sa shpesh na përplasim makinat,
Apo rrokullisemi shkallëve të dehur tapë.
Por ja që jetojmë-dhe me intriga banale
E plagosim Pushkinin prapë edhe prapë.

I vockël, derdhur në hekur, përkujtohet
Në një park pa njerëz ngaqë është acar
Ja ku qëndron (i dublikuar dhe si pjesë
këmbimi),
Me keqardhje të hidhur s'di nga t'ia mbaj

Tek kujton rininë, dhe titullin Kammerjunkner,
Këngët, lavdinë dhe vajzat në Kishinjov,
Gonçaroven në jelekun e bardhë e të qëndisur
Dhe vdekjen që s'mund ta marrësh kurrë si një
lojë.

VINCENT O'SULLIVAN
(New Zealand. 1937)**LIBERAL**

Mendojeni vetë:
Një njeri që ndjen për njerëzit,
Mik me fatkeqët,
Asnjë fjalë të keqe për Bar
-barët e supozuar me rroba romake.

Pranojeni këtë:
Një besimtar të kapacitetet e njeriut,
Zë që ngrihet kundër lojrave
Në të cilat trupi i njeriut është mish për sport,
Një njeri, sytë e të cilat prej muzikës mbushen
me lotë.

Së paku, duhet ta pranoni:
Asnjë njeri nuk e la derën time i uritur,
Asnjë grua nuk është ngacmuar,
Asnjë fëmijë nuk është keqtrajtuar,
Humanitas është e pashmangshme si fryma.

Unë që mund dhe të kisha, kurr
Nuk kam dhunuar, rrahur, shantazhuar,
Abuzuar me zyrën a pozitën;
Fshehur; nuk kam ndërhyrë te artet,
Nuk qëndrova asnjëherë mes njeriut dhe
perendimit të diellit .

E prapë vazhdoni të thoni,
Kam vvarë një Zot. Se pa-anësia ime
Paska qënë një farsë,
Se unë kam gisht në kaos.
Unë, Pont Pilati.
Që voton siç votoni ju.

ROGER MCGOUGH

Poet i njohur bashkëkohës anglez.
1937

MË LËNI TË VDES NË MOSHË TË RE

Më lëni të vdes në moshë të re
Jo vdekje të pastërt dhe në mes
Çarçafësh vdekje ujë-të shenjt
Jo me fjalën e famshmë të fundit kur të vdes
Vdekje paqësore pa frymë kur të mbes

Kur të jem 73 vjeç
Me t(h)umorin e pandreperë e gazmor
Ndoshta do më përplas përtokë në ashgol
Një makinë sport dhe në modë
Rrugës për në shtëpi,
Tek kthehem nga një gjithë natën-orgji!

Ose kur të jem 91,
Me flokët argjend thinjosh,

Ulur në një karrige tek një berber,
Rivalët e mi gangstjerë
Me automatikët amatorë do hyjnë me vrull,
T'i më qëllonjë në kurriz dhe brenda në trup !

Ose kur të jem 104,
Dhe mos të kem të drejt të hyjë në Tavernë,
Ndoshta dashnorja ime,
Do më kap në shtrat me vajzën e vet,
Duke pasë frikë për djalin e saj
Do ma pres copë-copë trupin tim,
T'i flak, veç një pjese, që do'e ruajë me
përkushtim.

Më lëni të vdes në moshë të re,
Jo një të çliruar mëkatesh në majë gishtash
Në dyll qirinsh dhe vdekjeje që t'zvoglon
Jo me hapje perdesh me kënde simetrike
Për një Vdekje si' Ah, sa e bukur kjo vdekje
fisnike!

WISŁAWA SZYMBORSKA

Çmimi Nobel për letersine -viti 1996. Poete polake, eseiste, përkthyesë. Akademia Suedeze e përcaktoi poezi e saj si një ‘Poezi me një ironi preçize e cila bën të mundshme që përmbajtja historike dhe ajo biologjike të dalin në dritë në formën e realitetit njerëzor’.

LINDUR

Kjo është e Ëma, Kjo grua e vogël, Krijuesja me sy gri.

Varka ku vite, më parë, Ai lundroi për në breg.

Varka nga e cila ai luftoi të kërcente, Në Botë, Në jo- përjetësi.

Nëna biologjike e burrit Për të cilin hidhem mbi zjarr.

Pra, kjo është, e vetmja grua Që nuk e zgjodhi Të përfunduar dhe të plotë.

Vetëm ajo e mori, Drejt lëkurës që njoh, Duke e lidhur me eshtrat Që janë të fshehura nga unë.

Vetëm ajo i dha Ato sy gri Që ai m’i jep me vështrime.

Pra kjo është ajo, Alfa e tij Përse duhej të ma prezantonte?

Lindur, Madje edhe ai i lindur. Si gjithkush tjetër, Si unë që do të vdes.

Bir i një gruaje të vetetë, I ardhur së pari prej thellësive të trupit. Udhëtar drejt omegës.

I ekspozuar tek mungesa e vet Që vjen nga kudo Dhe në çdo kohë.

Dhe koka e tij Është një kokë kundruall murit E cila nënshtrohet veç në kohën e duhur.

Dhe lëvizjet e tij Janë anullimet, E fatit të zakonshëm.

E kam kuptuar, Se kishte qënë i mbrojtur përgjysëm në rrugën e vet;

Po ai kurr s’ma kish thënë Kurr.

-Kjo është nëna ime- Më thotë ai, vetëm kaq!

DUKE SHKRUAR NJË CURRICULUM VITAE.

Çfarë duhet të bësh? Duhet të plotësosh aplikimin Dhe bashkëngjitur- një CV.

Pavarësisht sa e gjatë është jeta jote Curriculum Vitae duhe t’jetë i shkurtë .

Ji i detyruar të jesh konçiz, të zgjedhesh faktet Të kthesh peisazhet në adresë Dhe kujtimet e largëta në data fikse! Nga gjithë dashuritë, përmend veç martesën Dhe nga fëmijët, përmend veç ata që kanë lindur!

Është më e rëndësishme kush të njeh ty, Se sa kë njeh ti vetë ; Përmend udhëtimet- veç ato jashtë Pëlqimet- çfarë pëlqen, jo pse i pëlqen Fletë Lavdërimet-pa thënë pse janë dhënë.

Shkruaj sikur asnjëherë nuk ke folur me veten Dhe pa patur as më të voglin dyshim.

Mos thuaj asgjë për qenin tënd, macet a zogjt Për dhuratat e çmuara që i ruan, miqt dhe ëndërrat

Thuaj çmimin, jo vleren, titullin jo përmbajtjen Thuaj numrin e këpucëve dhe jo ku ke bredhur Me personin që të ka marrë me vete.

Bashkëngjit një foto çasti, që tregon një vesh tëndin Por për të treguar formen e tij, jo atë që dëgjon.

Dhe çfarë dëgjon? Zhurmëmime makinash që shndrojnë letren në brum-pastë.

OCTAVIO PAZ

Çmimi Nobel- 1990. Poet Mexican: 1914-1998; 1977- Jerusalem Prize; 1998 : Miguel Cervantes Prize;1981-Neustadt International Prize;

URA

Mes këtij çasti dhe këtij çasti Mes asaj që unë jam dhe ti je, Fjala Urë.

Duke hyrë në të Ke hyrë në vetvete Bora ndërlidhet Dhe kyçet si një rreth.

Nga njëri breg në tjetrin Gjithmonë do ketë Një trup që zgjatet : Një ylber.

Unë do flejë poshtë harqeve të tij!

ELIZABETH BISHOP

Poete dhe tregimtare amerikane. 1911-1979. Ka qënë Consultant in Poetry në Biblioteken e Kongresit amerikan nga 1949-1950.Fiutuese në poezi e Pulitzer Prize -1956, dhe fituese e Çmimit të Librit Kombëtar-1970. Po ashtu është nderuar me Neustadt International Prize për Letersinë. Dwight Garner ka shkruar se ajo është ndoshta ‘poetessa e lindur më e talentuara e shekullit të XX’.

NJË ART

Nuk është e vështirë ta zotërosh Artin me humbë, Shumë gjëra duken se i humbasim me qëllim Kështu që humbja e tyre nuk është që ka kosto shumë.

Çdo ditë humb më mirë diçka; pranoje kët’problem, Kur humb çelësin e derës, orën ters që vjen, Artin e humbjes nuk qënka vështirë ta shtish në mend.

Praktiko që t’humbasësh më shumë, më shpejt e më shumë : Ku ke dashtë të udhëtosh, emërat, se në ç’vend. Për asnjëren nga k’to humbje ti nuk mbytesh në Lum.

Orën e nënës humba, shtëpinë në parafund, Dhe nja tre shtepi të tjera ikën si pa të keq Nuk qënka vështirë t’ m’sosh Artin me humb.

Humba dy qytete, e çfarë qytetesh! Dhe përtej Ca mbretni, që zotëroja, një Kontinent, dy lumenj Më merr malli për to, po prapë, tragjedi nuk është.

Edhe ty me t’humб (zë gazmor, një gjest që më pëlqen) Unë nuk do të kisha rrejtë. Është e qartë krejt, Nuk qënka vështirë t’m’sosh Artin me humb Edhe pse kjo po m’duket (shkruaj) si katastrofë-tërmet!

VARLAM SHALAMOV

Rusi. 1907-1982

Njëri ndër shkrimtarët më ikonikë rus. E ndjeu veten shkrimtar që në fëmëninë e vet. Kaloi pjesën më të madhe të jetës nëpër burgjet staliniste dhe në kampe izoluese. Libri ‘Tregimet e Kolyma-s, është konsideruar si libri përfundimtar i përshkrimeve të burgjeve

komuniste, aq sa para rrëfimeve të Shalamovit dhe vetë Solzhenicini duket disi i zbehtë. Poezia e dytë shpreh zhgënjimin pas vdekjes dhe denoncimit të krimeve të Stalini!

LETRA

Unë vazhdoj, s’ndalem. Vdekja më rri pranë, Veç një zarf i kaltër, Vetë jetën e mban.

Letren e kam shkruar Që në vjeshtën tjetër, Veç një gërmë të vetme Dhe asgjë më tepër.

Dhe prapë nuk e di Për ku ta postoj, Po t’ kisha adresen, S’do mundja të rroj!

1955

MENDOJA SE...

Mendoja se do ne do të ishim heronjt, E kantatave, afisheve, librave gjithfarë, Se kapelat do fluturonin në ajër, Dhe vetë rrugët do çmendeshin fare.

Ishim kthyer! Kishim qënë të papërkulur! Kishim qëndruar pa tradhëtuar vetveten!

Po qyteti kishte një plan të vetin aty, Veç sa mërmëriti nën zë një fjalë a dy!

VEDIMIR KHLEBNIKOV

Russi. 1885-1922

NATË NË TRANSHE

Na duhen lulet për t’i vënë në arkivole, Por arkivolet na thonë se ne vetë jemi lulet, Që nuk zgjasim më gjatë nga lulet.

PABLO NERUDA

1904-1973

Kili : Çmimi Nobel :1971

MOS SHKO LARG

Mos shko larg, as dhe për një ditë të vetme, sepse, Sepse- si mund ta them! - një ditë është gjatë Dhe më duhet të pres për ty, si në një stacion të zbrastë Kur trenat e parkuar flejnë diku në natë.

Mos më lë, as dhe për një orë të vetme, sepse Pikat e vogla të ankthit do të rrjedhin bashkë lumë, Tymi që endet me gjatë një shtëpi do të sillet endacak Drejt meje, për t’ma mbytur zemren që ka humbë.

Oh, ndoshta silueta jote kurr nuk do çbëhet në plazh Ndoshta qepallat nuk do të përpëliten në distancën bosh, Dashuria ime, le të jemi në çdo sekond bashkë!

Ngase në këtë çast ke ikur shumë larg Do endem si një labyrinth mbi tokë, duke pyet: Mos do më lesh të vdes këtu? A do vish prapë?

PËRRALLA E FLOÇKES DHE E TË DEHURVE

Gjithë ato burra që ishin brënda Kur ajo hyri lakuriq, Të gjithë ishin duke pirë; filluan të pështynin. Ajo vinte për herë të parë nga lumi, nuk dinte asgjë.

Ishte një floçkë që kishte humbur rrugën . Fyerjet depertuan mishin e saj të panjollosur, Gjestet e pista përmbytën gjoksin e saj të artë, Duke mos ditur ç’janë lotët, nuk i fshiu lotët, Duke mos e ditur se ç’janë rrobat, nuk kishte rroba, E nxinë trupin e saj me tapa të djegura dhe bishta cigaresh, Dhe u shkrinë së qeshuri duke u shkrá në dysHEME, Nuk foli, ngase nuk kishte të folur,

Sytë i kishte në ngjyrën e dashurive të largëta Krahët e saj të binjaktë qenë prej topazi të bardhë. Buzët i lëvizën, në heshtje, me një koral dritash, Dhe papritur doli jashtë drejt derës. Hyri në Lum, dhe u bë e pastërt Duke ndriçuar si një gurë i bardhë në shi, Dhe pa vështruar pas, notoi prapë, Notoi drejt boshllëkut, notoi drejt vdekjes.

VALERY LARBAUD

(1881-1957)

Duke krijuar me imagjinatë poetin A.O.Barnabooth, francezi Valery Larbaud jo vetëm bëri të mundur të shkruante një libër me lirika mbresëlënëse dhe të bukura, por ai gjithashtu ngriti një urë bashkuese mes dy poetëve më të pangjashëm në dukje të parë, mes Guillaume Apollinaire dhe Walt Whitman. Libri ‘‘Poezitë e A.O.Barnabooth., (1908) është botuar së pari inga Gallimard’s Pléiade, dhe është konsideruar si një perlë e poezisë franceze.

E PAEMËR

Kur të kem vdekë, kur të jem njëri nga të dashurit tuaj të ikur (Të paktën, a e kujtoni sado pak, o njerëz, Atë tipin me të cilin aq shpesh ndeshët brrylat në rrugë?)

Vetëm ca imazhe do mbesin në poemat e mia, Imazhet e sa e sa vendeve, e sa vështrimeve, e këtyre fëtyrave

Që i pashë shpejt e shpejt në turmën që lëvizë? Kam ecur me ju, duke shmangur trafikun, Po ashtu si ju, jam ndalë te vitrina dyqanesh, I kam dhënë me sy komplimenta grave të bukura,

Kam ecur drejt k’naqësisë dhe lavdisë Me besimin e madh në zemër se çdo gjë po ndodh.

Kam ecur i lumtur në mesin e turmës, Sepse jemi pjesë e turmës, unë dhe ëndrrat e mia Dhe nëse jam paksa -për dreq- i ndryshëm nga ju

Kjo ndodh ngase shoh, Këtu, në mesin tuaj, si një vegim hyjnor Që nxitoj drejt saj të më prek sado lehtë, Të përbuzuren, të braktisuren mënjëanë, të ndaluarën, Dhjetë herë të mistershmen, Bukurinë e padukshme!

S.M.ARDAN

Indonesi, 1932-2006

ME DY MIKESHA

Çdo herë që marr honorare, Ftoj miken time numër I për darkë në restorant, Dhe për shëtitje në ajrin e natës Sidomos nëse koha është e bukur. Të dy ndjehemi plot e përplot me dashuri.

Ndërsa kur kokën dhe zemrën i kam të rënduara, dhe xhepin bosh, Shkoj të gjejë miken time II. Ne gjithashtu flasim me dashuri, duke bërë dashuri, Por jo rreth dashurisë, Mes çajit që sërëbim dhe kafshimeve të kikirikëve.

Sapo marr prapë honorare, Shkoj menjëherë në dasmën e mikes I I japim njëri-tjetrit duart plot dashuri, dasma ëshë e mbushur plot dashuri, Tani që netët janë të kthjellta dhe nuk bie shi.

Ditët tjetër blej dy tufa të vogla me lule, Të cilat i shpërndaj në varrin e kuq të mikes time II Dhe me paret që kanë mbet, shkoj të strukem në kinema I vetëm krejt.

Po të merrja honorare për këtë poezi, Do e kisha ftuar në kinema me gjithë të shoqin, miken I.

Dhe ndoshta do i ftoja dhe në restorant, Më pas, me paret që do të tepronin, do blija lulet që do i shpërndaja në varrin e mikes II, Pastaj do isha kthyer pas për t’u zhytur, Në vetmi...

Lajmi i vdekjes së shkrimtarit të shquar Gjerman, Martin Valser, m'u duk i rremë ose i pabesueshëm.

Në të vërtetë, shkrimtarët e mëdhenj nuk e njohin vdekjen. Ata nuk e pranojnë atë, por e njohin statusin e saj. Martin Valser shkon ndoshta më larg. Ai ndjek me këmbëngulje një shteg të

fshehtë, që e nje vetëm ai.

Të mëdhenjtë nuk e njohin vdekjen, por vetëm ikjen fizike. Pra, ata dinë të vdesin vetëm fizikisht.

Kjo do të thotë, të mos vdesësh si të tjerët, por të ikësh në një jetë të përtejme. Hebrejtë thonë se njeriu vdes dy herë: njëherë kur vdes dhe një herë tjetër, kur ai harrohet. Harrimi rri gati mbi çdo njeri si të ishte shpata e Damokleut. Harrimi është krematoriumi që e pret çdo krijesë. Kështu pra, dalim të një forcë asgjësuese, që ndryshe mund të quhej koha, e cila mori mbi vete, pushtetin më të madh dhe e bëri njeriun rob të saj.

Mijëra vjet me radhë, ne nuk mësuam gjë tjetër: Vetëm koha vendos për gjithçka.

Ne thoshim ç'thoshim, për këtë apo për atë poet, në fund, vendoste vetëm koha ose ndryshe, e ardhmja.

Letërsia e madhe vazhdonte të duronte gjithë marrëzitë e botës.

Një përbindësh misterioz e ndiqte atë hap pas hapi, duke ia përgjakur trupin e bukur, me shumë plagë të rënda, të pashërueshme.

Por ndodhi çudia: letërsia, në vend që të ndërronte jetë, ishte koha ajo që humbi plotësisht autoritetin e saj absolut.

Më vonë, rënia komike e kohës shkaktoi efekte tragjike.

Një shkrimtar si Martin Valser ishte i aftë të observonte dhe të zbulonte të gjitha perspektivat e brendshme të mundshme, duke u bërë mjeshtrë i konflikteve të brendshme.

Ai shkroi mbi shtatëdhjetë vepra në prozë.

Ndër më rëndësishmit ishin :

Martesë në Philippsburg, Lufta e Finkut, Një brirësh, Pa askënd, Gjah, Gjysmë loje, Mbrojtja e feminisë, Matanë dashurisë, Nënë e bir, Rrëzimi, Shtëpia e mjellmës...

Ai nuk interesohet për anën e jashtme. Heronjtë e tij ishin antiheronj.

Mbas maturës, ai studioi filozofi, literaturë dhe histori.

Jeta e tij ishte gjithashtu një aventurë e pazakontë.

Ishte shumë produktiv.

Çdo vit shkruante një roman.

Martin Valser shkroi gjithashtu mbi pesëdhjetë pjesë teatri, dhe pati një sukses të madh.

Ai inskenoi edhe vetë, mjaft pjesë.

Gjatë studimeve ai ishte reporter.

U bë shkrimtar i lirë.

Në grupin 47 u bë një nga personalitetet më të rëndësishëm.

Ai ishte kundër luftës në Vietnam.

Martini kishte energji radioaktive.

i palodhshëm.

I pangopshëm.

I padepërtueshëm,

Një trio e pazakontë.

E akuzonin për ambivalencë.

E akuzonin sepse nuk kishte asnjë punëtor në veprën e tij.

Ai përgjigjej thjesht:

Unë

Nuk jam

Proletar.

Ai ishte një esprit e pavarur dhe e lirë.

Ai kishte fjalet e tij.

Ai kishte mendimet dhe armë e tij unike.

Një dialog jo i parëndësishëm.

-Ju jeni një analitik i përkryer.

-Po, jam 96 vjeç, këtej e tutje nuk do të pranoj asnjë vit më tepër.

-ju jeni kundër industrializimit.

-Jo, unë, por industrializimi është kundër meje.

-Ti je një orator.

-Po.

-Çfarë është gjuha?

-Gjuha është poeti.


-Rroftë rasti.

-Nuk ka rast.

In Memoriam

MARTIN WALSER, e pashpjegueshmja dhe pavarësia absolute

Nga Fatmir Alimani



lëvdoi mjaft shkrimtarin Martin Valser. Por... më vonë loja ndryshoi krejtësisht, derisa u bë një ndeshje e fortë armiqësore.

Kulmi arriti në kishën Paulus, në Frankfurt, mbas së cilës ai ndërroi shtëpinë botuese Suhrkamp me

Rowolt. Debatu qe i madh. U zgjuan papritur të gjitha shtresat e shoqërisë gjermane. Martini madje shkroi një libër me titullin Vdekja e një kritiku. Që nënkuptonte gjithçka. Dy kalorësit bashkëkohorë mbetën të tillë gjer në vdekje. Nuk më kanë kuptuar, thoshte Martini.

Ndërkaq të dy botonin libra. I pari vdiq kritiku pastaj shkrimtari. Në një nga romanet, ai tregon si është zhvilluar dashuria për gjuhën, me një theks të veçantë. Po kështu ai zbulon paralele të qarta ndërmjet letërsisë dhe fesë. Të dyja përipiqen të lumtërojnë botën.

Ai është i pavarur jo vetëm pse ka gjithnjë aq sa i duhen, por edhe pse ai është edhe vetë një njeri

Që e meriton plotësisht emrin e tij. Financa e tij personale të linte një impresion të vazhdueshëm. Përse? Çfarë mungonte, akoma?

Prandaj, ai i shikonte ndryshe fenomenet dhe gjërat. Shkrimi dhe jeta u bënë një.

Pa asnjë ngurrim, ndryshe nga të tjerët, ai i sheh problemet, qartë dhe të ndërlukuara.

Ai e konsideronte si një gjë të domosdoshme bashkimin e Gjermanisë.

Pyetja themelore ishte: A do të arrinte ai vallë, të kishte vendin e tij në jetën e përtejme, që do të ishte më e bukur se çdo bukuri tjetër. Që do të ishte ashtu siç nuk do të ishte asnjë bukuri tjetër.

Që do ta ndihmonte njerëzimin të ngrihej çdo ditë, mbi veten e vet. Ai donte më shumë. Ai donte të

zbulonte sekretin e të pashpjegueshmes. Për të arritur në këtë pikë delikate dhe të fortë, duhej ndoshta të flijohej një jetë e tërë.

Ndër të tjera, ja çfarë thotë autori: "Forca tërheqëse e të pashpjegueshmes është pushteti i të pashpjegueshmes.

S'ka kurrfarë shpëtimi. E pashpjegueshmja është gjithnjë aty ku je ti.

Ty të është diktuar që ti të mos mendosh më për asgjë, përveç të pashpjegueshmes.

Asnjë njeri nuk mund të qëndrojë si memec përballë të pashpjegueshmes. Ai i flet.

Ai nuk thotë me anë të fytyrës, cili ishte ai. Ai bënte të shpjegueshmen. E pashpjegueshmja hesht me një ndjesi shkatërruese. Ai që i hedh një llaf të pashpjegueshmes, sepse ai të pashpjegueshmen si të tillë, nuk mund ta duronte, dhe gjatë kohë që ai foli si t'i vinte, u bë e qartë, që asgjë prej çfarë kishte folur ai, nuk do të quhej, shpjegim.

E pashpjegueshmja është e paafrueshme. Ajo nuk ka asnjë të çarë. Asnjë mimikë. Asnjë atmosferë. Ajo refuzon parandjenjat. Me fjalën refuzim është thënë tepër shumë. Ajo nuk ka kurrfarë gjestesh, që të fshihte diçka në to. Ajo nuk ka asgjë. Ajo është asgjë. Asgjë, përveç të pashpjegueshmes. Ajo nuk është enigmë. As parabolë, as metaforë. Ajo nuk do të jetë asgjë. Ajo është e pashpjegueshmja. Si e tillë, ajo është gjëja më e fuqishme që ekziston.

Martin Valser lindi më 24 mars 1927 në Vaserburg. Ai ndërroi jetë më 28 korrik 2023, në Bodense. Një zë që vjen nga larg:

Kush më kuptoi, më kuptoi. Të tjerët...



Ajo njihje Marks, Bethovenin, Robert dhe Klara Shumanin, vëllezërit Grim, Liszt e të tjerë, duke e kthyer kështu në një revolucion të romantizmit femëror.

BETTINA BRENTANO: MUZA E TË GJITHËVE!

Nga George Perdota



Përktheu Jola Tasellari

Ajo ngjalli kureshtjen e Napoleon Bonapartit dhe bënte shëtitje intime me Karl Marks, ruante një pasion të veçantë për Gëten, i cili ia shndërroi dëshirën e zjarrtë në një raport të stërzgatur letërkëmbimi, dhe ishte muza e Bethovenit. Robert Shuman dhe Johannes Brahms i dedikuan këngë, kurse vëllezërit Grim një botim të përrallave të tyre. Kush ishte kjo grua e jashtëzakonshme? Emri i saj ish' Elizabeth Brentano, ndryshe njihet si Bettina. Ishte motra e poetit të njohur Clemens Brentano, dhe gruaja e një tjetër poeti, Achim von Arnim, të cilit i lindi njëmbëdhjetë fëmijë. Nuk shkroi kurrë poezi, megjithatë shkrimet e saj habitën e mrekulluan lexuesit. Gjithashtu dhe kompozonte. Dy këngët e saj të para u shfaqën nën pseudonimin "Beans Beor" (bekim, jam e bekuar). Duke iu qasur kompozimit përmes pikëpamjes letrare, disa nga këngët iu publikuan përgjatë jetës. Kompozitorë të rinj e virtuozë si Franz Liszt, Joseph Joachim, Peter Cornelius dhe Johann Kinkel, e admironin si mikeshë të Gëtes e të Bethovenit, dhe ndikimi i saj mbi muzikantët e rinj kishte rëndësi të lartë. Ajo ishte një "muzë e lartësuar, një lëvizje letrare e drejtuar prej një gruaje, njëherazi figura më përfaqësuese e shekullit të romantizmit".

Bettina lindi në Frankfurt në vitin 1785 dhe e ëma kishte qenë dashuria e parë e Gëtes. Kur ajo vdiq, Bettina-n e dërguan në manastir dhe gradualisht, Clemens-i, vëllai i saj i marrë, i cili njëherë kishte lyer ngjyrë blu tërë dhomën, nga dyshemeja te tavani, përfshi tapetin, perdet, mobiljet dhe fytyrën e vet, u bë udhëheqësi i saj. Clemens-i dhe miku i tij, Achim von Arnim, me ndihmesë të madhe nga Bettina, mblodhën poezi popullore të cilat i publikuan gradualisht si teza mbi Romantizmin Gjerman, *Des Knaben Wunderhorn*. Bettina kish' qenë gjithnjë rebele dhe dashuria e saj e parë ishte një vajzë pesë vite më e madhe, të cilën e njohu në manastir. Kur ishte njëzet e një vjeç e prezantuan me Gëten, dhe kur ai e pyeti se çfarë i interesonte, iu përgjigj: "Asgjë nuk më intereson veç teje". Mesa duket, "iu shtri në prehër, i hodhi krahët në qafë dhe e zuri gjumi". Qartazi donte të bëhej muza e tij, ndoshta edhe më tepër. Në një letër i shkroi, "Kam qenë xhelozë dhe nganjëherë e kam ndiere veten si subjekt të poezive tuaja, ndaj pse t'ia privoj vetes lumturinë? Çfarë realiteti më të lartësuar ka se ëndrra?" Gëte, mbi tridhjetë vite më i madh, nuk dinte si ta përballonte, kështu që letrat e saj i shndërronte në materiale për librat dhe poezitë e veta, "por e shmangu intimitetin".

Rreth viteve 1810, Bettina ishte njohur me një tjetër artist të madh të kohës, Ludvig van Bethoven. Sipas vetë memoareve të saj, "një ditë, ndërkohë që Bethoven po punonte në piano, i vendosa duart mbi supe. U kthye me inat, vetëm për të gjetur një grua të re e tërheqëse, që i foli në vesh: Më quajnë Brentano." Dukshëm, Bethoven u magjeps prej sjelljes së saj dhe bashkë kultivuan një miqësi të ngushtë, por kurrë nuk qenë partnerë. Ishte sigurisht e vendosur për t'i bërë bashkë Gëten dhe Bethovenin, gjë që ndodhi në një takim të vetëm e jo të lehtë. Në letrat e saj citonte vazhdimisht Bethovenin dhe Gëten, por të gjitha fjalët ishin shpikjet e saj. Adhuresit sugjerojnë se Bettina krijoi zhanrit e vet letrar, romanin epistolar.

Ndikimi i Bettina-s u ndie përmes Europës Qendrore dhe kjo përfshiu mbështetjen për Johanna Kinkel-in, kompozitorin, shkrimtaren, pianisten dhe mësuesen e muzikës që publikoi rreth shtatëdhjetë këngë për këndim e piano. Pasi i shpëtoi të shoqit abuzues, Johanna jetoi me Bettina von Arnim për muaj të tërë dhe e ndihmoi me projekte kompozimi dhe përkthimi. Koleksioni i saj i parë me gjashtë këngë u publikua nën titullin "J. Mathieux", dedikuar mentorit të saj, ndërsa kritiku Ludwig Rellstab, sugjeron se shpejt do të bëhet e njohur dhe e respektuar. Bettina bëri fushatë të palodhur kundër anti-semitizmit, shkroi disa libra politikë shumë të rrezikshëm për çështjen e çlirimit nga sundimi Prus dhe madje u damkos si komuniste. Libri i saj i fundit, *Biseda me djajtë*, gati e shkatërroi financiarisht, dhe duke vështruar bustin e Gëtes, ndërroi jetë në shtratin e saj në moshën shtatëdhjetë e katër vjeçare. Dijetarë dhe kritikë bashkohen me mendimin se Bettina von Arnim ishte e veçantë në një shekull plot me figura ekstravagante. "Ishte muza e të gjithëve, kërkoi dashuri nga çdokush, por nuk ishte asgjë më shumë se njeriu i vetes. Krijimi i saj më i madh ishte vetvetja."

"...me një shkrim veçanërisht të thjeshtë, e herë-herë edhe sarkastik, Aliçka na përcjell mesazhin se, nëse dëshiron të mbijetojë, njeriu duhet të marrë në dorë të ardhmen e tij.

Një regjim autoritar i bazuar në dhunë dhe mungesën e harmonisë sociale në fund krijon njerëz, të cilët ose do të kërkojnë përgjithmonë vartësinë e tyre nga një autoritet më i lartë ose do të përfundojnë në veprime spazmatike."

BOTOHET NË ATHINË ROMANI I YLLJET ALIÇKËS "VALSI I LUMTURISË"

(përkthyer nga Andreas Zarbalas, botim i Plethora).

Nga Manos Kontoleon

Ndonëse ka disa tituj librash letrarë të shkruar nga autorë bashkëkohorë shqiptarë që janë përkthyer në gjuhën tonë, nuk mund të pretendohet se publiku bibliofil grek është i njohur me stigmën e letërsisë së sotme shqipe. Pra, mbetet çështje zbulimi i identitetit letrar të një vendi që kufizohet me vendin tonë dhe ku pranë nesh jetojnë një pjesë e madhe e njerëzve që kanë lindur atje.

Plethora Publications – një shtëpi botuese, degë e Eurasia Publications – është përpjekur të plotësojë këtë boshllëk si në të kaluarën ashtu dhe, duke vazhduar këtë përpjekje. Kohët e fundit kjo shtëpi botuese fundi ka nxjerrë veprën "Valsi i lumturisë" nga autori shqiptar Ylljet Aliçka.

Aliçka ka shkruar disa romane dhe përmbledhje me tregime të shkurtra, si dhe skenarë filmash artistikë, bazuar në librat e tij. Përkthimet e librave të tij si dhe përshtatja e tyre në kinema është shoqëruar me njohje ndërkombëtare, si çmimi për filmin "Slogans" në Festivalin e Filmit në Kanë dhe në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit në Tokio në vitin 2002, ndërsa ne patëm mundësinë ta takojmë për herë të parë në Festivalin e Filmit të Selanikut në 2008. Librat e tij janë botuar në mbi dhjetë gjuhë:frëngjisht, gjermanisht, italisht, arabisht, polonisht, çekisht, norvegjisht, anglisht, persisht, maqedonisht, gjuhën kineze dhe esperanto. Drama e romanit "Valsi i lumturisë" bazohet në një ngjarje reale ndodhur në Shqipëri në vitin 1985. Një familje shqiptare – gjashtë vëllezër e motra – gjatë ceremonisë së varrimit të Enver Hoxhës, futen në ambasadën italiane dhe kërkojnë azil politik. Në klimën e asaj kohe, veprimi i tyre tronditi mirëfilli mbarë vendin dhe shumë shpejt merr dimensione ndërkombëtare.

Ajo ditë, që me një lëvizje spontane, i bëri ata të kërkojnë azil, do të jetë një ditë vendimtare për gjithë jetën e tyre.

Veprimet diplomatike kundër reagimeve të pabaza të regjimit, i cili tashmë ka nisur të shembet, nuk sjellin asnjë rezultat.

Brenda ambasadës italiane, gjashtë anëtarët e familjes Tota përjetojnë një formë

të re izolimi dhe më pas shembullin e tyre do e ndjekin disa qindra mijëra bashkatdhetarë të tyre, dërsa vendoset regjimi i ri politik. Për shkak të këtij izolimi të ri, lidhjet mes tyre do të dëmtohen, personalitetet e tyre disi të mashtruar nga një regjim autoritar do t'i pengojnë ata të ecin dinamikisht në rrugët e reja që ndjekin bashkëkombësit e tjerë dhe përfundimisht një nga një, ata do të kalojnë në një qorrsovak psikologjik, pse jo dhe biologjik.

Në këtë panoramë tregimtare, Aliçka vendos rrefimin e tij dhe me një shkrim veçanërisht të thjeshtë, e herë-herë edhe sarkastik, përcjell mesazhin se, nëse dëshiron të mbijetojë, njeriu duhet të marrë në dorë të ardhmen e tij.

Natyrisht, ky pozicion - dhe pa u përshfaqur dukshëm një gjë e tillë - mbështet mesazhin sesi një regjim autoritar i bazuar në dhunë dhe mungesën e harmonisë sociale në fund krijon njerëz që ose do të kërkojnë përgjithmonë vartësinë e tyre nga një autoritet më i lartë ose do të përfundojnë në veprime spazmatike.

Prozozim interesant ky, i këtij shkrimtari që lëviz mes letërsisë fikson dhe asaj dokumentare.

Fragment nga libri

"Pas darkës ai u ul në verandën përballë kabinës dhe shikoi diellin duke perënduar në det. Iu kujtua se ishte ulur përsëri në të njëjtin vend, duke vështruar detin, në një kohë kaq të largët saqë dyshonte nëse kishte jetuar vërtet të njëjtën imazh. Pastaj ai hoqi dyshimin nga mendja e tij dhe u përpoq të zbulonte pse pjesa më e madhe e planetit është e mbuluar me ujë.

"Pse duhet të ndodhë kjo?" pyeti veten, derisa e zuri gjumi i lehtë nën rrahjen monotone të valëve, pa e zgjidhur enigmën e ujit. Të nesërmen u zgjua herët nga zhurmat e minjve që vraponin nga kabina në kabinë".

Dhe së fundi, romani ka ardhur mrekullisht në gjuhën greke nga përkthyesi i talentuar Andrea Zarballa.



1

Vizita e dytë pas 18 vjetësh ishte sa e papritur, aq dhe e nevojshme për Milin. Një vit më parë, 1966, zjarri që përfshiu gjithë bllokun shkumbëzoi studion e tij, atë reliqë aq të çmuar të artit të tij ku prej tij fotografoheshin, sportistë, artistë, valltarë, këngëtarë. Humbja ishte e madhe. Ekuipmentet dhe sendet personale ishin zhdukur, ose ishin kthyer të pavlefshme. Për fat të mirë dy të tretat e negativeve kishin shpëtuar. Pas kësaj kujton Mili, "Ishte koha për rifillim."

Rifillimi erdhi. Revista Life kishte menduar për një botim të veçantë për Pikason. Për këtë në Mars, 1967, Xhorxh Hunt (George Hunt), menaxheri botues i LIFE, e vizitoi Pikason në shtëpinë e tij, Notre-Dame-de-Vie, në Mougén në Jug të Francës. Kjo vizitë u bë shkak që LIFE të ngarkoj Milin në një angazhim strikt, të fotografonte artistin dhe skulpturat e tij. Me mbresat dhe fotografitë e kësaj vizite, Mili botoi në 1970 librin, "PICASSO-S THIRD DIMENSION."

Për të futur lexuesin në subjekt, mendoj se është e nevojshme të prezantoj Editorialin e Xhorxh Hunt botuar në LIFE, 27 Dhjetor, 1968.

LIFE, 27 Dhjetor, 1968.

Nga Xhorxh Hunt (*Fragment*)

"Ne gjykojmë se ky gjigand ishte Mikelanxhelo ose Da Vinçi i kohës tonë, një forcë masive kulture, tani i moshuar, i tërhequr, i thellë dhe brenda kornizës së tij të rreptë, një thesar eksperience.

...Ishte e vështirë t'a takoje sa vetë De Golin. Të shohësh Pikason për herë të parë përballesh me dy sy të jashtëzakonshëm kafe të errët. Ata janë çuditërisht të mëdhenj për fytyrën dhe ndryshojnë ndërkohë që e sheh dhe bisedon me të. Ndrrojnë aq dukshëm me mendimet që kalojnë në mendjen e tij, ndoshta ktheheshin mbrapsht dhe prap humbisnin në mendime.

2

Ata dukeshin djallëzor, miqësor, ofendues, armiqësor, arrogant, të mërzitshëm dhe menjëherë interesant. Në të shumtën gjatë vizitës tonë ishin të qeshur. Por në gjithë këtë, asnjëri nuk la pa vënë re fuqinë e prezencës së tij, talentit që provokoi një vizion të ri në art...

Pikaso më pyeti nëse e kisha parë ekspozitën e hapur në atë kohë në Paris me titull, "Homage a Pablo Picasso." I thashë se e kisha parë. Ai erdhi rreth tavolinës dhe më tregoi katalogun me një shprehje buzëqeshje. Pas pak u largua. Dhjetë minuta më vonë u kthye dhe më drejtoi një libër. Në kopertinë shkruar, *Për Hantin - Picasso, 19 Mars, 1967.*

The Power of Picasso

LIFE, 27 Dhjetor, 1968.

"Pablo Pikaso tronditi botën duke i rrëzuar mënyrat tradicionale të të parit dhe të menduarit. Shekulli i ri sapo kishte filluar kur Pikaso mori komandën. I nxitur nga koha dhe nga gjenia e tij, e detyroi botën - që

GJON MILI, PICASSO VIZITA E DYTË

nga Qemal Agaj

ai vazhdimisht e acarronte - të njoh veten në mënyrën që e shihte ai. Por aq i habitshëm sa ishte impakti dhe influenca e tij, është fenomeni i tij si njeri. Krijues i mrekullueshëm, provoi çdo lloj arti, i pasuroi të gjitha ato, zbuloi të reja, një sundues gjatë gjithë viteve, që i përgjigjej vetëm vetes së tij.

Asnjë njeri i kohës tonë nuk ka pasur kaq influencë të fortë në artin kontemporan. Pak, nëqoftëse ndonjë, kanë prodhuar kaq kryevepra eksplozive. Të shëtisësh në një Muzeum të Artit Modern pa njohur rreth Pikasos, është pothuajse aq e pamundur, sa të provosh të lexosh pa ditur alfabetin. Akoma më shumë, ndoshta të mos kesh kuptuar çfarë Pikaso thoshte në pikturat, skulpturat, grafikat, qeramikat, eksperimentet e tij të pafund me teknika të reja deri te vizatimet me dritë në errësirë, është të kesh humbur ngazëllimin e të parit dhe dëgjuarit të një nga zërat më të qarta dhe talentin më të fuqishëm të kohës tonë."

PICASSO-S THIRD DIMENSION Introduksion - Gjon MILI.

3

Së pari dua të përmend detyrimin tim ndaj Xhorxh Hunt, Manaxherit botues të LIFE, i cili pas vizitës me Pikason inicioi projektin për të fotografuar artistin dhe

veprat e tij.

Ky libër u bë i mundur nga dy vizita me pikason 18 vjet larg njera tjetrës. Në të dy rastet kur u caktova të fotografoj artistin, e gjeta veten të angazhuar ashtu siç ndodh shpesh me njerës që punojnë me të, në një eksperiencë krijuese të paparashikuar.


Rezultatet e vizitës së parë, në 1949, mund të shihen në 16 faqet e para të librit, fotografi të vizatimeve me dritë në hapësirë të Pikasos. Gjë e çastit vizatuar me dritë të vogël në errësirë, janë shkëlqim i aftësive të tij brilante të nxitura nga momenti.

Prej vitesh, pas eksperiencës së parë me Pikason, flisnim në telefon, kur nuk ishte i zhytur në punë, Pikaso ishte një fëmijë dhe një bashkëbisedues entuziast. Do të kalonin 18 vjet që do ta shihja atë përsëri në një sesion profesional shumë strikt.

Arsyeja për këtë libër dhe subjekti kryesor i tij, u bën të qarta për mua pas vizitës së fundit me Pikason në Notre-Dame-de-Vie, rezidenca e tij në kodrat Mougins, në 1967. Pas disa portretesh, takime të çastit me Pikason, u kushtova në interpretimin e krijimeve të tij tre dimensionale.

Fragmente nga libri, "PICASSO-S THIRD DIMENSION"

...Pamja e origjinaleve të tij, shumë prej tyre të thyera, hedhur pa rregull në



studion e tij të madhe, më tronditën. Ndjeva një nevojë të papërmbajtur të hidhja në dorë këto mrekulli, që Pikaso gjithmonë zotërues i krijimeve të tij, nuk ishte i prirur të ndahej prej tyre.

Sesionet ditore në punishte, në Notre-Dame-de-Vie, zgjatën disa javë. Ato u plotësuan më vonë në orët e natës në Tate Galery në Londër, dhe në Muzeumin e Artit Modern, në New York, ku statujat, kolazhet, qeramikat dhe konstruksionet e Pikasos ishin ekspozuar atë vit. Para se të mbaroja udhëtova për në Stokholm, në kërkim të gjigandeve prej betoni, derdhje masive bazuar në modelet me letra të Pikasos. Gjithashtu shkova në Montmartre në Paris dhe Horta de Ebro, një fshat në Tarragona, Spanjë, për të përshkruar kujtime nga rinia e Pikasos.

4

...I vendosur në një maj kodre, i izoluar dhe pothuajse me pamje të fshehur nga ullinj dhe selvi shekullore, Notre-Dame-de-Vie është një vend i shenjtë për një figurë aq legjendare si Pikaso. Në të nxehtit e mesditës struktura tërheqëse tre katëshe duket pa jetë. Mungesa e lëvizjeve nuk tregonte rrjedhën e rutinës së përditshme të vilës me shumë kompartimente. Për të jashtmit duke kaluar përgjatë, shtëpia me kangjella bëhet e gjallë vetëm gjatë netëve, kur dritat e studios ndriçojnë deri pas mesnate.

...Edhe me gjithë suksesin dhe pasurinë, Pikaso ngelet jo i tërhequr prej saj, ose jo në gjendje të çliroj veten nga idea e ngulitur për të krijuar. "Unë nuk ndahem nga arti, sepse s'do të mund të jetoja pa i kushtuar gjithë jetën atij. Unë e dua atë si i vetmi fund i jetës time."

Jo më kot gruaja e tij, Zhakëlin pohon, "Pikaso është një mrekulli, një diell, një evidencë."

I vetënxitur, brilant dhe i paparashikuar, Pikaso është i veçantë. Artisti më i shquar i kohës së tij, më i imituar, më i kërkuar dhe më i kritikuar, Pikaso vazhdon të krijoj vepra arti të diskutueshme si asnjëherë. Shumë nga skulpturat e tij duke qenë realiste, nuk ngrenë probleme në diskutim, në të kundërt, konstruksionet e tij të fundit, nudot anormale dhe zbulimet metamorfoze, në të cilat ai me vetëdije shtrembëron të vërtetën (natyralen), akoma friksojnë ose hutojnë të paimagjinatët. Pikaso nuk është një që t'i bën gjërat të thjeshta. Ai thotë, "Unë dua të tërheq gjendjen shpirtërore





në një drejtim që nuk është mësuar dhe ta zgjuaj atë.”

Për arsye se kaq gjëra që Pikaso ka bër janë shqetësuese, të duhet një reagim fizik edhe inat të arrish të kuptosh realitetin e pazakontë të tij. Kjo më solli ndërmend thënien e mikut të tij, Andre Breton, “Bukuria duhet të jetë tronditëse, ose pushon së qeni.”

...Edhe kur bashkon objekte që nuk janë harmoni ose shtjellon forma jo reale, idetë e tij bëhen të pëlqyeshme, mesazhi i tij shfaqet dukshëm. Ky mesazh shprehet qartë në thënien e Gertrude Stein, “Nëqoftëse çdo njeri nuk do të ishte kaq i plogët, do ta kuptonte se e bukura është e bukur edhe kur është shqetësuese dhe stimuluese, jo vetëm kur është e pranueshme dhe klasike.”

...Dikush mund të admiroj një pikturë, dikush shikon një statujë. Një pikturë duke qënë një-planshe mund të shihet vetëm përballë dhe të jep një impresion një-anësor, por jo të lehtë për t’u interpretuar. Në të kundërt, një skulpturë duhet parë nga të gjitha planet, të tërheq ta prekësh, ndrron sipas dritës dhe këndvështrimit, të fton ta zbulosh.

...Në skulpturën klasike, volumi realizohet nga një masë që përcaktohet nga sipërfaqja e saj. Në të kundërt, në skulpturën kubiste, si në arkitekturë, hapësira është aq e rrethuar nga pjesëza, sa boshllëku në vend të substancës bëhet kryesor.

5

Thënia e Pikasos se një vepër arti përfundon vetëm në sytë e atij që e shikon, më shtyti të eksperimentoj. Duke përqëndruar dritën, kapja detale esenciale. Duke kombinuar dritën e ditës me dritë artificiale të kontrolluar, pasuroheshin ngjyrat. Çfarë më interesonte më shumë, ishte të zbuloja të reja nga dimensionin i tretë i Pikasos, përfshirë në të, por jo i qartë në dukje.”

Epilog

Në introduksionin e librit të Milit, **Photographs & Recollections** nga TIME, 1980, midis të tjerave shkruhet: “Fotografi Gjon Mili, është **mjeshtër**

i aksidentit të kalkulluar. Kur përgatitet të shkrep aparatën, spontaniteti dhe e magjishmja ndodh. Fotografitë e tij, teknikisht inovative, janë të mbushura me emocione, humor dhe **joi de vivre.**

...Të inkluduara në libër janë 35 vjet portrete artistësh, njerës të shquar, politikanë dhe muzikantë, shumë të fotografuara për LIFE, por disa për kënaqësinë e atij vet. E tëra është shoqëruar me tekstin gazmor të Milit, një përshkrim që arrinë të të prek dhe të krijoj humor në të njëjtën kohë.

...Shumë nga seritë e tij fotografike – vizita e fundit me të moshuarin, Sean O’ Casey, një zjarr që shkruambëzoi studion e Milit, ku humbën jetën disa zjarrëfikës, amoraliteti rrënoqthës i Eichmann – janë fotogazetari tronditëse.

Siç u shpreh Sartre me rastin e

ekspozitës së Milit në Paris, 1946, “Përpara se të takoja Milin, kam njohur vetëm fotograf pa temperament, që bëjnë fotografi me inat, si njeri që vret diçka...”

GJON MILI dhe angazhimet e tij në ngjarjet politike të kohës.

Angazhimi i parë i Milit në ngjarjet politike të kohës ishte fotografimi i Konferencës së Paqes në Paris, 1946. Kur fotografoi përfaqësuesin e Shqipërisë, ndoshta as ai nuk e dinte se po fotografonte diktatorin e ardhshëm të Atdheut, që aq shumë e kishte brenda tij, aq sa dhe emrin e ruajti në shqiptimin shqip, GJON dhe jo në atë anglisht, XHON (John).

Ai vërtetë e fotografoi diktatorin, por për të ngeli vetëm në celuloid. Shtypi komunist me krenari e botonte

fotografinë, por jo autorin e saj. Mili nuk e përfshiu atë në librin e tij.

6

Në vitin 1961 me kërkesë të qeverisë Israelite, caktohet të fotografoj kriminelin e luftës, Adolf Eichmann në burg, në Izrael. I.S.A., (Israeli State Agency) në New York, dokumenton: “Qeveria Izraelite zgjodhi fotografën e shquar Shqiptaro-Amerikan të LIFE, GJON MILI, për fotografimin e Eichmann në burg, me kushte që ai zyrtarisht do të punësohej nga ‘Government Press Office’, kështu do të parandalohen akuzat që Izraeli nuk mund të prodhojë imazhe ekselente.”

Imazhi i Eichmann me cigare, është i vetmi moment ku Mili u gjend ball për ball me kriminelin. Vall çfarë ndjeu Mili në në atë moment? Kur doli nga qelia, roja i tha: “Zotni, ju dukeni shumë i verdhë.” Mili nuk gjeti përgjigje.

Eichmann në qeli në prag të gjyqit. Një studim intim fotografuar nga GJON MILI.

LIFE, 14 Prill, 1961.

“Nganjëherë disa njerës të dëgjuar bëhen simbol i kohës që jetojnë, i të mirës ose i të keqes, i arësyes ose marrëzisë. Një njeri i tillë është Nazisti Adolf Eichmann, një simbol i urrejtjes dhe imoralitetit të Gjermanisë Naziste. Ja ku është në këto studime dramatike nga fotografi Gjon Mili. Këto janë pamjet e para në botë në një shikim intim të njeriut që u zhduk 16 vjet më parë dhe për gjithë këto vite ka qënë i kërkuari, i damkosuri i krimeve të luftës...”

Në 1973 ai i kërkoi editorit të “LIFE Special Reports,” John Loengard, të mbulonte “Watergate Scandal”, fundin e Presidencës së Richard Nikson. Një kërkesë kjo që editorin ia atribuoi Milit si, “Person me shqetësime për liritë qytetare dhe demokracinë.”

Dilet në mendim të përgjithshëm se personaliteti i Gjon Milit, bën pjesë në tërësinë e personaliteteve sociale dhe artistike më të shquara të kohës.

Referenca:
PICASSO-s THIRD DIMENSION - Gjon MILI, 1972. Photographs & Recollections - Gjon MILI, 1984. LIFE, 27 Dhjetor, 1968. LIFE, 14 Prill, 1961



Karikaturë nga Arben Mexsi

